

**“ALEKSANDËR MOISIU” UNIVERSITY
DURRËS, ALBANIA**

**Interdisciplinary Journal
of Research and Development**

VOLUME 5, Number 1, 2018

ISSN: 2410-3411
ISSN-L: 2313-058X

Published by
“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania

EDITORIAL STAFF OF INTERDISCIPLINARY JOURNAL OF RESEARCH AND DEVELOPMENT

President of Editorial Board

Prof. Dr. Kseanela Sotirofski,
“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania

EDITORIAL BOARD

Kseanela Sotirofski,	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
Leke Sokoli,	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
Lavdosh Ahmetaj,	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
Mithat Mema,	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
Andon Kume,	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
Azeta Tartari,	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
Lindita Mukli,	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
Jani Sota,	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
Osman Metalla,	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
Deak Csaba,	National Innovation Office, Hungary
Ensar Nisanci,	“Namik Kemal” University, Tekirdag, Turkey
Ihsan Soysal,	“Namik Kemal” University, Tekirdag, Turkey
Jose Albiac,	Saragossa University. Saragossa Spain
Szilagyi Roland,	University of Miskolc, Hungary
Athanasios Natsis,	Agricultural University of Athens, Greece
Michel Bonneau,	University of Angers, France
Francesco Scalera,	University of Bari, Italy

Editor in chief

Prof. Dr. Mit’hat Mema, *“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania*

Associate editors

Dr. Daniela Meçe, “Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
Dr. Majlinda Sana, “Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
Dr. Albana Halili, “Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
Dr. Ela Golemi, “Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
Prof. Ass. Dr. Enver Bytyçi, “Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania

TABLE OF CONTENTS

Enver BYTYÇI

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT DHE RRETHANAT
NDËRKOMBËTARE NË TË CILAT U MBAJT AJO 5

Prof. Assoc. Ph.D. Jani SOTA

POLITIKA ARSIMORE E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT
FAKTOR KRYESOR NË EVOLUIMIN E RILINDJES KOMBËTARE 12

Dr. Joachim MATZINGER & Dr. Monica GENESIN

GJUHA SHQIPE DHE GJENDJA GJUHËSORE
NË EPOKËN E SKËNDERBEUT 34

Agostino GIORDANO

„SHPATA SKANDERBEKUT NDË DIBRET
POSHT’ I BINARD BILOTËS 44

Migena SHEHU

KUFIRI JUGOR I SHQIPËRISË DHE ISHUJT E EGJEUT
ANALIZË E KORRESPONDENCËS DIPLOMATIKE
BRITANIKE PËRGJATË VITEVE 1913 - 1914 57

Dr. në proces Luljeta TAFANI

SKANDERBEU STRATEG GJENIAL ME JETESHKRIMIN
MË TË PËRHAPUR NË EVROPË 69

Besnik RAMETI

SA ISHIN TË PËRGATITUR SHQIPËTARET
NË ASPEKT DIPLOMATIK NDAJ VENDIMEVE
TË KONGRESIT TË BERLINIT (1878-1881) 81

Prof.as.dr. Lavdosh AHMETAJ

RADIKALITETI POLITIK I LIDHJES SË PRIZËRENIT
NXIT INSTIKTIN USHTARAK TË PORTËS SË LARTË 91

Dr. Nuridin AHMETI

FIGURA E SKËNDERBEUT NË SHTYPIN
FETARË SHQIPTARË NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE 105

Prof. Asoc.Dr. Mois KAMBERI

ORIGJINA E KASTRIOTËVE, SKËNDERBEUT
NËPËRMJET TOPONIMEVE 118

Prof. Asoc. Dr. Enver BYTYÇI

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT DHE RRETHANAT NDËRKOMBËTARE NË TË CILAT U MBAJT AJO

Lidhja Shqiptare e Prizrenit është ngjarja më e madhe kombëtare e para shekullit XX, sepse ajo shtroi trasenë e krijimit të një shteti shqiptar kombëtar, hodhi bazat e bashkimit politik të shqiptarëve, unifikoi përpjekjet e shqiptarëve në të gjitha trevat e të katër vilajeteve, si dhe të atyre në Turqi, Rumani, Bullgari, Egjipt etj, me qëllim krijimin e një shteti nacional, ku të bashkoheshin shqiptarët rreth simboleve të tyre kombëtare.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit është ngjarje që ende sot jep mesazhet e bashkimit dhe të identifikimit tonë kombëtar në funksion të ndërtimit dhe forcimit të shtetit në frymën e lirive dhe vlerave perendimore. Lidhja Shqiptare e Prizrenit është simbol i angazhimit politik për ruajtjen dhe mbrojtjen e çdo pëllëmbë tokë të territorit shqiptar!

Lidhja shqiptare e Prizrenit erdhi në një kohë kur teatri politik i Fuqive të Mëdha Europiane po rikonfigurohej, kur vendin e Prusisë tashmë e kishte zënë Gjermania e bashkur, kur Italia ishte shfaqur si Fuqi rajonale dhe kontinentale pas bashkimit të saj, kur Perandoria Osmane kishte filluar tatëpjetën e saj dhe kur dy Fuqitë e asaj kohe rivale, Rusia dhe Perandoria Austro-Hungareze i shpërfaqën ambicjet dhe rivalitetet e tyre për influencë dhe ndikim në gadishullin e Ballkanit e të Europës Juglindore.

Lidhja u mbajt në Prizren më 10 qershor 1878. Ajo i filloi punimet e saj vetëm tri ditë para se të fillonte mbledhja e Kongresit të Berlinit. Ndërkohë deri në këtë moment kishin ndodhur ngjarje të tjera të rëndësishme ndërkombëtare. Më 1856-ën në Paris ishte vendosur që të ruheshin ekulibrat politikë të Fuqive Europiane, e në këtë kuadër Ruisë iu ndalua dalja në Detin e Zi. Por me ndryshimin e kushteve gjeopolitike dhe të rrethanave ndërkombëtare Rusia filloi të bënte presion mbi Fuqitë e tjera, me qëllim shtrirjen e ndikimit dhe influencës së saj në vendet e Europës Lindore dhe Juglindore,

Dhe nëse vihemi në kërkim të këtyre kushteve e rrethanave, atëherë do të venë re pikërisht disa ndryshime drastike. Cilat ishin ato?

1. Perandoria Osmane, pjesë e së cilës ishte formalisht pjesa më e madhe e Ballkanit, ndërkohë që vilajetet shqiptare qenë plotësisht në varësinë e Portës së Lartë, vuante krizën e shpërbërjes së saj. Kjo krizë identiteti dhe shpërbërjeje kishte filluar në Greqi me Revolucionin e vitit 1821. Por në mesin e viteve 1870 Porta e Lartë vuante nga shumë sëmundje. Më së pari ekonomia e saj u ndodh në një krizë të thellë. Korrupsioni i aparatit burokratik, arroganca e hallkave administrative dhe plogështia e strukturave shtetërore u bënë sëmundja kryesore e brendshme e pushtetit të Sulltanit. Kjo situatë e krijuar e çoi perandorinë drejt kolapsit financiar. Në vitin 1875 Porta e Lartë kishte një defiçit tregtar të papërbalueshëm. Ndonëse të ardhurat e saj vjetore shkonin 800 milionë franga ari, borxhet kapnin shifrën e 5,3 miliardë franga ari. Në këtë situatë financat e perandorisë nuk përballonin as këstet vjetore të interesave të këtij borxhi, për të mos folur për pagesat e kësteve të detyrueshme për kthim.

Në këto kushte krize u shfaqën një sërë kryengritjesh të armatosura. Serbia dhe Mali i Zi, të inkurajuar nga Cari i Rusisë, i shpallën luftë Stambollit në verën e vitit 1876 me ultimatumin për pavarësinë e këtyre dy vendeve. Bullgaria po ashtu kishte shpallur autonominë e saj nga Porta e Lartë. Në Hercegovinë shpërtheu në korrik 1875 kryengritja çlirimtare antiosmane, kryengritje të cilën e mbështetën popullsitë sllave, por jo edhe popullsia muslimane. Megjithatë kjo kryengritje u shtri edhe në Bosnjë. Për të realizuar interesat e saj në Ballkan Rusia përkrahu fuqimisht kryengritjet sllave të Ballkanit, ndërkohë që në ndihmë të kryengritjes serbe e malazeze dërgoi rreth 30 mijë “vullnetarë” përkrahës të luftës antiosmane.

2. Me kryengritjet ballkanike të popujve sllavë dhe lufrat ruso-turke në Krime kishte filluar ajo që tashmë në histori është konsideruar si Kriza Lindore. Kryengritjet antiosmane u shtrinë deri në Krime, gadishull në të cilin u përplasën ushtritë e dy perandorive, asaj osmane dhe perandorisë ruse. Përplasje midis këtyre dy më të fuqishmëve në Lindjen e Juglindjen europiane ishte sinjali i parë i asaj çfarë do të vinte në teatrin europian të Fuqive të Mëdha në vitet në vazhdim. Megjithatë Rusia u përpoq që ta shfrytëzojë situatën e saj të favorshme nga fitoret në terrenin ushtarak dhe të imponojë kushtet e saj të prezencës dhe autoritetit politik e strategjik në Ballkan.

Rusia e kësaj kohe shihte në horizont krijimin e shansit për realizimin e ambicjeve në rajonin tonë. Ajo koordinoi të gjitha veprimet me qëllim vënien e Perandorisë Osmane para faktit të kryer dhe zëvendësimit e saj në territoret e Europës Juglindore. Por duket se Anglia ishte e kujdesshme. Ndërsa Gjermania, ndonëse e nxiste Rusinë kundër Perandorisë Osmane, bënte kujdes që të mos çenoheshin interesat e Perandorisë Austro-Hungareze.

Me qëllim që Rusia dhe Perandoria Dyshe të ruanin ekuilibrat e interesave

të tyre në rajonin european të Perandorisë Osmane u nënshkrua në Budapest më 18 mars 1877 një marrëveshje midis tyre. Sipas kësaj marrëveshjeje Austro-Hungaria nuk do bëhej palë në luftën ruso-turke dhe për këtë Rusia ra dakord që Vjena të pushtonte Boanjë-Hercegovinën, ndërkohë që fati i Novi Pazarit dhe Sanxhakut do të përcaktohej më vonë. Ndërsa Vjena i njihte të drejtën Rusisë të pushtonte Besarabinë dhe Batumin në Kaukaz. Nëse Perandoria Osmane do të binte, atëherë të dy perandoritë ranë dakord që të krijoheshin shtetet ballkanike, përfshirë edhe Shqipërinë. Për herë të parë flitej në bisedime të fshehta për të drejtën e shqiptarëve për autonomi ose krijimin e një shteti shqiptar, por pa përcaktuar vijat kufitare të tij.

Megjithatë në këtë rast palët ranë dakord që Greqisë t'i bashkëngjiten Kreta, Thesalia dhe Epiri, çka do të thoshte një popullsi shqiptare në jug të vendit. Por Austro-Hungaria evitoi krijimin e një shteti sllav të përbashkët në Ballkan, përmes të cilit Rusia dhe Serbia do të dilnin në brigjet lindore të Detit Adriatik.

Më 24 prill 1877 Rusia i shpalli luftë Perandorisë Osmane. Serbia nuk iu bashkua Peterburgut, ndërkohë që Mali i Zi i shpalli gjithashtu luftë Turqisë, duke u vënë në krah të Rusisë. Lufta vazhdoi për gati një vit, derisa Porta e Lartë u gjunjësua përballë forcës së Carit rus dhe pranoi kushtet e humbjes së territoreve në Traktatin e Shën Stefanit, nënshkruar midis dy palëve më 3 mars 1878.

Traktati i Shën Stefanit i shkëputte Perandorisë Osmane afër 80 përqind të territoreve të saj në kontinentin european. Sipas këtij traktati Serbia dhe Mali i Zi do të ishin shtete të pavarura, ndërsa Bullgaria do të kishte një autonomi gati të plotë nga Stambolli. Bullgaria thjesht do t'i paguante Sulltanit një taksë simbolike, përndryshe nuk do të kishte asnjë lidhje tjetër ushtarake, administrative ose qeverisëse me Portën e Lartë. Në këtë traktat Rusia u kujdes që të mos kishte asnjë keqkuptim sa i përket pranisë së saj në Ballkan. Nuk pranoi që të jetë ajo zotëruese e territoreve, por mundësoi krijimin e dy shteteve të fuqishme sllave ballkanike, Bullgarinë dhe Serbinë, me qëllim që përmes tyre të realizonte të gjitha synimet gjeostrategjike dhe gjeopolitike në rajonin tonë.

Bullgarisë iu dhanë shumë territore shqiptare, si Shkupi, Kaçaniku, Tetova, Gostivari, Dibra, Ohri, Struga, Pogradeci, rrethinat e Korçës e deri në malet e Voskopojës. Serbisë iu dhanë përmes këtij traktati territore të tjera shqiptare në veri të Kosovës, deri në Mitrovicë. Ndërsa Malit të Zi iu dhanë Ulqini, Plava, Kraja, Gucia dhe territore të tjera të banuara nga shqiptarët. Ndërkohë që në jug të vendit i ashtuquajturit Eipri i Jugut në Taktatin e Budapestit i ishte premtuar Greqisë. Për krijimin e një shteti shqiptar nuk u fol në këtë traktat. Megjithatë besohej se sipas interesave të Austro-Hungarisë, terroret tjera shqiptare ende nën Perandorinë Osmane, do të mbeteshin pjesë e një shteti të ardhshëm shqiptar.

Rusia, Serbia dhe Mali i Zi u përpoqën gjithashtu të tërhiqnin shqiptarët në luftë kundër Perandorisë Osmane, por deri në atë masë sa të ndihmonin fitoren e tyre në këtë luftë, jo edhe me synimin që pjesmarrja e shqiptarëve të krijonte mundësinë e krijimit të një shteti shqiptar.

Në përmbushje të detyrimeve të Traktatit të Shën Stefanit Serbia realizoi fushatën e parë të saj të spastrimit etnik të shqiptarëve në rajonet e sanxhakut të Nishit. Sipas Noel Malcolm kjo fushatë shpërnguljesh, tashmë e dëshmuar nga dokumente origjinale që kanë dalë nga arkivat serbe, i bindi shqiptarët se ata do të kenë një konflikt të gjatë dhe të ashpër me Serbinë. Këto ngjarje bënë që shqiptarët të tregohen të kujdesshëm dhe të matur në kërkesat dhe reagimin e tyre ndaj Perandorisë Osmane. Protesta të fuqishme të shqiptarëve u zhvilluan vetëm në rastet kur Fuqitë e Mëdha dhe Porta e Lartë së bashku me Greqinë tentuan të shkëpusin territoret e Çamërisë nga vilajetet shqiptare për t'ia dhënë ato shtetit grek. Edhe pse këtë akt e kishte rekomanduar Kongresi i Berlinit, shqiptarët e detyruan komisionin greko-turk të tërhiqet, duke shpëtuar një pjesë të territoreve të tyre. Në veri të vendit pati gjithashtu një kryengritje të armatosura, të cilat u drejtuan si kundër osmanëve, ashtu dhe kundër ndërhyrjes së Fuqive të Mëdha dhe ushtrisë malazeze për pushtimin e territoreve të Plavës, Gucisë, Grudës, Kastratit etj.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit erdhi kështu si një ngjarje, e cila ndodhi në kushtet e një trysnie të jashtëzakonshme të fqinjëve veriorë dhe jugorë për aneksimin e territoreve shqiptare. Gjithçka po ndodhte në kushte të reja të ekspansionit rus dhe ndikimit të Fuqive Europiane në Ballkan, të cilat kishin marrë anën e Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë. Shqiptarët nuk kishin aleatë në këto momente.

3. Kongresi i Berlinit i filloi punimet e tij vetëm tri ditë pasi kishte nisur mbajtja e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ky kongres vendosi raporte të reja ndërkombëtare europiane, për shkak të ndryshimeve të mëdha që kishin ndodhur. Siç thamë, Gjermania ishte bashkuar, Italia kishte krijuar shtetin e saj kombëtar, Rusia kishte dalë fituese në betejat dhe luftën kundër Perandorisë Osmane, Monarkia Dyshe kishte nisur aksionin e saj politik dhe diplomatik për të rivalizuar dhe konkuruar prezencën e Rusisë në Europën Juglindore. Në shtetet ballkanike sllave ishte konfirmuar autonomia ose pavarësia nga Porta e Lartë. Për të gjitha këto arsye Kongresi i Berlinit ishte dhe mbeti ngjarja më me rëndësi e kohës për ndërtimin e një rendi botëror paksa të ndryshëm nga rendi i mëparshëm.

Shqipëria nuk mund të qëndronte jashtë këtyre zhvillimeve. Prandaj Lidhja Shqiptare e Prizrenit pati një rëndësi të jashtëzakonshme për evidentimin dhe ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare. Në fakt Kongresi i Berlinit u mblodh për të rishikuar Traktatin e Shën Stefanit. Në këtë Kongres morën pjesë gjashtë

Fuqitë e Mëdha Europiane, përkatësisht Gjermania, Anglia, Franca, Rusia, Austro-Hungaria dhe Italia. Punimet u drejtuan nga kancelari gjerman Otto von Bismark. Në kongres ishte ftuar të marrë pjesë gjithashtu një delegacion i Perandorisë Osmane, si dhe shtetet ballkanike (Serbia, Greqia, Bullgaria, Rumania dhe Mali i Zi). Përmes peticioneve shqiptarët i parashtruan Kongresit pretendimet e tyre edhe. Më 15 qershor Lidhja miratoi një peticion për Fuqitë e Mëdha me kërkesën për autonomi të vilajeteve shqiptare nga Porta e Lartë dhe e përcolli atë me anën e Abdyl Frashërit. Abdyl Frashëri në krye të delegacionit mundi ta takonte kancelarin gjerman Bismark, por nuk mundi të imponojë futjen në rend të ditës të kërkesës së shqiptarëve për të njohur autonominë e vilajeteve shqiptare, pak a shumë në atë formë si autonomia e Bullgarisë.

Vendimet e Kongresit të Berlinit favorizuan shtetet ballkanike, por jo edhe shqiptarët, të cilëve me vendimet e tij u shkëputej një pjesë e territorit të saj. Ka interpretime se ky kongres e rëndoi pozitën e shqiptarëve “pse nuk kërkoi prishjen e sistemit të organizimit të vilajeteve nga ana e Perandorisë Osmane”. Në fakt Fuqitë e Mëdha u kujdesën që Porta e Lartë e Stambollit të kishte një rol në Ballkan dhe të ruante statuskuonë e saj. Sidomos anglezët, të cilët morën Qipron, këmbëngulën fort për ruajtjen e sistemit të kohës së Perandorisë Osmane, gjithnjë nga frika se shpërbërja e pakontrolluar e saj do të favorizonte daljen e Rosisë në Bosfor.

4. Brenda vendit situata ishte organizuar mjaft mirë. Lidhja Shqiptare e Prizrenit funksionoi së ekzistuari dhe kreu për tri vite radhazi funksione të shumta në dobi të autonomisë së vilajeteve shqiptare. Në rrethanat e rënduara ndërkombëtare intelektualët shqiptarë në Stamboll, shumiva e të cilëve ishin të lidhur me pozicione të rëndësishme në qeverinë e Stambollit, organizuan më 18 dhjetor 1877 forumin e organizatës atdhetare revolucionare me emrin Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare, atë që në histori njihet si Komiteti i Stambollit. Kryetar i Komitetit u zgjodh Abdyl Frashëri, deputet e parlamentit të dytë osman, i zgjedhur në Janinë. Programi i këtij komiteti përmbante organizimin e një kryengritjeje mbarëkombëtare antiosmane dhe krijimin e një aleance me Greqinë. Por bisedimet me Greqinë dështuan për shkak të ambicjeve të saj për territoret e të ashtuquajturit Epiri i Jugut, që më vonë do të rriste oreksin edhe për aneksimin e Epirit të Veriut ose Shqipërisë së sotme Londineze të Jugut.

Në shkurt të vitit 1878 ky program pësoi ndryshimin radikal, duke evituar një konflikt të armatosur shqiptaro-turk, me qëllim organizimin politik për arritjen e autonomisë së vilajeteve shqiptare.

Para formimit të Komitetit të Stambollit, në Janinë ishte krijuar Komiteti i Janinës (maj 1887), në programin e të cilit ishte vënë organizimi i kryengritjes

së armatosur antiosmane. Por edhe pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit veprimtaritë patriotike ishin të njëpasnjëshme. Mund të përmendim disa prej tyre:

1. Aksionin e Gjakovës të korrik-shtatorit 1878. Ky aksion u parapri me mbajtjen e Kuvendit Ndërkrahinor në Janinë më 24 korrik 1878, nën drejtimin e Abdyl Frashërit, kuvend i cili vendosi kundërshtimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit për aneksimin e tokave shqiptare të Çamërisë dhe Janinës nga Greqia dhe të Plavës e Grudës nga ana e Malit të Zi. Më 25 gusht të atij vitit patrioti nga Luma e Kukësit, Ramadan Zaskoci, vrau telegrafistin turk në Prizren, duke ndërprerë lidhjet e ushtrisë turke me Portën e Lartë. Ndërsa më 3 - 4 shtator ushtria e Lidhjes me 4500 forca të armatosura sulmoi Mehmet Ali Pashën dhe ushtrinë turke në Gjakovë, duke e mundur atë, madje duke e lënë të vrarë vetë pashain turk. Ky aksion pati jehonë të gjerë dhe ndikoi shumë në rritjen e autoritetit të Lidhjes,

2. Më 1 nëntor 1878 u mbledh Kuvendi i Dibrës, i cili hartoi një program me shtatë pika, njëra prej të cilave i kërkonte Stambollit krijimin e një vilajeti të vetëm shqiptar, i cili do të shërbente si kufi për realizimin e një shteti të pavarur në kushte të përshtatshme.

Për mbrojtjen e trojeve jugore të Shqipërisë u mbajt Kuvendi i Prevezës (11 janar 1879), ku morën pjesë 400 delegatë. Ky kuvend hartoi një rezolutë drejtuar Fuqive të Mëdha dhe ngarkoi një delegacion të kryesuar nga Abdyl Frashëri që të udhëtonte në kryeqytetet europiane për t'i bindur kancelaritë e kontinentit për vendimet e gabuara të Kongresit të Berlinit dhe rishqyrtimin e çështjes shqiptare. Në lidhje me qëndrimin e shqiptarëve ndaj Protokollit nr.13, gjuha e memorandumit ishte e prerë. Shqiptarët, thuhej aty, si një popull i frymëzuar nga ndjenja atdhetare, nuk do të lejojnë që vendi i tyre të pushtohet dhe të sundohet nga të tjerët. Dhe më tej: ***“Shqiptarët kanë ruajtur atdheun e tyre, kombësinë e tyre, gjuhën e tyre dhe zakonet e tyre duke prapsur sulmet e romakëve, të bizantinëve e të venedikasve. Si mund të lejohet që në këtë shekull të diturisë e të qytetërimit, një komb kaq trim e kaq i lidhur me truallin e tij të sakrifikohet duke ia dhënë një fqinji kaq të pangopur, pa asnjë arsye të ligjshme?”***

Nën drejtimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit forcat kryengritëse shqiptare mbrojtën Plavën dhe Gucinë gjatë periudhës tetor 1879-janar 1880. Por luftimet vazhduan edhe gjatë pranverës së vitit 1880, derisa Fuqitë e Mëdha u detyruan të hiqnin dorë nga vendimet e Kongresit të Berlinit për aneksimin e këtyre territoreve Malit të Zi.

Po gjatë vitit 1879 nisi lëvizja kundër administratës osmane, e cila vijoi në vitin 1880 dhe u cilësua si lëvizje për autonominë e territoreve shqiptare dhe krijimin e një vilajeti të vetëm, në të cilin të mësohej gjuha shqipe dhe administrata të ishte me shqiptarë, duke shtuar kërkesën që ushtria gjithashtu të përbëhej po nga shqiptarët.

Bibliografia:

1. Peter Bartl: Albanien - vom Mittelalter bis zur Gegenwart, Verlag Friedrich Pustet, Regensburg-Muenschen, 1995.
2. Michael Weithmann: Kriesenherd Balkan - Urspruengend Hintergruende des aktuellen Konflikts. Wilhelm Heyne Verlag, Muenchen, 1992.
3. Konrad Clewing, Oliver Jens schmitt (Hg): Geschichte Suedosteuropas - vom fruehen Mitelalter bis zur gegenäart. Verlag Fridrich Pustet, Regensburg 2011.
4. Robert Elsie: Fjalor historik i Shqipërisë, UEGEn, Tiranë 2011.
5. Enver Bytyçi: Shqiptarët, serbët dhe grekët, Shtëpia Botuese KOHA, Tiranë 2005.
6. Noel Malcolm: Kosova një histori i shkurtër. KOHA, Prishtinë 1998.
7. Enver Bytyçi: Sistemet dhe Institucionet e Krahasuara të Qeverisjes. Instituti i Studimeve të Europës Juglindore, Tiranë 2017.

Prof. Assoc. Ph.D.¹ Jani SOTA

POLITIKA ARSIMORE E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT FAKTOR KRYESOR NË EVOLUIMIN E RILINDJES KOMBËTARE

Abstrakt

Artikulli synon të identifikoj rolin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në planin arsimor dhe kulturor, para së gjithash, në hartimin prej saj të platformës së zhvillimit të arsimit që ishte pjesë organike, e pandarë e programit të autonomisë territoriale administrative. Bartës i ideve për arsimim dhe shkollë shqipe ishin figurat e dalluara të kulturës dhe të mendimit politik shqiptar, të cilët dalloheshin për punë kreative, si ideologë e aktivist politik dhe të mendimit pedagogjik shqiptar, që kultivonin mendimin e mirëfilltë politik në dhe të huaj. Mendimi i ri i përparuar me karakter kombëtar për zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe, u shpreh në dokumentet kryesore zyrtare dhe jo zyrtare të Lidhjes së Prizrenit dhe në varg traktatesh politike si “*E vërteta mbi Shqipërinë e shqiptarët*” (1878) e Pashko Vasës, “*Apologjia*” (1878) e Jani Vretos, “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të behet*” (1899) e Sami Frashërit; si dhe në një mori artikujsh politik të botuar në gazetën “Zëri i Shqipërisë” i Anastas Kulluriotit. Lidhja Shqiptare ushtroi një ndikim të fuqishëm pedagogjik, letrar dhe kulturor në përgjithësi në një numër të konsiderueshëm përfaqësuesish të mendimit pedagogjik e të veprimtarisë shkollore shqiptare me orientim progresiv e demokratik në hapësirën e viteve.

Fjalë kyçe: Memorandum, platformë arsimore, mendim pedagogjik, tekst mësimor.

¹ “Aleksandër Moisiu” University; Durrës, jani_sota@yahoo.com

Hyrje

Historia e shkollave dhe e ideve pedagogjike të shumë vendeve dhe popujve, sidomos nga vitet '70 të shek. XIX, është i mbushur me ndryshime e kthesa të mëdha e të rëndësishme. Rritet shumë interesi për shkollat fillore dhe shkolla të tjera, në sajë të një kujdesi gjithnjë e më të madh të vendeve të Europës që, kundrejt shkollave private dhe kishtarë, të hapen shkolla si institucione edukativo-arsimore shtetërore e që arsimit të lidhet ngushtë me nevojat e prodhimit të industrisë dhe të jetë në frymën e ideologjisë së klasës sunduese.

Në këtë drejtim ndikoi gjithsesi edhe zhvillimi i shpejtë i shkencave të natyrës dhe i shkencave të tjera, që pati për pasoj edhe ndryshimin e përmbajtjes e madje edhe të organizimit dhe të metodave të mësimi e të arsimit. Brenda gjithë këtij procesi arritjen më të madhe paraqet shfaqja dhe zhvillimi i doktrinës dhe i veprave filozofike. Në këtë periudhë proletariati bëhet një klasë e re dhe e formuar me qëllime e synime politike të qarta, gjë që u pasqyrua edhe me idetë e politikës arsimore të Komunës së Parisit. Këto janë vetëm disa momente e ngjarje më të rëndësishme që ishin pasqyruar asaj kohe në shkolla dhe arsim, e idetë e këtilla gjetën shprehje dhe u zhvilluan edhe ndër ne. E drejta, në kushtet e pushtetit osman, edhe vetë shkollat shtetërore turke madje zhvilloheshin dhe përhapeshin shumë ngadalë.

Gjatë viteve '70 kjo lëvizje e rilindjes kulturore me një arsimim gjithnjë më të organizuar pedagogjik, nuk la anash as popullin shqiptar të gjysmës së dytë të shek. XIX, Këto janë vetëm disa momente e ngjarje më të rëndësishme që ndikuan në atë kohë jo vetëm në progresin e shkollave dhe arsimimit e shoqërisë ne vendet e zhvilluara evropiane, por ato gjetën shprehje dhe u zhvilluan edhe në shoqërinë shqiptare të gjysmës së dytë të shek. XIX, qoftë kur është fjala për ata që jetuan dhe punuan gjatë kësaj kohe në kushtet që impononte politikën e vendeve të zhvilluara evropiane.

Është koha kur Rilindja Kombëtare dhe bartësit e saj gjendeshin para sprovave të mëdha, përkrahë parashtrimit të detyrave të ngutshme në planin e organizimit, të thurjes së një platforme të mirëfilltë jo vetëm *politike*, por edhe *atë arsimore*, në formulimin e ideve të reja *filozofike për edukimin*, si dhe kultivimin e një *moralit të lartë atdhetarë* dhe të *ndërgjegjshme kombëtar*.

Bartës të këtyre ideve, pra *autor idesh* mbi takimin kombëtar janë ata, të cilët jetonin larg atdheut dhe të cilët zgjidhjen e problemit të popullit të tyre e shihnin brenda përmbajtjes të politikës arsimore të Rilindjes Kombëtare, brenda faktorit integruar çfarë ishte kultura dhe arsimit, pra brenda kodit civil e juridik çfarë kishin popujt e tjerë të Ballkanit. Me fjalë të tjera bartës të ideve për arsimim dhe shkollë shqipe ishin *figurat e dalluara të kulturës dhe të mendimit politik*

shqiptar, të cilët dalloheshin për punë kreative, si ideologë e aktivist politik dhe të mendimit pedagogjik shqiptar, që kultivonin mendimin e mirëfilltë politik në dhe të huaj.

Në kontekstin e aktivitetit mbarëkombëtar të asaj kohe, ishte edhe *Lidhja Kombëtare Shqiptare*, e cila u formua në Prizren, më 10 qershor 1878². Ajo është organizata e parë politike mbarëshqiptare në historinë e kombit tonë, që la gjurmë të pashlyeshme dhe që ndikoi fuqishëm mbi të gjitha anët e jetës së tij. Ajo ishte e para *lëvizje masive me karakter kombëtar*, në të cilën morën pjesë të gjithë krahinat e Shqipërisë dhe ku u harmonizuan të gjitha format e luftës çlirimtare që nga *kuvendet popullore* deri të parashtrimit i *kërkesave politike*, që nga *misionet diplomatike* deri të *kryengritjet a armatosura*.

Lidhja e Prizrenit synoi të realizonte programin e Rilindjes Kombëtare në kushtet e krizës Lindore të viteve ‘të shek. XIX. Synimet e saj ishin: njohja e kombit shqiptar si një bashkësi e pandarë. Mbrojtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë etnike dhe formimi i një shteti shqiptar autonom, demokratik dhe iluminist³.

Shikuar në aspektin e përmbajtjes, Lidhja Shqiptare ishte një lëvizje kulturo-politike gjysmë e pavarur, në thelb, po mbillte farën e vet, që paralajmëronte një fillim të mbarë në planin e vetëdijesimit kombëtar shqiptar. Është e vërtetë se *problemet politike, ushtarake dhe diplomatike* patën përparësi në veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, megjithatë ajo nuk la pas dore *problemet e arsimit*, duke luajtur një rol të shquar në këtë fushë. Gati të gjithë ideologët e saj e theksonin se krahas veprimtarisë politiko-ushtarake, Lidhja duhet ti kushtonte rëndësi edhe faktorit arsimor.

1. Platforma kulturore-arsimore e Lidhje së Prizrenit dhe rëndësia e saj

Edhe pse Lidhja e Prizrenit, për shkak të luftës kundër forcave osmane dhe shteteve shoviniste fqinje, nuk arriti të merrej drejtpërdrejtë me hapjen e shkollave, ajo shënon një fazë të re edhe në zhvillimin e shkollës dhe të mendimit pedagogjik shqiptar. Shënon një hap cilësor në ndërtimin e platformës së sistemit arsimor kombëtar, edhe pse jo në atë shkallë që kërkonin ideatorët e Rilindjes. Kjo shihet qartë në vendimin e Degës së lidhjes Shqiptare të Dibrës dhe të Lidhjes së Toskërisë, përfaqësuar nga Abdyl Frashëri, ku ndër të tjera

² Grup autorësh, *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve* (më tej: *Historia e Shqipërisë ...*), Prishtinë: “Sprint”, 2001, f. 117.

³ Fahredin Shabani, *Mendimi politik në Rilindjen Kombëtare Shqiptare 1881-1912* (më tej: *Mendimi politik ...*), botimi i Institutit Albanologjik, Prishtinë: “Shtypshkronja KGT”, 2011, f. 56.

thuhet: “të gjithë nëpunësit që do jenë në Shqipëri duhet të dinë gjuhën e vendit; të përhapet arsimit dhe në shkolla të mësohet edhe gjuha shqipe; të ndahet një sasi e mjaftueshme nga të ardhurat e përgjithshme të vilajetit për t’u shpenzuar për përmirësimin e arsimit si dhe për ndërtime publike”⁴.

Roli i Lidhjes Shqiptare në planin kulturor qëndron, para së gjithash, në hartimin prej saj të programit të zhvillimit të arsimit kombëtar që ishte pjesa organike, e pandarë e programit të autonomisë territoriale administrative. Programi që parashtrroi Lidhja Shqiptare parashikonte:

- “Së pari, njohjen zyrtare të gjuhës shqipe në përdorim të përgjithshëm brenda kufijve territorial të shtrirjes së kombit, në sistemin administrativë, në kulturë dhe në të gjithë sistemin ekzistues arsimor.
- Së dyti, krijimin e shkollave kombëtare shqiptare nga cikli i ulët dhe i mesëm deri në ciklet e larta dhe shpenzimin e një pjesë të të ardhurave që grumbulloheshin nga vjelja e taksave brenda vendit në dobi të mbajtjes dhe të përparimit të arsimit kombëtar.
- Së treti, mbrojtjen e njësisë së kulturës kombëtare, duke e vënë atë mbi ndasitë fetare e krahinore.
- Së katërti, autonomia territoriale, politike duhej të shërbente si një mbështetje për një progres të gjithanshëm material dhe shpirtëror të kombit, për t’u zhvilluar në rrugën e qytetërimit modern”⁵.

Me këtë përmbajtje programi arsimor-kulturor i Lidhjes së Prizrenit, si pjesë e pandarë e programit të saj të autonomisë politike territoriale, ndikoi fuqishëm në të gjitha drejtimet e luftës për zhvillimin e arsimit dhe kulturës kombëtare. Fakti që Lidhja nuk pati mundësi të vërë në jetë këtë program, nuk e mohon aspak rëndësinë e tij si për atë kohë, ashtu edhe në të gjithë përpjekjet e mëvonshme për zhvillimin e arsimit dhe kulturës kombëtare.

Kërkesa që “në shkolla të mësohet edhe gjuha shqipe” ishte në nivelin e kërkesave të ideologëve të Rilindjes. Kjo për faktin se në atë kohë, në qarqet intelektuale shqiptare, ishte i pranishëm edhe mendimi për nevojën e ekzistimit të shkollave osmane dhe konsiderohej se ajo ishte e pranueshme për Portën e Lartë.

Por, ekzistojnë një varg dokumentesh nga të cilat del qartë platforma arsimore e Lidhjes së Prizrenit, e drejtuesve të Lëvizjes Kombëtare: Sami Frashërit, Pashko Vasës, Jani Vretos, Konstandin Kristoforidhit etj., të cilët

⁴ Jashar Rexhepagiq, *Sami Frashëri dhe pedagogjia e Rilindjes Kombëtare*, botim i Akademisë së Shkencave dhe e Artave e Kosovës, Prishtinë: 1995, f. 20.

⁵ Alfred Uçi, “Lidhja Shqiptare e Prizrenit si faktorë kulturor në Rilindjen Kombëtare”, në: Grup autorësh, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, Tiranë: “Shtëpia Botuese e Librit Shkollor”, 110.

konsideronin se “pa zhvillimin e arsimit kombëtar, pa gjuhë shqipe të lëruar si gjuhë të kulturës, të shkencës dhe të shtetit shqiptar, nuk mund të jetësohet pavarësia, bashkimi dhe përparimi i atdheut”⁶.

Qysh në dokumentet më të para zyrtare të Lidhjes Shqiptare theksohej se kombi shqiptar kishte krijuar e ruajtur gjatë historisë së tij një kulturë me veçori të qarta kombëtare. Së këtejmi argumentohej domosdoshmëria historike e mbrojtjes së individualitetit dhe e origjinalitetit të kulturës së populli tonë. *“Shqipëria ka një faqe të lavdishme në historinë e kombeve, - thuhet në Memorandumin e 13 qershorit 1887* - që nga Skënderbeu gjer te Marko Boçari, që nga Lekë Dukagjini gjer te Ali Tepelena; ajo e ka ruajtur karakterin e vet kombëtar dhe amanetin e shenjtë të pavarësisë së saj. Shqiptari dhe kur luftonte në malet e veta për të mbrojtur vatrat atërore, edhe kur bënte luftë përkrah ushtrive të kombeve të tjera, ka qenë i ndarë, si në çadtrat, ashtu dhe në kohën e veprimit, sipas vijave të caktuara mirë, nga çdo ushtri tjetër që është radhitur nën flamurin e gjysmëhënës. Ky karakter kombëtar që nuk është përgënjeshtuar kurrë, dhe që ka luftuar ngadhënjimisht kundër egërsisë osmane për më shumë se katër shekuj, nuk mund dhe nuk duhet të zhduket tani, në këtë shekull qytetërimi, nga dora e areopagut evropian ...”*⁸.

Politika arsimore e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit gjeti një shprehje në pikësynime e drejtime arsimore të përcaktuara qartë, në veprimtari konkrete për të mbrojtur interesat arsimdashëse të popullit shqiptar, për shndërrimin e gjendjes arsimore në vend dhe në masa energjike për të zbatuar në jetë programin arsimor.

Lidhja nuk pati kohë të merrej drejtpërsëdrejti me hapjen e shkollave, për arsye se u përfshi në një luftë të vazhdueshme kundër Perandorisë Osmane, fuqive shoviniste ballkanike dhe shteteve imperialiste evropiane. Megjithatë, në këtë periudhë afër katërvjeçare, nga masat popullore dhe mendimtarët më të shquar të vendit dhe të lëvizjes kombëtare të tij u formulua qartë politika në fushën e arsimit. Kjo duket mirë në dokumentet e Lidhjes, siç janë:

⁶ Zekerie Cana, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë*, Prishtinë: “Rilindja”, 1979, f. 56.

⁷ * Memorandumi i është drejtuar kryeministrit të Anglisë, Disraelit (lordit Bikonsfild), është hartuar nga një grup atdhetarësh në Shkodër, emrat e të cilëve nuk i njohim dhe është dërguar në emër të popullit. [Shënim i autorit]

⁸ *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912* (më tej: *Akte të Rilindjes ...*), përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë, 1978, f. 24-25.

- Memorandumi i Prizrenit i nëntorit 1878.
- Programi i paraqitur nga Abdyl Frashëri në Kuvendin e Gjirokastrës në korrik të vitit 1880.
- Protestat.
- Letrat dhe memorandumet e popullit.
- Fjalimet, artikujt dhe letrat e Abdyl Frashërit.
- Vepra “*Apologjia*”, e Jani Vretos
- Vepra “*E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptaret*”, e Pashko Vasës;
- Artikujt e botuar në gazetën “*Zëri i Shqipërisë*” i Anastas Kulluriotit.

Mendoj se politika arsimore e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit duhet analizuar në tri pamjet e saj themelore. ***Së pari***, ajo e konceptoi autonominë territorial-administrative të lidhur ngushtë dhe të pandarë nga autonomia kulturore-arsimore e Shqipërisë; ***së dyti***, veprimtarinë politike e ushtarake nga veprimtaria kulturore-arsimore e organeve drejtuese të Lidhjes; ***së treti***, politika për arsimimin gjeti shprehje drejtpërsëdrejti në dokumentacionin e hartuar nga Lidhja.

Ky koncept gjeti shprehje drejtpërsëdrejti në dokumentacionin e hartuar nga Lidhja. Drejtuesit e saj e kuptonin shumë mirë së siguri i pavarësisë së atdheut nuk mund të arrihej pa zhvilluar arsimimin popullor dhe pa e bërë gjuhën shqipe të lëvruar kombëtare, gjuhë të shtetit shqiptar dhe të kulturës e të shkencës shqiptare.

Kështu, në *Memorandumin e pranverës së vitit 1877* drejtuar qeverisë së Stambollit, në, nga mbledhja e parisë së jugut të Janinës, kërkohej në të njëjtën kohë që “administrata, shkollat dhe gjuhët të ishin në gjuhën shqipe”⁹. Kjo kërkesë mori formë të plotë në *Memorandumin e 27 nëntorit 1878* të miratuar në mbledhjen plenare të Lidhjes në Prizren, e cila iu drejtua Portës së Lartë, dhe gjeti zbatim në vitet e veprimtarisë së Lidhjes më 1878-1881. Memorandumi theksonte në mënyrë të veçantë dhe me forcë se “armiqtë fqinjë, veç të tjerave, përpiqeshin për të ndërruar gjuhën dhe kombësinë e shqiptarëve”¹⁰. Po kështu, në pikën 2 të Memorandumi kërkonte që “nëpunësit të dinë shqip”, kurse në pikën 3 thuhej se “arsimi duhet të përhapët nëpër të gjitha anët dhe nëpër shkolla të mësohet dhe gjuha shqipe”¹¹. Veç kësaj, kërkohej që “një pjesë e të ardhurave të Lidhjes të shpenzoheshin për arsimin dhe punët botërore”¹². Ky dokument që në të vërtetë një kompromis ku kërkohej që të ruhej sistemi arsimor ekzistues dhe të përdore gjuha shqipe në shkolla.

⁹ *Po aty*, f. 11.

¹⁰ *Po aty*, f. 61-62.

¹¹ *Po aty*.

¹² *Po aty*.

Kërkesat për arsimin, më vonë Lidhja i përsëriti vazhdimisht. Kështu, në *Memorandumin e 9 korrikut 1879*, kërkohet që “t’i jepet mundësi popullit shqiptar që të qytetërohet dhe të hyjë në rrugën e përparimit”¹³.

Kërkesa për ruajtjen e pavarësisë politike, kulturore dhe të gjuhës përsëritet me forcë në *Promemorian e 18 majit 1880*, drejtuar konsujve të huaj në Shkodër¹⁴. E njëjta kërkesë ligjërohet edhe *Rezolutën e mbledhjes së Dibrës*^{15*}, që u mbajt më 20 tetor 1880¹⁶.

Për organizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të arsimit e të kulturës kombëtare, **Komiteti Shqiptar i Stambollit** krijoi një komision të veçantë, i cili u ngarkua të zgjidhte dy detyra të ngutshme dhe të rëndësishme: caktimin e një alfabeti të përbashkët për shqiptarët dhe formimin e një shoqërie qendrore kulturore¹⁷.

Zgjerimi i lëvizjes atdhetare në Shqipëri e bëri të domosdoshëm veprimtarinë e organizuar në fushën e arsimit dhe të kulturës, e cila u kurorëzua me themelimin **Shoqërisë e të Shtypurit Shkronja Shqip** në tetor 1879¹⁸. Kryetar i saj u zgjodh Sami Frashëri. Qëllimi kryesor i Shoqërisë, ishte “hapja e shkollave shqipe dhe lëvrimin e gjuhës amtare”¹⁹.

Kjo politikë arsimore gjeti përkrahje në masat e gjera të popullit. Këtë e dëshmojnë *protestat* dhe *memorandumet* e herëpashershme, që u drejtoheshin Fuqive të Mëdha evropiane, Kongresit të Berlinit, Portës së Lartë, konsujve të huaj dhe opinionit publik evropian. Në to theksohej se, “populli shqiptar preferonte më mirë të zhduket se sa t’u nënshtrohet të huajve dhe t’i mohoheshin gjuha, kombësia, zakonet dhe traditat, të cilat i ka ruajtur si të vetmet thesare, përmes rrebesheve të pushtimit të huaj në shekuj”²⁰.

Në veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, rol të rëndësishëm luajti

¹³ *Po aty*, f. 93.

¹⁴ *Po aty*, f. 136-139.

¹⁵ * Për shkak të divergjencave, Kuvendi i Dibrës doli me dy rezoluta: ajo e rrymës radikale me 130 vota, që kërkonte një autonomi të gjerë të realizuar me forcë dhe rezoluta e rrymës së moderuar me 150 vota, që kërkonte një autonomi të kufizuar dhe me pëlqimin e sulltanit. [Marrë nga: Kristo Frashëri, "Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare", në: *Studime historike*, Nr. 1, botimi i Institutit të Historisë, Tiranë, 1978, f. 39.]

¹⁶ G. autorësh, *Historia e Shqipërisë ...*, f. 125.

¹⁷ Rexhep Qosja, “Kolonja e Stambollit”, në: *Seminari i Kulturës Shqiptare për të huaj*, Nr. 4, Prishtinë, 1978, f. 201.

¹⁸ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)*, Fondi i Shoqërisë e të Shtypurit të Shkronjave Shqipe 1878-1882 (F.) - Nr. 101, Viti 1879 (V.), Dosja 1 (D.), fleta 2 (fl.).

¹⁹ Xhafer Belegu, *Lidhja e Prizrenit*, Shkodër, 1939, f. 41.

²⁰ G. autorësh, *Historia e Shqipërisë ...*, f. 183.

edhe **Komisioni për Punët e Brendshme**, i cili do të merrej me çështje që kishin të bënit me “rregullimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor në shkolla, për të shpërndarje e drejtë të të ardhurat dhe për ndërtime publike”²¹. Të gjitha këto do të ndikonin për të fuqizuar më shumë ndjenjat arsimdashëse në popull, si dhe për të shpeshuar veprimtarinë e hapjes së shkollave shqipe në të gjithë trevën shqiptare. Kjo pasqyrohet qartë edhe në *Promemorien drejtuar ambasadorit britanik në Stamboll*, ku ndërmjet të tjerash shkruhej se: “Shqiptarët janë të vendosur t’i këpusin të gjitha lidhjet me sundimin osman dhe kërkonte një administratë të veçantë, që u përgjigjet më tepër nevojave dhe aspiratave të tyre. Shqiptarët kërkojnë të drejtën të hyjnë në gjirin e familjes së madhe evropiane, pjesëtarë të cilës janë”²².

Gjithashtu, në *Raportin e përgatitur nga konsulli i Austro-Hungarisë*, më 7 gusht 1880, drejtuar qeverisë së vet, theksohet se: “Lidhja i largoi nëpunësit turq prej zyrave dhe i zëvendësoi me shqiptare, pa ndryshim feje”²³.

Po kështu, edhe relatuesit e Perandorisë Osmane pohojnë se, “devotshmëria kombëtare dhe patriotizmi midis shqiptarëve janë aq të forta, saqë ndryshimi në fe nuk mund t’i dobësojë aspak ato”²⁴. Për këtë arsye, Porta e Lartë shpejtonte të jepte udhëzime që në Shqipëri “të fillohej nga ato institucione e reforma, që kanë të bëjnë me arsimin, [...] pasi të vërehej se kryerja dhe zbatimi i tyre do të përputhej me gjendjen dhe me karakterin e popullsisë”²⁵. Por realiteti ishte krejt ndryshe, Porta e Lartë ndiqte po atë politikë që kishte ndjekur ndër vite, dhe kjo dukej kur ajo i bënte thirrje që “të hiqej dorë nga lufta dhe shqiptarët të merreshin me shtimin e pasurisë së vendit, me zhvillimin e tregtisë, bujqësisë e artizanatit, se dhe me përhapjen e diturisë dhe të arsimit, nënkuptohet, mesjetar turk”²⁶. Gjithashtu, të gjitha koncesionet e Perandorisë për përhapjen e arsimit, reduktohen në propozimin qesharake që “të hapej një shkollë ruzhdije në Burrel”²⁷.

Këtyre kushteve të vështira politike u shtohej edhe politika armiqësore

²¹ Iliaz Rexha, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe Porta e Lartë* (më tej: *Lidhja Shqiptare e Prizrenit ...*), botim i Institutit të Albanologjisë, Prishtinë, 2014, f. 85.

²² Koli Xoxi, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, Tiranë, 1978, f. 50.

²³ *Tercüman-I Şark*, No. 103, Istanbul, 3 Ağustos 1878.

²⁴ Iliaz Rexha, “Dega e Lidhjes së Prishtinës dhe veprimtaria e saj”, në: *Kosova*, botim i Institutit të Historisë, Prishtinë, 2004, f. 234.

²⁵ Bedri Dedaj, “Mendimi pedagogjik i Rilindjes Kombëtare Shqiptare” (më tej: “Mendimi pedagogjik ...”), në: *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, botim i Ministrisë së Arsimit dhe e Shkencës dhe Institutit të Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 2003, f. 114.

²⁶ *Po aty*.

²⁷ *Po aty*.

që ndiqnin në atë kohë ndaj Shqipërisë disa nga Fuqitë e Mëdha dhe nga monarkitë fqinje. Fuqitë e Mëdha, në përgjithësi, ishin për ruajtjen e hartës politike të Ballkanit që ato vetë kishin vendosur, prandaj përkrahnin ekzistencën e Perandorisë Osmane, ndërsa monarkitë fqinje ballkanike, sidomos Serbia e Greqia, u përmbaheshin gjithnjë pretendimeve të tyre shoviniste ndaj trojeve shqiptare²⁸.

2. Veprimtaria dhe mendimi pedagogjik i korifenjve të Rilindjes Kombëtare në vitet e Lidhjes Shqiptare

Rrethanat e reja politike ishin të papërshtatshme për të organizuar një kryengritje të armatosur të përgjithshme, prandaj atdhetarët rilindës i kushtuan vëmendje të veçantë ngritjes së mëtejshme të ndërgjegjes kombëtare të popullit nëpërmjet përhapjes së mësimi shqip, të shkollës kombëtare dhe të letërsisë shqiptare.

Për t'iu përgjigjur si duhej nevojave të Lëvizjes Kombëtare, veprimtaria e ideologëve të Rilindjes filloj të organizohej më mirë. Të gjithë rilindësit dhe atdhetarët shqiptarë, të cilët jetuan në mërgim në vise të ndryshme të Perandorisë Osmane, e sidomos ata të Stambollit, dhanë kontribut të merituar në organizimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, por vend të posaçëm zënë Abdyl Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vreto, Sami Frashëri, Konstadin Kristoforidhi, Koto Hoxhi, Anastas Kullurioti etj.

Aktiviteti i tyre në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare është i madh. Ata, me mendjemprehtësi të madhe e të pashoqe, i tejkalonin njohuritë osmane. Për këtë veprimtari dhe këtë aktivitet është i njohur dhe jo vetëm opinioni ynë shkencor dhe publicistik, por edhe ai osman-turk dhe evropian, diku më shumë e diku më pak. Gjithashtu, mendoj se kjo njohuri është e shumëllojshme sa u përket burimeve dhe literaturës në gjuhë të ndryshme të popujve evropiane. Veprimtaria e tyre është e lidhur edhe me krijimtari të vlefshme pedagogjike-didaktike, shkencore, artistike, dhe publicistike.

Mirëpo nuk mund të jemi të kënaqur me të gjitha ato që dimë për veprimtarinë e rilindëseve. Për ata ende jemi të interesuar të njihemi dhe të informohemi, jo vetëm për shumë veprat e tyre me vlerë politike, publicistike, shkencore, letrare e artistike, por edhe me ato të dimensionit më të gjerë që kanë të bëjnë me pedagogjinë.

Veprimtarinë e tyre na e përshkruan më së miri Bedri Dedja, Kristo Frashëri,

²⁸ Qamil Gexha, *Shtypi i Malit të Zi mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1873-1912*, Gjakovë: "Blini BK", 2003, f. 39-40.

Iliaz Rexha etj, në artikujt dhe studimet e tyre.

Duke shkruar për **Abdyl Frashërin**, nuk mund të lëmë pa përmendur problemin e arsimit në gjuhën shqipe i cili qe themelor për mendimin dhe veprimtarinë fjalën e tij. Pjekuria e Abdyl Frashërit ishte arritur shumë herët, por ajo u ngrit sidomos gjatë Krizës Lindore, pikërisht kur ishte zgjedhur si deputet për Janinë në Parlamentin e parë Osmanë^{29*}. Në këtë kohë filloi të aktualizohet çështja shqiptare, për të cilën u angazhua, në mënyrë maksimale, Abdyl Frashëri. Në fjalën e tij, të mbajtur në Parlamentin Osman mbi gjendjen e mjerueshme në Rumeli, Abdyl duke e ilustruar me shembullin e Shqipërisë, nxjerr në pah se: *“nuk kishte as një fshat në të cilën ekzistonte shkolla shqipe. Ai nuk i konsideronte mejtepet dhe medreset - shkolla të kohës, në të cilën kryesisht mësoheshin lëndë fetare”*³⁰. Ai insistonte me këmbëngulje që të zbatoheshin nenet e kushtetutës dhe rregulloret e vilajeteve për përhapjen dhe përparimin e arsimit e të kulturës edhe në gjuhën shqipe. Ai reagoi dhe kritikoi ashpër moszbatimin në jetë të ligjit për hapjen e shkollave nëpër viset shqiptare. Lidhur me arsimin ai shpreh edhe këtë mendim: *“Në botë çdo begati dhe lulëzim, që ka të bëjë me civilizimin njerëzor, është arritur me anë të arsimit”*³¹.

Abdyli kërkonte që të hapeshin shkolla, gjimnaze, shkolla të larta, akademi dhe universitete bashkëkohore sipas sistemit evropianë, në të cilën do të mësoheshin dhe studioheshin lëndët shoqërore, natyrore-shkencore. Koncepti i Abdylit mbi arsimin bashkëkohorë përputhej plotësisht me programin e Samiut për arsimin bashkëkohor të mbarë popullsisë, pa dallim kombëtare, fetar dhe klasor.

Aktiviteti maksimal Abdylit e vazhdoi në kohën e krizës dhe pas tij. Sipas burimeve osmane, ai u përpoq të parashtronte gjendjen e vështirë të shqiptarëve, para përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha, me anë të memorandumëve dhe peticioneve të hartuara me dorën e vetë, ua bënte me dije se ekzistonte kombi shqiptar, të cilët shtetet evropiane dhe Qeveria osmane, për shkak të interesave të tyre grabitqare, ia kishin mohuar të drejtën e ekzistimit dhe të identitetit të tij.

Në Memorandumin e 23 qershorit 1878, të cilën e hartoi Abdyl Frashëri së bashku me Mehmet Ali Vrionin, drejtuar Sulltanit, ai kërkonte nga Sulltani që kurrsesi të mos lejonte zbatimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit lidhur me dorëzimin e tokave shqiptare shteteve monarkiste ballkanike. Në këtë peticion, mes të tjerash, thuhej: *“Asnjë njeri nga viset shqiptare në asnjë mënyrë nuk do të pranojë që ndonjë pjesë nga tokat e shenjta të trashëguara nga stërgjyshërit*

²⁹ * Parlamenti qe jetë shkurtër, me që sulltan Abdyl Hamiti, pas një viti e shpërndaui parlamentin.

³⁰ AQSH, Fondi i Abdyl Frashërit 1881-1889 - Nr. 1, V. 1881, D. 1, fl. 1. Shih: I. Rexha, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit ...*, f. 113.

³¹ *Po aty*, f. 129.

e tyre, t'i dorëzohen tjetërkujt. Jemi të gatshëm që deri në fund të luftojmë për mbrojtjen e identitetit kombëtar dhe të integritetit tokësor të shqiptarëve"³².

Në kontekstin e aktivitetit gjithëkombëtar, që në mars të vitit 1878, një shqiptar (ka të ngjarë të ketë qenë vetë Vaso Pasha), ia dërgoi një përkujtesë ambasadorit britanik në Stamboll. Duke referuar në emër të tërë kombit, aty vihej në dukje se "po lind një çështje e re, çështja shqiptare"³³, dhe rrjedhimisht nga kjo, autori bënte të ditur se "edhe shqiptarët po kërkojnë me të drejtë futjen e tyre në gjirin e familjeve të mëdha evropiane, pjesë e së cilës janë"³⁴.

Me figurën e Pashko Vasës kemi të bëjmë me një rilindës të dalluar, me një vizionar të mendimit politik dhe me një përfaqësues të denjë të kulturës kombëtare shqiptare. Po ai, më 1871, bashkë me Sami Frashërin dhe Janin Vreton, vendosin themelet e një organizate atdhetare, për ta realizuar, më 1877, themelimin e **Komitetit Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare** dhe më 1879, **Shoqërinë e të Shtypurit Shkronja Shqip**.

Pikëpamjet e tij të avancuara, Pashko Vasa i shpalosi në planin letrarohistorik dhe politik. Ai shprehu shumë mendime progresive demokratike dhe republikane, disa herë antifeudale, antimonarkiste dhe antiklerikale³⁵. Kështu, poema, "*Mori Shqipëri e mjera Shqipëri*", mbeti ndër krijimet më të bukura në letërsinë e Rilindjes Kombëtare, ashtu siç ka mbetur me vlerë të madhe trajtesat historike dhe veprat e tij gjuhësore. Veprën "*E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët*"³⁶, ai e mbyll, ndër të tjera, me këto fjalë: "I harruar populli shqiptar, ne deshëm t'ua sillnim në kujtesë popujve të qytetëruar; i fyer, ne e mbrojtëm kundër dashaligësisë, i goditur nga shpifja ne u përpoqëm jepnim të drejtën që i takon"³⁷.

Në veprën e lartpërmendur, Pashko Vasa e trajton problemin e arsimit, duke akuzuar hapur Portën e Lartë, e cila ka lejuar shkollat greke në trevat shqiptare dhe ka penguar arsimin në gjuhën shqipe. Qeveria osmane, shkruan ai "nuk ka menduar kurrë të përkrähë dhe të përhapë arsimin popullor në një shkallë të

³² Iliaz Rexha, "Aktiviteti ideopolitik i vëllezërve Frashëri në periudhën e Lidhjes së Prizrenit", në: *Vjetari*, Nr. X-XI, botim i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Prishtinë, 1979, f. 322. BOA, Fondi, Dis Isleri Bakanlingi, Nr. 78.

³³ *Akte të Rilindjes ...*, f. 14-16.

³⁴ Vehbi Bala, *Pashko Vasa*, Tiranë: "8 Nëntor", 1979, f. 86-87.

³⁵ Vehbi Bala, "Pashko Vasa si ideologu i Lidhjes Shqiptare" (më tej: "Pashko Vasa si ideologu ..."), në: *Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881*, Vëll. I, Tiranë, 1979, f. 205.

³⁶ * Varianti i parë i kësaj vepre doli në Stamboll. [Marrë nga: "Etudes sur l'Albanie et les albanias par Wassa Efendi", in: *La Turquie*, Constantinople, 1879, pp. 103.]

³⁷ F. Shabani, *Mendimi politik ...*, f. 80-81.

gjerë dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë”³⁸, kështu ndodhi që edhe gjuha të mos arrijë të ketë literaturën e vet për të përhapur arsimin. Kështu është vepruar dhe në veri të Shqipërisë, vazhdon ai, ku qeveria otomane “s’ka bere asgjë për arsimin popullor” e ku kryesisht mësohet italishtja. Në këtë mënyrë, gjatë të gjithë shekujve të pushtimit turk, “arsimi popullor nuk beri as më të voglin përparim, për shkak të mungesës se institucioneve shkollore të krijuara në përputhje me nevojat e vendit”³⁹.

Pashko Vasa, si mendimtar përparimtar dhe atdhetar kërkoi që sistemi arsimor, i cili do të krijohej në Shqipëri, duhet të ketë karakter të thellë kombëtar, t’i përshtatet plotësisht psikologjise se shqiptarit dhe të synojë të zhvillojë inteligjencën, begatinë dhe fuqinë ushtarake të Shqipërisë. *“Kjo do të behet e mundur vetëm me bashkimin dhe shpalljen e pavarësisë; vetëm kështu mund të arrihet që arsimi popullor [...] të përhapet kudo, duke sjellë me vete përparimin, qytetërimin dhe rrjedhimisht begatinë dhe mirëqenien e përgjithshme”*⁴⁰. Ai vlerëson drejt dhe objektivisht rëndësinë, që ka vlerësimi i gjuhëve të huaja, qoftë dhe i greqishtes, italishtes etj., sepse ndihmojnë për të ndriçuar intelektin. Por Shqipëria ka nevojë për një sistem arsimor të vetin, në gjuhën amtare, ku gjuhët e huaja mos *“t’i sjellin dëm parimit të kombësisë që është dhe mbetet një dhe i pandarë për gjithë shqiptarët”*⁴¹.

Vepra “Apologji” e **Jani Vretos**, është një tjetër dokument i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, një manifest i vërtetë me përmbajtje në planin e mendimit politik të Rilindjes Kombëtare. Padyshim, paraqitja e Vretos në skenën politike e publicistike të asaj kohe zgjoi breshërinë e madhe te shqiptarët, ngase aktiviteti i tij nisi e përfundoi në kushtet tejet të vështira. Por, si një intelektual i formuar në frymën e humanizmit europian, Vreto si polemik, mbi të gjitha në *“Apologjinë”* e tij, mbeti një shembull i përsosur i vlerësimit objektiv, të argumentuar, racional e konstruktiv. Si iluminist ai e quan arsimin vendimtar për zhvillimin e Shqipërisë. Ai thekson se *“mjeti i vetëm i ndriçimit shpirtëror është gjuha dhe një komb, që nuk shkruan gjuhën e vet, jo vetëm nuk mund të ndriçohet, por përgjithësisht nuk mund as të ndihmojë me anë të gjuhës së tij në përparimin e shkencës dhe të qytetërimit”*⁴².

Në vargun e figurave të spikatura të rilindëseve që vepruan në epokën

³⁸ Kristo Frashëri, *Rilindja Kombëtare Shqiptare - Me rastin e 50-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë Kombëtare 1912* (më tej: *Rilindja Kombëtare ...*), Tiranë: “Naim Frashëri”, 1962, f. 30-31.

³⁹ *Po aty*.

⁴⁰ B. Dedaj, “Mendimi pedagogjik ...”, f. 117.

⁴¹ *Po aty*.

⁴² *AQSH, Fondi i Jani Vreto 1865-1970 - Nr. 21, V. 1865, D. 2, fl. 1-2.*

e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në Stamboll, në Misirin e largët, në Athinë, Anastas Kullurioti. Para së gjithash, Kullurioti, në qytetin e Athinës, e cila ishte edhe qendra e prapaskenave antishqiptare, do të botonte gazetën “*Φωνή της Αλβανίας*” (“Zëri i Shqipërisë”), padyshim zëdhënësin më të madh dhe me spirituoze të emancipimit politik të luftës së shqiptarëve, jo vetëm për autonomi, por edhe për pavarësi.

Duke pasur relacione të ngushta me rilindësit e tjerë, Anastas Kullurioti siguroi për shtyllat e organit të vet shkrimet e penave të dalluara të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Kështu, Thimi Mitko në “*Zëri i Shqipërisë*”, botoi vjershën “*Jo o shqiptar, ndë doni*”⁴³, pastaj vjershën “*Nxitje mbi shqiptarët, për të shkruajnë gjuhën e tyre*”⁴⁴, dhe sërisht vjershën me titull “*Të nxiturit’ e Shqipërisë turke përpieturë*”⁴⁵. Duke u mbështetur në të kaluarën e lavdishëm në faqet e atij organi shtypi, padyshim kombëtar. Në funksion të ngritjes së mëtejshme të ndërgjegjes kombëtare, botohte në formë fejtani, “*Historia e Skënderbeut*”, nga Paganelli, si studim i mirënjohur i Vaso Pashës, “*E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët*”⁴⁶.

Duhet theksuar se, “*Zëri i Shqipërisë*” u shqua si një gazetë qendrore edhe në përshkrimin e ngjarjeve më të rëndësishme politike, duke ia përcjell te shqiptarët dhe si një mjet informimi që asgjë nuk i shpëtonte pa shkruar në atë kohë. Kështu, në nëntor të vitit 1879, gazeta e Kulluriotit u bë e mirënjohur në Vilajetin e Janinës dhe përcillte me ëndje nga shqiptarët e konfesionit mysliman, por edhe atij ortodoks⁴⁷.

“Çështja shqiptare u trajtua edhe në gazeta e revista të tjera patriotike, si në: “*L’Albanese d’Italia*” (“Shqiptari i Italisë”) më 1848; “*Pellazgu*” më 1860. Këto organe botoheshin në gjuhë të huaj, italisht. Ndërkaq, përpjekjet e para për shtypin shqiptar filluan me “*Flamurin e Arbërit*”. Kjo ishte një gazetë mujore e kolonisë arbëreshe të Kalabrisë në Itali, e cila doli në vitet 1883-1887, në gjuhën arbëreshe, e drejtuar nga Jeronim De Rada. Në fund të shek. XIX, shtypi shqiptar pasurohet me organe të reja si: “*Shqipëria*” (Bukuresht, 1891-1899; “*Albania*” e Faik Konicës (Bruxell, 1897 dhe vazhdoi në Londër deri në vitin 1909); “*Drita*” (1901-1908) e Shahin Kolonjës dhe “*Mbrothësia*” e Kristo Luarasit në Sofje; “*Albania*” (Beograd, Trieste, 1905-1908); “*Kombi*” (Boston, 1906-

⁴³ *Φωνή της Αλβανίας*, No. 13, Αθήνα, 22 Δεκεμβρίου 1879.

⁴⁴ *Φωνή της Αλβανίας*, No. 20, Αθήνα, 12 Φεβρουαρίου 1880.

⁴⁵ *Φωνή της Αλβανίας*, No. 23, Αθήνα, 12 Φεβρουαρίου 1880.

⁴⁶ *Φωνή της Αλβανίας*, No. 26, Αθήνα, 16 Απριλίου 1880.

⁴⁷ F. Shabani, *Mendimi politik ...*, f. 80-81.

1908). Më vonë botohen: “*Dielli*”; “*Shqipëria*” (Kairo, Magoga, 1906-1908); “*Rrufeja*” (Egjypt, 1909), si dhe gazeta dhe revista të tjera atdhetare. Në vitet 1908-1910, doli gazeta “*Korça*” e drejtuar nga Sami Pojani dhe Lyfti Zavalani. Kjo ishte gazeta e parë shqipe në trevat shqiptare. Në këto tribuna kombëtare, intelektualët rilindës trajtonin çështjet jetike të kombit shqiptar, ku vend të rëndësishëm i kushtohet edhe arsimit dhe shkollës shqipe. Shtrohet nevoja për shkollë dhe libra shqip, për alfabet të përbashkët kombëtar⁷⁴⁸.

Mendoj se, lajmet mbi ngjarje të ndryshme që përmban shtypi i kohës kanë vlerën burimit të dytë, pa marrë parasysh shkallën e saktësisë, sepse shtypi, përkundër burimit të vërtetë, në atë kohë bëhet shprehje e dëshirës subjektive.

Politika arsimore e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u konkretizua në *aksione të mëdha kulturore* dhe në *vepra pedagogjike-didaktike*. Kështu, aktiviteti i Lidhjes për arsimin u dendësua veçanërisht në muajt qershor-tetor 1879, në diskutimet për alfabetin dhe me krijimin e **Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip**. Në “*Kanonizmën*” e kësaj shoqërie, ndër të tjera, thuhet: “Gjithë sa kombe janë të ndrituarë dhe të qytetëruarë, janë ndrituarë dhe qytetëruarë prej shkronjash ndë gjuhë të veta. Edhe çdo komb, që nuk ka shkruarë gjuhën e vet, edhe s’ka shkrinjë ndë gjuhën e vet, është ndë t’errët dhe barbar. Edhe shqiptarët [...] mendonën dhe s’thënë këtë të madhe të keqe, s’thënë dhe të madhe nevolë të shkruanjënë gjuhën edhe të kenë shkronja e të këndonjënë ndë gjuhët e tyre. E kështu kënetë shoqëri shqyptrësh për të shtypurë shkronja shqip⁷⁴⁹.”

Një fitore e madhe e asaj lëvizje me qendër veprimi në Stamboll, ishte padyshim aprovimi i alfabetit të sprovuar të Sami Frashëri, i njohur me emrin Alfabeti i Stambollit. Ky akt i rëndësishëm në fushën e arsimit dhe të kulturës së Rilindjes u bë edhe më madhështor, ngase ajo u arrit si fryt i punës kolektive dhe i përpjekjeve shumëvjeçare⁵⁰. Duke u nisur nga parimi që “çdo shkronjë të ketë vetëm një tingull dhe për një tingull një shkronjë me vete”, alfabeti i Stambollit u bë alfabet qendror i Rilindjes Kombëtare, në kuadrin e aktivitetit botues në dy dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XIX. Që këtë shumë shpejtë gjeti zbatim praktik edhe në Shqipërinë e Jugut, edhe pse nuk duhet të harrojmë se autoritet kishtarë greke të asaj kohe bënë përpjekje të pengonin përdorimin e saj.

Tre muaj pas përcaktimit të abesë, kryesisht mbi bazën e shkronjave latine, u

⁴⁸ Gaetano Petrota, *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*, përktheu nga origjinali Qemal Velija, Tiranë: “Almeira”, 2008, f. 369-387.

⁴⁹ K. Frashëri, *Rilindja Kombëtare ...*, f. 167-168.

⁵⁰ A. Bala, *Pashko Vasa*, f. 80.

botua *“Alfabetorja e gjuhës shqipe”*, me rreth 136 faqe⁵¹. Duke u botuar brenda afatit sa më të shkurtër, me ndihmën e pakursyer të S. Frashërit, J. Vretos, P. Vasës dhe të K. Hoxhit, ajo e çoi akoma më përpara idenë e avancimit të kombit shqiptar, drejt procesit të unifikimit, pa dalim krahine dhe përkatësie fetare. Po kështu, me rëndësi të madhe ishte fakti se *“Alfavitari”*, si dokument kulturor e politik në frymën kombëtare, u shtrua në kundërshtim me politikën përçarëse e asimiluese të Portës dhe të propagandës greke në veçanti, që vazhdonte t’i identifikonte të gjithë shqiptarët ortodoks si grekë. Si kundra peshë e kësaj politike, Sami Frashëri brenda *“Alfavitari”* botoi artikullin me titull *“Gjuha shqipe”*, e cila mund të konsiderohet si një manifest monumental, ku ndërmjet të tjerash, shkruante: “gjithë ata njërës që gjenden në një vëntë, e flasënë një gjuhë, edhe që kanë një palë zakone e një farë të roituri, thuhet një komb”⁵².

Gjithashtu, *“Alfavitari”* është një tjetër dokument kryesor e më i rëndësishëm i platformës arsimore, sinteza e mendimit arsimor, pedagogjik e didaktik te viteve të Lidhjes, që ilustron edhe me qartë politiken e saj në fushën e arsimit kombëtar. *“Alfabetarja”* nuk është thjesht një libër leximi. Ajo i kalon shumë këta kufij, është një përmbledhje e plotë tekstesh për shkollën fillore, për arsimin e fëmijëve dhe të rriturve; është njëkohësisht edhe një dokument didaktik-arsimor dhe teorik-pedagogjik i kësaj periudhe, ku pasqyrohen pikëpamjet e mendimtarëve dhe ideologëve më të shquar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit⁵³.

“Alfabetarja e Stambollit”, në të cilën u mishëruan atdhetarizmi, dituria dhe mendimi pedagogjik e didaktik i Sami Frashërit, Jani Vretos, Pashko Vasës dhe Koto Hoxhit, përfshin në tërësi abetaren, gramatikën, historinë, gjeografinë aritmetikën, diturinë e natyrës dhe mësimin e moralit, pra të gjitha tekstet e lendeve, që mund të përfshinte plani mësimor i një shkollë elementare shqiptare, thellësisht popullore për atë kohë. Nëpërmjet këtyre teksteve, autorët përçojnë edhe didaktikën e tyre dhe, veçanërisht, pikëpamjet pedagogjike.

Te *“Shqypnia e Shqyptarëve”*, që është në të njëjtën kohë edhe një tekst elementar i historisë së Shqipërisë, Pashko Vasa e quan mësimin kushtin themelor të zhvillimit psikik intelektual dhe fizik të brezit te ri, mjetin e edukimit patriotik. *“Për këtë punë, - shkruante ai, - na ju themi dit e nat me çue djelmt e vashat në shkollë, a bollë që të mësohen e të zan’ me ligjërue e me shkue e me u ba të ditçëm”*⁵⁴.

Gjithashtu, mendimtari Jani Vreto shtjellon pikëpamjet e tij për mësimin dhe

⁵¹ AQSH, Fondi i Komitetit Qendror i Kostandinopojës 1867-1867 - Nr. 101, V. 1867, D. 1, fl. 1.

⁵² Sami Frashëri, “Gjuha shqipe”, në: *Alfabetare e gjuhës shqipe*, Kostandinopojë, 1879, f. 24.

⁵³ B. Dedaj, “Mendimi pedagogjik ...”, f. 117-118.

⁵⁴ AQSH, Fondi i Pashko Vasa 1881-1939 - Nr. 61, V. 1881, D.2, fl. 3. Shih: V. Bala, “Pashko Vasa si ideologu ...”, f. 206-207.

edukatën morale. Sipas tij, “të mësuarit e të drejtave dhe të vërtetave, nevojiten për të drejtuar trupin në punë, për të rritur mirëqenien, për të fituar profesionin e jetës. Të mësuarit është pa kufi, ai duhet zhvilluar gradualisht, duke nisur nga me te thjeshtat, me te nevojshmet dhe me te vlefshmet. Të mësuarit vazhdon grithe jetën dhe për të duhet sakrifikuar edhe gjumi i natës. [...] Çdo brez duhet t’i japë më shumë arsim brezit të ri që vjen, në krahasim me vetveten. Të mësuarit është baza e edukatës morale. Fëmijët duhet t’i mësojmë dhe t’i edukojmë që të falin jetën për atdheun, të duan prindërit, të kalisin trupin, të shporrin dembelizmin dhe të duan punën”⁵⁵. Ai e sheh brezin e ri të popullit shqiptar, si krijuesin e përparimit dhe të diturisë së Atdheut në të ardhmen, kur thotë: “Tani, o djalë, o bir, çun e vashëz ç’ të jesh, mba vesh dhe dëgjo. [...] Shiko të msojshme përpara shkronja që të mund të këndojshe dhe të përvetësosh të drejtat, që kanë gjetur dhe shkruar të tjerët përpara teje, [...] edhe të shkruajsh edhe ti nde mundesh të shtojsh gjëkafshë nde diturinë, që mësove prej të tjerësh...”⁵⁶.

Një vit pas mbledhjes historike të 10 qershorit 1878, dhe disa muaj pas Memorandumit të nëntorit 1878, ku formulohej qartë nevoja për mësimin e shqipes, ideologët e Lidhjes vunë në qarkullim me tirazh prej 20.000 kopjesh “*Alfavitari*”⁵⁷. Kjo qe shprehje e politikës largpamëse të tyre. Ajo ishte platforma e pedagogjisë dhe e didaktikës kombëtare, për atë kohë.

Gjatë vitit 1880, Porta e Lartë kaloi në një reaksion të hapur kundër lëvizjes kulturore dhe arsimore shqiptare. Administrata e saj ndërhyri (me ashpërsi dhe kërcënime) për të ndaluar veprimtarinë e “*Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip*”. Ajo nuk dha leje për botime librash, as për krijim degësh, as për ngritje shkollash shqipe. Në këtë rrethanë, “*Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip*” nuk pati mundësi ta zhvillonte veprimtarinë e saj kulturore brenda Perandorisë Osmane, dhe as në Shqipëri. Ndjekjeve u shpëtoi vetëm dega e “*Shoqërisë së Shkronjave*” në Bukuresht të Rumanisë, e cila më vonë luajti një rol të rëndësishëm për realizimin e programit kulturor dhe arsimor të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Madje, pasi shtypen me gjak kryengritjen e popullit tonë më 1881, pushtuesit iu sulën arsimit në gjuhën shqipe për të arritur shkombëtarizimin kulturor të shqiptareve.

Në këtë kohë, Turqia bëri çmos për të penguar çdo përparim intelektual në Shqipëri, duke mos lenë asgjëkund shenjë të shkollës shqipe, duke mos lejuar në shkollat turke të kohës në territorin shqiptar të përmendej as emri shqiptar dhe as emri i Skënderbeut.

Por, duke njohur interesin kombëtar dhe duke e vendosur në themel të

⁵⁵ *Po aty*.

⁵⁶ *Po aty*.

⁵⁷ B. Dedaj, “Mendimi pedagogjik ...”, f. 119.

politikës shqiptare, me të drejtë mund të themi se politika arsimore e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte politika e një kombi të ri, që tashëm kishte ndër forcën e tij, që ishte kalitur në disfata e në fitore dhe që kishte fituar përmes tyre besimin e palëkundur në ngadhënjimin e çështjes së tij të drejtë. Këtë besim e shprehu qartë ideologu i Lidhjes Shqiptare Sami Frashëri kur tha: “Kush të na dal përpara e të na ndalojë në këtë udhë të shenjtëruar, ta shtyjme, ta rrëzojmë, ta shkelim e të shkojmë më tutje”⁵⁸.

Përfundime

Shembulli i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, i rolit dhe i rëndësisë së gjerë, në thelb pa dyshim progresiv historik, shoqëror-politik, kombëtar, ekonomik e juridik, e gjithësesi edhe i vlerave të saj kulturore edukative-arsimore, na jep mundësin të nxirren edhe disa qëndrime e rezultate shkencore të përgjithshme, si më poshtë:

E para, Lufta dhe liria e arsimimit gjatë më pak se katër vjet (1878-1881) ishin jo vetëm të lidhura në mënyrë të pashkëputshme, por përbënin një tërësi unike ku gërshetoheshin vërtetë pikëpamjet e përmbajtjes. Shtresave progresive e borgjezisë tregtare shqiptare dhe inteligjenca jo aq e madhe me armë e pendë në dorë përmes *Statutit* (Kararnamesë) dhe *Udhëzimeve të Pleqësisë së Lidhjes*, në *Memorandumin e Shkodrës* (13 qershor 1878), me anë të *deklaratave të Lidhjes Shqiptare në Jug* dhe përmes *dokumenteve të tjera*, zhvilluan luftën kundër pushtetit osman dhe synimeve pushtuese të disa borgjezive të vendeve të Ballkanit, për realizimin në jetë të vendimeve të Lidhjes, ndër të cilat edhe vendimet për hapjen e shkollave shqipe, mbi arsimin në gjuhën shqipe, sigurimin e kushteve materiale të tjera që këto shkolla të mund të ekzistonin e të zhvilloheshin më tej.

E dyta, rezultat është se kjo ngjarje dhe lëvizje më e rëndësishme shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX nuk një gjë e shkëputur dhe e izoluar nga ngjarjet shoqërore e politike në suaza më të gjera, madje edhe në përmasa botërore⁵⁹, ndërsa Lidhja e Prizrenit më së paku mund të shpjegohet, madje edhe të kuptohet thelbi dhe rëndësia e saj, nëse nuk merren parasysh gjithë ato trazira, e kohë pas kohe edhe konflikte të armatosura të popullit shqiptar për çlirimin e vet jo vetëm në prag të Lidhjes, por edhe gjatë viteve ‘40 të shek. XIX e më parë.

E treta, i rëndësishëm pa dyshim i fuqishëm ishte dhe veprimtaria ideologjive

⁵⁸ Sami Frashëri, *Vepra 4*, Prishtinë: “Rilindja”, 1978, f. 141. Zija Xholi, Sami Frashëri (Monografi).

⁵⁹ * Çështja Lindore dhe Kongresi i Berlinit. [Shënim i autorit]

të Rilindjes Shqiptare gjatë viteve '70 e '80, e cila gjeti pasqyrim në veprat pedagogjike-didaktike e të cilëve meritojnë një studim të gjithanshëm, objektiv dhe të dokumentuar. Mund të themi se jo të gjithë ata ishin marrë njësoj me çështje pedagogjike, e as që kishin trajtuar çështje të ndryshme didaktike, e në veçanti të shkollave, por është fakt se ata kishin mjaft qëndrime të ngjashme, e shpeshherë edhe pothuajse krejtësisht identike. Pra, atyre u takojnë meritat për zhvillimin e praktikës shkollore, madje dhe të teorisë pedagogjike bashkë me të gjitha karakteristikat e saj.

E katërta, është fakt se Lidhja Shqiptare e Prizrenit, jo vetëm që u mbështet, u përkrah dhe u nxit nga veprimtaria e përfaqësuesve të Rilindjes, por për nga përmbajtja, qëllimi dhe rezultatet e saj. Lidhja ushtroi një ndikim të jashtëzakonshëm të fuqishëm pedagogjik, letrar dhe kulturor në përgjithësi në një mënyrë të konsiderueshme përfaqësuesish të mendimit pedagogjik e të veprimtarisë shkollore shqiptare me orientim progresiv e demokratik. Përveç kësaj, Lidhja e Prizrenit ushtroi një ndikim të fortë pedagogjik në një plejadë krijuesish të mëvonshëm jo vetëm letrarë, mbi autorët e veprave historike, sociologjike e filozofike, por dhembti shumë krijues në fushat e artit, e në veçanti tek mësuesit e shkollave. Përmendim këtu: Gjerasim Qeriazhi, Petro Nini Luarasi, Sevasti Qiriazhi, Papa Kristo Negovani, Dervish Hima, Hasan Prishtina, Mati Logoreci, Aleksandër Xhuvani, Luigj Gurakuqi, Babë Dudë Karbunara, Qamil Bala, Sali Nivica, Salih Çeka e shumë të tjerë, që kanë lënë një fond shumë të pasur pedagogjik, e të dokumentuar me përgjegjësi, historike-pedagogjike mbi bazën e të cilit mund të nxjerrim në të ardhmen përfundime më sintetike.

Së pesti, Lidhja e Prizrenit dhe misioni i saj pedagogjik nuk duhet zmadhuar e fetishizuar. Ajo nuk shkoqiti në mënyrë të hollësishme shumë çështje që kishin të bënit me zhvillimin e pedagogjisë, dhe për pasoj nuk solli një sistem pedagogjik e të tërësishëm. Dihet gjithashtu, që Lidhja gjatë kohë së ekzistencës së vet nuk mundi aq lehtë e shpejtë t'i realizonte në jetë një varg të tërë kërkesash pedagogjike të tjera, në radhë të parë për shkak të një varg kundërshtimesh e pengesash që ekzistonin asokohe e në vitet e mëvonshme.

Sidoqoftë, mendoj se brenda fushës së historisë kombëtare të shkollave dhe të ideve pedagogjike të shqiptarëve, Lidhja Shqiptare e Prizrenit zë pa dyshim një vend të veçantë dhe ka një rol të padiskutueshëm në periodizimin, çka do të thotë edhe në luftën për themelimin e shkollave, masivizimin e tyre gjithnjë më të madh dhe në rezultatet e kësaj lufte të gjatë në trevat shqiptare deri më 1881.

CONCLUSIONS

The example of the Albanian League of Prizren, of the role and of the great importance, essentially undoubtedly historical, social-political, national, economic and juridical progressive, and of its cultural and educational values, also gives us the opportunity to draw some views and general scientific results, as follows:

The first, War and Freedom of Education during less than four years (1878-1881) were not only unrelated but consisted of a unique set of realistic content views. The progressive strata of the Albanian bourgeoisie trade and the not so great intelligence with arms and feather in hand through the Statute (Karnames) and the Leadership Guidelines of the League, in the Memorandum of Shkodra (June 13, 1878), through the statements of the Albanian League in the South and through other documents, developed the struggle against Ottoman power and the invasive intentions of some bourgeoisie of the Balkan countries for the realization of the League decisions, including the decisions on the opening of Albanian schools, education in Albanian language, provision of conditions other materials that these schools could have existed and developed further.

Second, the result is that this most important Albanian event and movement during the second half of the 20th century. XIX is not a disconnected and isolated from social and political events in wider proportions, even in global dimensions, while the League of Prizren can at least be explained, even to understand its essence and significance, if not consider all these riots, and from time to time the armed conflicts of the Albanian people for their liberation not only on the eve of the League but also during the 1940s. XIXth ago.

Third, important, certainly powerful was the activity of the Albanian Renaissance ideals during the 1970s and 1980s, which found reflection in pedagogical-didactic works deserving a comprehensive, objective and documented study. We can say that not all of them were treated equally pedagogically, nor did they deal with various didactic issues, especially in schools, but it was a fact that they had quite similar and often almost identical identities. So they are worthy of the development of school practice, even of pedagogical theory, along with all its features.

Fourth, it is a fact that the Albanian League of Prizren not only relied, supported and encouraged by the activity of the Renaissance representatives, but by its content, purpose and results. The relationship exerted an extraordinarily powerful pedagogical, literary and cultural impact in a significant way to representatives of pedagogical thought and activity of Albanian school with progressive and democratic orientation. In addition, the League of Prizren

exerted a strong pedagogical influence on a constellation of not only literary creators, authors of historical, sociological and philosophical works, but also very creative in the fields of art, and in particular in school teachers. We mention here: Gjerasim Qeriazi, Petro Nini Luarasi, Sevasti Qiriazi, Papa Kristo Negovani, Dervish Hima, Hasan Prishtina, Mati Logoreci, Aleksandër Xhuvani, Luigj Gurakuqi, Babë Dudë Karbunara, Qamil Bala, Sali Nivica, Salih Çeka and many others have left a very rich pedagogical fund, documented with responsibility, historical-pedagogical, on the basis of which we can come up with more synthetic conclusions in the future.

Fifthly, the League of Prizren and its pedagogical mission should not be magnified and fetishized. It did not elaborate in detail many issues related to the development of pedagogy, and consequently did not bring about a complete pedagogical system. It is also known that the League during its existence was not so easy to implement a whole range of pedagogical requirements in the first place because of a series of objections and obstacles that existed at that time in the years later.

However, I think that within the field of national school history and pedagogical ideas of Albanians, the Albanian League of Prizren undoubtedly has a special place and has an indisputable role in periodization, which is to say in the struggle for the establishment of schools, their ever greater massivization and the results of this long war in Albanian territories until 1881.

BIBLIOGRAFIA

I. Arkivat

- *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)*
- Fondi i Shoqërisë e të Shtypurit të Shkronjave Shqipe, vitet 1878-1882
- Fondi i Jani Vreto, vitet 1865-1970
- Fondi i Komitetit Qendror i Kostandinopojës, vitet 1867-1867
- Fondi i Pashko Vasa, vitet 1881-1939

II. Burime të botuara

- *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912*, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë, 1978

III. Organe shtypi

- *La Turquie*, Constantinople, 1879
- *Tercüman-I Şark*, No. 103, Istanbul, 1878
- *Φωνή της Αλβανίας*, No. 13, Αθήνα, 1879, 1880.

IV. Literatura

- Bala, Vehbi: “Pashko Vasa si ideologu i Lidhjes Shqiptare”, në: *Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881*, Vëll. I, Tiranë, 1979
- Bala, Vehbi: *Pashko Vasa*, Tiranë: “8 Nëntor”, 1979
- Belegu, Xhafer: *Lidhja e Prizrenit*, Shkodër, 1939
- Cana, Zekerie: *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë*, Prishtinë: “Rilindja”, 1979
- Dedaj, Bedri: “Mendimi pedagogjik i Rilindjes Kombëtare Shqiptare”, në: *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, botim i Ministrisë së Arsimit dhe e Shkencës dhe Institutit të Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 2003
- Frashëri, Kristo: “Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”, në: *Studime historike*, Nr. 1, botimi i Institutit të Historisë, Tiranë, 1978

- Frashëri, Kristo: *Rilindja Kombëtare Shqiptare - Me rastin e 50-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë Kombëtare 1912*, Tiranë: “Naim Frashëri”, 1962
- Frashëri, Sami: “Gjuha shqipe”, në: *Alfabetare e gjuhës shqipe*, Kostandinopojë, 1879
- Frashëri, Sami: *Vepra 4*, Prishtinë: “Rilindja”, 1978
- Gexha, Qamil: *Shtypi i Malit të Zi mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1873-1912*, Gjakovë: “Blini BK”, 2003
- Grup autorësh, *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, Prishtinë: “Sprint”, 2001
- Petrota, Gaetano: *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*, përktheu nga origjinali Qemal Velija, Tiranë: “Almeira”, 2008
- Qosja, Rexhep: “Kolonia e Stambollit”, në: *Seminari i Kulturës Shqiptare për të huaj*, Nr. 4, Prishtinë, 1978
- Rexha, Iliaz: “Aktiviteti ideopolitik i vëllezërve Frashëri në periudhën e Lidhjes së Prizrenit”, në: *Vjetari*, Nr. X-XI, botim i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Prishtinë, 1979
- Rexha, Iliaz: “Dega e Lidhjes së Prishtinës dhe veprimtaria e saj”, në: *Kosova*, botim i Institutit të Historisë, Prishtinë, 2004
- Rexha, Iliaz: *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe Porta e Lartë*, botim i Institutit të Albanologjisë, Prishtinë, 201
- Rexhepagiq, Jashar: *Sami Frashëri dhe pedagogjia e Rilindjes Kombëtare*, botim i Akademisë së Shkencave dhe e Artave e Kosovës, Prishtinë: 1995, f. 20.
- Shabani, Fahredin: *Mendimi politik në Rilindjen Kombëtare Shqiptare 1881-1912*, botimi i Institutit Albanologjik, Prishtinë: “Shtypshkronja KGT”, 2011
- Uçi, Alfred: “Lidhja Shqiptare e Prizrenit si faktorë kulturor në Rilindjen Kombëtare”, në: Grup autorësh, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, Tiranë: “Shtëpia Botuese e Librit Shkollor”, 1979
- Xoxi, Koli: *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, Tiranë, 1978

Dr. Joachim MATZINGER & Dr. Monica GENESIN

GJUHA SHQIPE DHE GJENDJA GJUHËSORE NË EPOKËN E SKËNDERBEUT

Abstract

Me këtë synim le të hedhim një vështrim mbi gjendjen gjuhësore në antikitet. Në fund të antikitetit, rreth shekullit të gjashtë pas Krishtit, shumëgjuhësia në Shqipëri zgjerohet me një komponente shtesë, sepse që nga ajo datë u shpërnda gradualisht idioma sllave dhe kjo shpërndarje e gjerë e gjuhës sllave në zonën e Shqipërisë pohohet edhe nga shumica e toponimeve që kanë origjinën sllave e të cilat mund të gjenden në të gjithë territorin e Shqipërisë, nga veriu deri në jug. Më në fund, në shekullin 14-të dhe në shekujt e pastajmë si rezultat i sundimit osman shtohet edhe gjuha osmane në Shqipëri, si kudo në Evropën Juglindore, që bëhet një mjet komunikimi shumë i rëndësishëm. Kjo shumëgjuhësi si rezultat i ngjarjeve gjeopolitike në Shqipërinë para-moderne reflektohet edhe në hapësirën publike. Megjithatë shqipja nuk ishte një gjuhë zyrtare me karakter publik, ajo ishte gjuha e një pjese të madhe të njerëzve në territorin e Shqipërisë. Pikërisht në periudhën e Skënderbeut u vunë për herë të parë themelet e shkrimit të gjuhës shqipe.

1. Kur shikojmë territorin e Shqipërisë, del qartë se është një hapësirë, në të cilën historikisht u takuan gjithmonë gjuhë të ndryshme. Kjo larmi gjuhësh është në fund të fundit një tipar përcaktues për Shqipërinë, i cili vlen në mënyrë të pakushtëzuar deri në ditët e sotme. Me këtë synim le të hedhim një vështrim mbi gjendjen gjuhësore në antikitet. Dhe në fakt, bazat e kësaj shumëgjuhësie i gjejmë në antikitet, sepse përveç idomeve lokale, të cilat duam t'i quajmë thjesht „idiome ilire“, në territorin e Shqipërisë së sotme fliteshin edhe greqishtja dhe që nga shekulli i dytë para Krishtit edhe latinishtja. Edhe këtu në Durrës mund të shihet këtë fenomen fare mirë. Me një vizitë në Muzeun Arkeologjik të Durrësit, ku ruhen mbishkrime të shumta greke e latine, në të cilat janë regjistruar antroponime lokale, shohim

një dëshmi elokvente për shumëgjuhësinë e lartëpërmendur.

2. Në fund të antikitetit, rreth shekullit të gjashtë pas Krishtit, shumëgjuhësia në Shqipëri zgjerohet me një komponente shtesë, sepse që nga ajo datë u shpërnda gradualisht idioma sllave dhe kjo shpërndarje e gjerë e gjuhës sllave në zonën e Shqipërisë pohohet edhe nga shumica e toponimeve që kanë origjinën sllave e të cilat mund të gjenden në të gjithë territorin e Shqipërisë, nga veriu deri në jug, që na tregojnë qartë për shembull emri i vendit *Velipojë* në veri dhe emri i vendit *Goricë* në jug. Në këtë mënyrë u vunë themelet për shumëgjuhësinë historike në Shqipërinë para-moderne, e cila përbëhet nga komponentet e mëposhtme.
 - (i) Gjuhët pasardhëse të latinishtes në dy ose tre variante:
 - (a) në zonën e detit Adriatik dhe në qytete, ku ndoshta është zhvilluar një variant i gjuhës dalmate, që më vonë është zëvendësuar nga dialekti venecian dhe
 - (b) arumunishtja, gjuha e barinjve transumantë.
 - (ii) Sllavishtja.
 - (iii) Greqishtja.
 - (iv) Shqipja.

Më në fund, në shekullin 14-të dhe në shekujt e pastajmë si rezultat i sundimit osman shtohet edhe gjuha osmane në Shqipëri, si kudo në Evropën Juglindore, që bëhet një mjet komunikimi shumë i rëndësishëm.

Si dëshmi për gërshetimin gjuhësor mes gjuhës greke, romane dhe sllave në Shqipëri mund të përmendet për shembull mbishkrimi trigjuhësor i princit Karl Thopia nga viti 1381 në manastirin e Shën Gjon Vladimirit. Në këtë mbishkrim trigjuhësor princi Thopia njofton në latinisht, greqisht dhe serbisht për restaurimin e ndërtesës së shenjtë.

Pastaj ekzistojnë letra dhe dokumente nga kancelaritë e principatave lokale në territorin e Shqipërisë, ndonjëherë në greqisht, latinisht ose serbisht.

Së fundi mund të përmendim statutet e Shkodrës, një dokument i jashtëzakonshëm që na tregon përdorimin e dialektit venecian si gjuhë e administratës të paktën për qytetarët e këtij qyteti.

Pra peisazhi gjuhësor në Shqipërinë para-moderne ishte shumë i larmishëm dhe gjuha e përdorur zyrtare ishte një mjet komunikimi i përdorur në mënyrë pragmatike për shkak të komunikimit me botën mbrenda dhe jashtë Shqipërisë. Prandaj, gjuha, qoftë greke, romane, sllave, apo shqipe ishte një element unifikues, që së bashku me karakteristika të tjera mund të shprehte edhe identitetin e grupit, por, në atë kohë, gjuha sigurisht nuk kishte ndonjë funksion përjashtues.

3. Kjo shumëgjuhësi si rezultat i ngjarjeve gjeopolitike në Shqipërinë para-moderne reflektohet edhe në hapësirën publike. Siç kemi përmendur më parë: greqishtja, serbishtja, latinishtja dhe dialekti venecian, si gjuhët e kancelarive lokale shqiptare karakterizojnë peizazhin gjuhësor të Shqipërisë. Kjo vlen edhe për dinastinë e Kastriotëve. Kancelaria e Gjon Kastriotit, ose siç quhet në dokumentet origjinale e Ivan Kastriotit, babait të Skënderbeut, na ka trashëguar dokumente në greqisht dhe serbisht, që ishin gjuhët e kësaj kancelarie. Edhe për Skënderbeun na tregon biografi i tij, Marin Barleti, se ai ishte një poliglot, i cili fliste ose njihte turqishten, arabishten, greqishten, italishten dhe sllavishten – dhe natyrisht edhe shqipen.
4. Megjithëse shqipja nuk ishte një gjuhë zyrtare me karakter publik, ajo ishte gjuha e një pjese të madhe të njerëzve në territorin e Shqipërisë. Pikërisht në periudhën e Skënderbeut u vunë për herë të parë themelet e shkrimit të gjuhës shqipe. Por, siç dihet, ky akt shkrimi i gjuhës shqipe nuk ishte asnjë akt krijimi letrar, ose përkthimi biblik në gjuhën e folur, por një pasojë nevojë. Sepse si rezultat i pushtimit osman kisha katolike kishte shumë humbje të rënda, si për shembull, një mungesë e gjerë e klerikëve që i njihnin mirë dhe në mënyrë konforme ritet dhe dogmat e konfesionit katolik. Për ta forcuar dhe për ta ruajtur besimin katolik dhe mbi të gjitha për t’i shpëtuar shpirtit e porsalindur u lejua, që formula e pagëzimit — që ndryshe është folur nga prifti në latinisht — të flitej nga prindërit edhe në gjuhën shqipe, pasi ata zakonisht nuk e njihnin latinishten. Dhe kështu ishte vetëm Kryepeshkopi i Durrësit dhe këshilltari i ngushtë i Skënderbeut, Pal Engjëlli apo Paulus Angelus nga Drishti, i cili e shkroi fjalinë e parë shqipe në veprën e tij *Constitutiones Ordinationes et Statuta* në vitin 1462: *un të pagësonjt pr'emënit atit et birit et shpërtit shënjt*.
5. Natyrisht duhet të vihet në dukje, se kjo fjali e parë shqipe është e pandashme nga konteksti katolik i Shqipërisë së Veriut dhe nga autori i saj, i cili jo vetëm ka lindur në këtë kontekst, por si një klerik punonte afërsisht edhe krejt në këtë kontekst. Prandaj, nuk është rastësi se u zgjodh alfabeti latin për ta shkruar këtë shprehje që edhe simbolizon — me vetëdije, apo ndoshta në këtë shkrim të hershëm dhe pa vetëdije — përkatësinë e shkrimit shqip me rrethin kulturor perëndimor, domethënë me traditën e shkrimit latin. Nga ana tjetër duhet shtruar seriozisht pyetja, a reflekton ky shkrim i hershëm në fakt realitetin e shkrimit në Shqipërinë e shekullit 15-të. Kjo është e lidhur me pyetjen se kur ka filluar shkrimi shqip. Siç është e njohur, ekziston një referim i vjetër për përdorimin e shkrimit në Shqipëri, konkretisht shënimi i

njohur i anonimit të vitit 1332 me fjalët: *Et licet Albanenses aliam omnino linguam a latina habeant et diversam, tamen litteram latinam habent in usu et in omnibus suis libris*. Ky shënim u interpretua dhe ende shpesh interpretohet në atë mënyrë, që ekzistueshin libra në gjuhën shqipe në atë kohë. Por kjo nuk është aspak e mundshme për arësye kulturore dhe historike. Ky shënim na informon vetëm mbi ekzistencën e librave —“libra“, ose më saktësisht akte, diploma, etj.— të shkruara në alfabetin latin dhe gjuha e të cilave ishte ndoshta latinishtja ose dialekti venecian. Kështu, çështja e moshës së shkrimit shqip mbetet e hapur e gjithashtu pyetja, a e ka adaptuar shkrimin latin për shqipen Paulus Angelus vetë apo a ka shfrytëzuar një përdorim ekzistues të shkrimit për gjuhën shqipe me shkronja latine. Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, është e nevojshme për të shkruar mbrapa në kohë, pra rreth 100 vjet në të ardhmen, në mesin e shekullit të 16-të, saktësisht në vitin 1555. Është viti në të cilin ka lindur shqipja letrare në formën e punës së priftit katolik Gjon Buzuku. Vepra e tij —zakonisht i quajtur „Meshar“, por në vërtet një doracak për kujdesin shpirtëror— mund të na japë disa të dhëna të rëndësishme.

6. Në veprën e klerikut katolik Gjon Buzuku e vitit 1555 gjuha shqipe dokumentohet në dialektin geg. Nga ana e humbjes në fillimin e librit mungojnë të dhëna për vendin ku është shtypur ky libër, por provat shumë bindëse kulturore dhe historike të sjella gjatë viteve të fundit nga Lucia Nadin, përkrahin supozimin, që libri i Gjon Buzukut qe shtypur në Venedik. Në fakt, Venediku si vendi i shtypjes për një libër shqip nuk duhet të habitet, sepse në atë kohë ai ishte një vend shumë i rëndësishëm publikimesh për Ballkanin dhe për vendet e Lindjes, pikërisht për shkak të faktit se shtypshkronjat venedikase kishin shkronjat jo-latine për te shtypur gjuhë të ndryshme që nuk përdornin fare ose jo ekskluzivisht alfabetin latin. Në rastin e librit të Gjon Buzukut, megjithatë, s’kishte asnjë problem, sepse alfabeti që ka përdorur Gjon Buzuku në radhë të parë është bazuar në alfabetin latin. Por jo ekskluzivisht. Alfabeti i Gjon Buzukut është karakterizuar si një përzierje e shkronjave latine dhe cirilike. Saktësisht shkronjat cirilike janë huazuar nga varianti boshnjak i alfabetit cirilik, që quhet *bosančica*, dhe këto shkronja cirilike, ndër të tjera, janë përdorur për të shënuar fonema për të cilat alfabeti latin nuk kishte shkronja të veçanta. Alfabeti i përzier latin-cirilik i Gjon Buzukut paraqitet si vijon:

<a, b, c/ç, d, e, f, g, h, i/j, k, l, m, n, o, p, q, r, s/š, t, u/v, x, y, □, &, 0, 8, h, x, e>

7. Duke marrë parasysh në detaje funksionet e këtyre shkronjave në alfabetin e Gjon Buzukut, ose përdorimet ortografike të atij alfabeti, vihet re një praktikë edhe e përzier. Nga njëra anë një praktikë që ndjek ortografinë italiane, p.sh.:
- Përdorimi i shkronjës <c> për prapagjuhoren mbylltore [k] dhe paragjuhoren afrikate [tʃ]
 - Digrafi <gn> për të shënjuar sonanten mesgjuhore [ɲ]
 - Përdorimi i shkronjës <s> për të shënjuar paragjuhoren alveolare [s] dhe paragjuhoren fërkimoren [ʃ]. Ky përdorim është një ndikim grafik e ortografisë venedikase, sepse dialekti venedikas dikur kishte vetëm paragjuhoren alveolare [s].

Përveç këtyre shkronjave latine alfabeti buzukian dispononte edhe shkronjat e veçanta që janë huazuar nga alfabeti cirilik boshnjak e të cilat në rastin e të dy shkronjave ξ dhe ħ shërbejnë për të shënjuar fonema shqipe, për të cilat alfabeti latin nuk kishte asnjë shkronjë:

ξ shënjon [ð] dhe [θ] (në alfabetin shqip modern shkruhet si <dh> dhe <th>) ħ shenjon [ɲ] dhe [ç] (në alfabetin shqip modern shkruhet si <gj> dhe <q>).

Një nga pyetjet qendrore që i përkasin alfabetit buzukian, që ishte lindur nga një ndikim i dyfishtë latin-italian dhe cirilik, është çështja e moshës së tij. Pra, konkretisht çështja është: a e ka krijuar këtë alfabet Gjon Buzuku vetë, apo përdorte Gjon Buzuku një alfabet shqip ekzistues?

8. Një përgjigje e qartë për këtë pyetje nuk duket të jetë e mundur në bazë të fakteve që kemi në dispozicion, por mund të jepen disa mendime. Këto mendime janë të dyfishta. Së pari, duhet studiuar struktura e brendshme e alfabetit buzukian dhe së dyti duhet bërë një krahasim me shkronjat latine që janë përdorur në formulën e pagëzimit të Paulus Angelus-it rreth 100 vjet para Buzukut. Duhet kërkuar përdorimet e përbashkëta dhe ato të ndryshme.

8.1. Për të përcaktuar pak moshën e alfabetit buzukian duhet hulumtuar hollësisht shkronja ħ që në alfabetin cirilik quhet edhe *đerv*. Në alfabetin buzukian kjo shkronjë shënjon si qiellzoren e zëshme [ɲ] ashtu edhe qiellzoren e pazëshme [ç]. Pa dyshim, ky përdorim kopjon përdorimin e kësaj shkronje në alfabetin cirilik, ku ajo ishte përdorur pa dallim si për afrikaten alveopalatale të zëshme [ɲ] ashtu edhe për afrikaten alveopalatale të shurdhët [ç]. Megjithatë, është shumë e veçantë, se kjo shkronjë, që ka origjinën e saj në shkronjën **Ѣ**

të alfabetit glagolitik, ishte përdorur fillimisht vetëm për shënjuar fonemën e zëshme [□]. Përdorimi i saj edhe për variantin e shurdhët është dokumentuar vetëm që nga mesi i dytë të shekullit 14-të. Kështu kemi një datë shumë të veçantë, që na mëson se përdorimi i dyfishtë I kësaj shkronje në alfabetin shqip nuk mund të jetë më i hershëm se përdorimi i dyfishtë në alfabetin cirilik nga mesi i dytë I shekullit 14-të. Bazuar në këto konsiderata, alfabeti buzukian, nëse nuk ishte krijuar nga Gjon Buzuku vetë në mes të shekullit 16-të, mund të jetë krijuar më së shumti 200 vjet para Buzukut.

8.2. Krahasimi me shkrimin krejtësisht latin të formulës së pagëzimit të Paulus Angelus-it fillimisht tregon për fat të kaq se në këtë tekst kaq të shkurtër nuk janë përdorur leksema, në të cilan do të shfaqeshin fonema specifike si [ð], [θ], [□] ose [c]. Me të vërtetë do të ishte shumë interesante të shihej se si Paulus Angelus do të shkruante këto fonema. Prandaj, duhen analizuar vetëm ato fonema që gjejmë në formulën e pagëzimit e të cilat kërkojnë një analizë të veçantë. Këto janë hundorja qiellzore [□] dhe fërkimorja paragjuhore [□]. Përveç kësaj, duhet të merret në konsideratë edhe grykorja [g]. Paulus Angelus i ka shkruar këto fonema si vijon:

[□] = <ni>

[□] = <s>

[g] = <gh>

Ky krahasim na tregon një përputhje të përdorimit midis Paulus Angelus-it dhe Buzukut në rast e shkronjës <s> që —siç u tha më parë— shënjon si fërkimoren alveolare [s] ashtu edhe fërkimoren paragjuhore [□].

Megjithatë, përdorimet e tjera dallohen nga përdorimet që na tregon Gjon Buzuku. Hundorja qiellzore [□] shkruhet nga Gjon Buzuku në mënyrë ortografike italiane me digrafën <gn> e grykorja [g] përsëri në pozitën para një zanoreje të lartë shkruhet me <g> —siç e shkruan për shembull edhe Pjetër Budi—, digrafi <gh> gjendet së pari vetëm te Frang Bardhi që ashtu e kopjon ortografinë italiane.

Se mund të lëmë mënjanë karakteristika idiografike ose disa pasiguri grafike të autorit Paulus Angelus e nëse i marrim këto dallime seriozisht kjo na çon në përfundimin se Paulus Angelus dhe Gjon Buzuku kanë përdorur dy alfabete të ndryshme. Në kontekstin në të cilin është dokumentuar shkrimi i s.o. del si një shkrim spontan që nuk është bazuar në një përdorim më të vjetër të shkrimit të gjuhës shqipe. Ashtu, shkrimi i Paulus Angelus-it me të vërtetë —të paktën deri tani— do të jetë shkrimi i parë i gjuhës shqipe nga një shqiptar. Në kundërshtim me të, alfabeti buzukian që është dokumentuar rreth 100 vjet më vonë për

shkak të strukturës së tij dhe përdorimit të tij lë përshtypjen sikur të ketë pasur përpjekje të mëparshme për të shkruar gjuhën shqipe. Por kjo konsideratë nuk mund të provohet dhe mbetet e mundshme se alfabeti buzukian është në vërtet një krijim me mjeshtëri e personalitetit Gjon Buzuku që ishte pa dyshim një klerik i mirëarsimuar, i cili që në mesin e shekullit të 16-të jetonte në rajonin e Adriadikut, ku në këtë kohë lulëzonte një klimë e njeë kulture shumë të frytshme. Deri në shfaqjen e dokumenteve të shkruara shqipe që janë më të hershme se libri i Gjon Buzukut nga 1555, kjo çështje kaq e ndërlikuar nuk mund të zgjidhet.

Përfundime

Edhe pse disa çështje të historisë së hershme të shkrimit shqip nuk mund të zgjidhen tani, është e sigurt se fillimi i shkrimit shqip në alfabetin latin ka ndodhur krejt në kohën e rezistencës së Skënderbeut kundër sundimit osman. Ky shkrim dhe zgjedhja e alfabetit latin nuk duhet të kuptohen si një shprehje e një vetëdije shqiptare kombëtare ose si një akt rezistence, por është në fakt rezultati i rrethanave dhe pasojave që kanë ndjekur rezistencën e Skënderbeut. Pushtimi osman ka tundur në radhë të parë pjesën katolike të Shqipërisë dhe kishte si rezultat një humbje të rëndë të popullsisë e një mungesë të gjerë të klerikëve që mund t'u ndihmonin shqiptarëve në çështjet dhe nevojat fetare. Për të lehtësuar nëvojën e për të shpëtuar shpirtat e porsalindur, praktika e zakonshme rituale e pagëzimit latin u anulua dhe Paulus Angelus në letrën e tij dha prindërit lejoheshin ta thonë formulën e pagëzimit të emergjencës edhe në gjuhën amtare, d.m.th. të pagëzojnë fëmijën e tyre në shqip. Paulus Angelus ka shkruar se formula e pagëzimit duhet të flitet në mënyrë korrekte e kështu na ka dhënë dëshminë e parë të shkrimit shqip. Por, edhe nëse shkrimi shqip me shkronja latine nga Paulus Angelus ka qënë ndoshta një akt unik dhe spontan, përkthimi i formulës së pagëzimit latin në një formë të shqipes që mund të kuptohet dhe të shqiptohet nga shqiptarët katolikë, dhe ritualisht saktë mund të konsiderohet si hapi i parë drejt krijimit të një koinëje shqipe veriore, një koinë shqipe siç do të shfaqet më vonë në veprat teologjike dhe kateketike të autorëve katolikë. Në fund të fundit, pa këtë kontekst të shekullit 14-të autorët katolikë nuk mund të kuptohen si duhet. Megjithëse vepra e Gjon Buzukut e meriton nderin për t'u parë si dokumenti i parë pothuajse i mirëfilltë letrar i gjuhës shqipe, ishte Paulus Angelus, i cili hodhi themelin e kësaj rruge zhvillimi.

Conclusions

Although certain questions of the early Albanian history of writing are not solvable in the current state of affairs, it is clear that it was precisely during the period of Skanderbeg's resistance to the Ottoman rule that Albanian was first written in the Latin alphabet. The choice of the Latin alphabet is by no means to be understood as an expression of an Albanian consciousness or even as an act of resistance, but simply due to the circumstances and consequences that resulted from this resistance by Skanderbeg. The Ottoman conquest had heavily affected the Catholic part of Albania causing heavy population losses, and also a shortage of clergymen who could have assisted the Albanians in matters of faith. In order to alleviate this plight with regard to the salvation of the newborn, parents were allowed to perform the emergency baptism in their Albanian mother tongue instead of using the Latin formula which they did not understand. The Albanian baptism formula is recorded in a letter of Paulus Angelus who gave us thus the first written testimony of Albanian. Although the writing of the baptism formula in Albanian was probably a unique and spontaneous act, it can be considered as the first step towards the creation of a Northern Albanian Catholic koiné, as it appears in the theological and catechetical works of later centuries. Ultimately, the ancient Albanian Catholic authors are not conceivable without this context of Skanderbeg and even if Gjon Buzuku had the undeniable honor of having written and published the first literary monument of Albanian, it was Paul Angelus who laid the cultural foundations for it.

Although certain questions of the early Albanian history of writing are not solvable in the current state of affairs, it is clear that it was precisely during the period of Skanderbeg's resistance to the Ottoman rule that Albanian was first written in the Latin alphabet. The choice of the Latin alphabet is by no means to be understood as an expression of an Albanian consciousness or even as an act of resistance, but simply due to the circumstances and consequences that resulted from this resistance by Skanderbeg. The Ottoman conquest had heavily affected the Catholic part of Albania causing heavy population losses, and also a shortage of clergymen who could have assisted the Albanians in matters of faith. In order to alleviate this plight with regard to the salvation of the newborn, parents were allowed to perform the emergency baptism in their Albanian mother tongue instead of using the Latin formula which they did not understand. The Albanian baptism formula is recorded in a letter of Paulus Angelus who gave us thus the first written testimony of Albanian. Although the writing of the baptism formula in Albanian was probably a unique and spontaneous act, it can be considered as the first step towards the creation of a Northern Albanian

Catholic koiné, as it appears in the theological and catechetical works of later centuries. Ultimately, the ancient Albanian Catholic authors are not conceivable without this context of Skanderbeg and even if Gjon Buzuku had the undeniable honor of having written and published the first literary monument of Albanian, it was Paul Angelus who laid the cultural foundations for it.

Although certain questions of the early Albanian history of writing are not solvable in the current state of affairs, it is clear that it was precisely during the period of Skanderbeg's resistance to the Ottoman rule that Albanian was first written in the Latin alphabet. The choice of the Latin alphabet is by no means to be understood as an expression of an Albanian consciousness or even as an act of resistance, but simply due to the circumstances and consequences that resulted from this resistance by Skanderbeg. The Ottoman conquest had heavily affected the Catholic part of Albania causing heavy population losses, and also a shortage of clergymen who could have assisted the Albanians in matters of faith. In order to alleviate this plight with regard to the salvation of the newborn, parents were allowed to perform the emergency baptism in their Albanian mother tongue instead of using the Latin formula which they did not understand. The Albanian baptism formula is recorded in a letter of Paulus Angelus who gave us thus the first written testimony of Albanian. Although the writing of the baptism formula in Albanian was probably a unique and spontaneous act, it can be considered as the first step towards the creation of a Northern Albanian Catholic koiné, as it appears in the theological and catechetical works of later centuries. Ultimately, the ancient Albanian Catholic authors are not conceivable without this context of Skanderbeg and even if Gjon Buzuku had the undeniable honor of having written and published the first literary monument of Albanian, it was Paul Angelus who laid the cultural foundations for it.

Although certain questions of the early Albanian history of writing are not solvable in the current state of affairs, it is clear that it was precisely during the period of Skanderbeg's resistance to the Ottoman rule that Albanian was first written in the Latin alphabet. The choice of the Latin alphabet is by no means to be understood as an expression of an Albanian consciousness or even as an act of resistance, but simply due to the circumstances and consequences that resulted from this resistance by Skanderbeg. The Ottoman conquest had heavily affected the Catholic part of Albania causing heavy population losses, and also a shortage of clergymen who could have assisted the Albanians in matters of faith. In order to alleviate this plight with regard to the salvation of the newborn, parents were allowed to perform the emergency baptism in their Albanian mother tongue instead of using the Latin formula which they did not understand. The Albanian baptism formula is recorded in a letter of Paulus Angelus who

gave us thus the first written testimony of Albanian. Although the writing of the baptism formula in Albanian was probably a unique and spontaneous act, it can be considered as the first step towards the creation of a Northern Albanian Catholic koiné, as it appears in the theological and catechetical works of later centuries. Ultimately, the ancient Albanian Catholic authors are not conceivable without this context of Skanderbeg and even if Gjon Buzuku had the undeniable honor of having written and published the first literary monument of Albanian, it was Paul Angelus who laid the cultural foundations for it.

Agostino GIORDANO¹

„SHPATA SKANDERBEKUT NDË DIBRET POSHT’ I BINARD BILOTËS

Abstrakt

Agostino Giordano: „Shpata Skanderbekut ndë Dibret Posht’, poemë në gjuhë arbëreshe e Bernardo Bilotta-s (1843-1918), prift bixantin ka Frasnita (Frascineto/Cs/Itali)’.

Vet tre autorë arbëreshë shkruajtën poeme mbi Gjergj Kastriotën Skënderbe: Jeronim De Rada, Giuseppe Angelo Nociti e Bernardo Bilotta.

Poema bilotian merret me luftën e parë të Skënderbeut kundër Turqvet, në Dibrën Poshtë. Një vepër e trimërisë, një ndër të parat, kujt autori i jipte shumë rëndësi e dishëronte të botohej; po mbet dorëshkrim deri më 1967, kur - e hartuar, me shkurtime ka stërnipi papas Emanuil Jordani – e botoi Universiteti i Tiranës. Një poemë – në katër redaktime - fryt i zakonit të gjallë popullor të Frasnitës dhe i leximit të veprave historike të Barleciit e të Papadopulo Vreto-s. Një vepër me më se 10.000 vargje, e shkruar në të folmen arbëreshe të Frasnitës, me vlera gjuhësore dhe etnike të rralla, ku rrëfyhet epeopea e Skënderbeut – sapo e zënë në Dibër - me një rrëfim madhështor dhe njëkohësisht popullor.

Bernard Bilota - të cilit simbjete bie qindvjetori i vdekjes - jetoi motin e Lidhjes së Prizrenit (1878), motin e Kuvendit të Monastirit (1908), motin e Pavarësisë së Mëmëdheut ka Turqit (1912). Poema qëndron një provë se si Arbëreshët kanë jetuar me helm shtypjen shumëshekullore të Mëmëdheut nën Turqit dhe me gëzim kanë festuar lirinë e tij. Një vjershërim pothuaj popullor, një rrëfim me ndikime nga poemat epike kalorsiake të letërsisë italiane, ku fantazia i ngatërrehet historisë, e ku poeti i shton figurës s’Skënderbeut frymë tjetër legjendare.

Historia e krijon Legjendën, dhe legjenda krijon Rapsoditë.

Binard Bilota, poet e prift bixantin, këndon Gjergj Kastriotin si Mbret të Arbrit e si Luftar të Krishtëritit.

¹ Revista online „Jeta Arbëreshe’

Rapsodia e Skanderbekut rron Frasnitë, aq te Vallet e Pashkëvet sa te poema e Bilotës.

Shkruan Binard Bilota:

*Bëra kët kangjelime se t'kallzonja
trūt e zëmren time të fësheht...
Së munda u të mbahsha mos thonja
çë ndienja e më zënë ndë zëmrèt.
M'i gjava u kanarit, kūr shkruenja,
çë dha si ndien ja zdreth e së rri qet,
i elt ka malli, kūr zë lëng rrënja
e bari ngjallet të nxjër lule e fjet.
E kështu më këndova Skanderbën
çë gjith të lashtit burra arbresh shkon
e s'jān, në pas atij si ài më qēn.
Gjella e urt e e dashme e tīj lulzon
nga mot e gjith sīt ài me hājēn
mbi të telq, se burra dreq i bēn.*

Të Binard Bilotës, poet e prift bixantin arbëresh ka Frasnita, simbjekt kujtohet qindvjetori i vdekjes (1843-1918).

Poemës së tij „Shpata Skanderbekut ndë Dibret Posht’ i kushtoi katër redaktime: e para ka datën e vitit 1874, e prasmja 1890. Zu e e shkruajti kur ish trim e kjo është një ndër të parat vepra.

„Skanderbekun’ e njohu ç’kur ish djalë: ndër Pashkë, Frasnitë, Vallet këndoje Rapsodinë e tij bashkë me të tjera, e ku epopea e këtij Eroi ngjatej edhe me ca tjera shfaqje etnike, si „të nxijturit e lëtinjvet’ e si „të xarrisurit e filaqirëvet turq’ për me i shitur në treg.

„Dibren e Poshtë’ e njohu tue djovasur Barlecin dhe Antivarinin, të pjerrë në gjuhë italiane ka Andrea Papadopulo Vretò.

Kujtimi i gjallë i popullit arbëresh përpiqet me rrefimin historik. E të dya përputhen e plotësohen. Kështu lehet ky poem i Bilotës.

Patjetër Bilota rritet me vjershin e vallevet ndë veshët; trim, studion historinë e Arbrit, në Kollegjin e Shën Adrianit, në Shën Mitër; burr, djovasen tërë veprën e De Radës, mësemë poemën

„Skanderbekun e pafanë’; nd’ata vjet çë ky sheh dritën me të parët 3 libra (1872-73), Bilota shkruan (1874) redaktimin e parë të „Shpatës’. Dhe e titullon kështu: „Shpata Skanderbekut, e shkruetur ka Binard Bilotta, frasnjot, ndë të parën e vjeshtit 1874’.

Vet tre autorë arbëreshë shkruajtën poeme mbi Gjergj Kastriotën Skanderbë: Jeronim De Rada, Giuseppe Angelo Nociti e Binard Bilotta.

Poemi i De Radës përshkruan Arbërinë, të shkretë, nën thundrat turke: është e pret të vinjë Skanderbeku t'ë lironjë.

Poemi i Bilotës këndon të parën luftë të Skanderbekut kundër Turqvet, në Dibërën e Poshtë.

Poemi arbëresh „La difesa di Croia”, i poetit ka Spixana, Giuseppe Angelo Nociti (1832-1899), rrëfyon se si Skanderbeku përgatitën mbrojtjen e Krujës, kryehorë-kështjellën e tij, ka të sulurit e sultan Muratit II: sulm që pra vërtet ndodhet te viti 1450.

Pesëdhjetë vjet De Rada përpunoi Poemin e tij (1834-84) e një pjesë e botoi. Dorëshkrim qëndroi poemi i Noçitit.

Gjashtëmbëdhjetë vjet Bilota përpunoi Poemin e tij; po, si e shkruajti, ashtu qëndroi: dorëshkrim.

E helm ndienj Bilota për gjithë veprat e tija arbëreshe, - që thërret „biltë e mi” – e që, megjithëse të stolisura, s'mund t'shohen dritën e botimit.

Kështu shkruan te një poezi e vitit 1911:

....

*Për helmin e sëmundes, biltë e mī
si të nëmur shkojen gjellen ktu mbi dhē:
s'kān kush t'm'i paltonj më me gajdhī,
të buthtohen ndë jetë me dritë të rē!...*

Vet në vitin 1967, si qasej 500vjetori i vdekjes së Skanderbekut, ky Poem, me pëlqimin e Universitetit të Tiranës, vjen i botuar në Tiranë, në edicionë të pjesshme, nën kujdesën e stërnipit të Bilotës, papas Emanuele Giordano.

Binard Bilota, është një arbëresh entuziast, ka zjarrin mbrënda.

Thërritet „nxënës i De Radës”, atij i kushton më se ndonj vepër; bën filologji si Kamarda, Dorsa, De Rada. Dhe boton 9 libra me studime filologjike.

Ka një pjekuri të thellë në gjuhët dhe letërsitë e vjetra, greqishte e latinishte, si edhe italiane; po ka edhe një fantazi të dhezur, e çdo fjalje i gjën rrënjën arbëreshe.

„Nxënës i De Radës”, thojem.

De Rada zë e shkruan veprën „Skanderbeku i pafanë” te viti 1837 dhe e mbaron pas pesëdhjetë vjetsh; Bilota zë e shkruan „Shpaten e Skanderbekut” te viti 1874 dhe e mbaron (me redacjonën e katërt) te viti 1890. Mjeshtër e nxënës.

De Rada shkruan mbi „ndodhje ideale” të vitevet 1418-1444; Bilota shkruan mbi „ndodhje historike” të vitit 1444.

De Rada shkruan mbi Skanderbekun „e pafanë”, në formë pesimiste; Bilota

shkruan mbi Skanderbekun që mundën Turqit, optimist.

10.269 janë vjershet e poemit deradian; 10.584 janë ata të poemit bilotjan.

Po ndryshimi i math ndër dy veprave është ky: De Rada e boton poemën e tij, Bilota jo. Kështu që poemi i De Radës patjetër interesoi dhe zgjoi Shqiptarët, kurse poemi bilotjan jo. Ndëse kish parë dritën, patjetër e kish dhënë kontributin e tij.

Bilota është prift arbëresh, e „Shpata Skandebekut” është vepra e një prifti arbëresh. Vepër e një Arbëreshi kundër Turqvet; vepër e një të Krishteri kundër Musulmanvet.

Skanderbeku del jashtë me tërë fuqinë e vlerjen e tij: „I prasmi luftar i Krishtërit”, e prasmja kështjellë kundër Turqvet (të pabesë); vepra është një mundje/fitore e qartë morale, bestare – si, në realitet, që mundje/fitore ushtarake – mbi Turqit e mbi Besën e tyre (të rreme).

Bilota është i ashpër dhe i qartë kundër Otomanvet. Ai rron motin e Lidhjes së Prizrenit (1878), motin e Kuvendit të Monastirit (1908), motin e Pavarësisë së Atdheut ka Turqit (1912), pas 444 vjet sundimi të egër. Bilota e rron të tërë Ëndrrën e popullit shqiptar, aq atë kulturore sa atë politike: më parë u zgjodh Alfabeti i popullit shqiptar e pëstaj populli u zgjith ka gërthëtët e Turqvet.

Sikurse Alfabeti i njësuar i mbësoi Shqiptarëvet udhën e Lirisë. Alfabeti e Shpata liruan Shqiptarët ka zigòi turk.

Me „Shpatën e Skanderbekut”, Bilota nëng shkruan një poem fantazije, edhe ndëse ktu-ktje del ka avlaqi i rrëfyemes historike të Barlecit dhe Antivarinit – edhe këta pak të enfatizuar - e i qaset

„Iliades” së Omerit, dhe poemet epikë-kalorsiakë të poetëve italianë Boiardo, Tasso e Ariosto: atjë kur bën e hijën te lufta arbro-turke edhe shpirtra të mbinaturshëm.

Bilota e rron me pasion lirinë e Shqipërisë nga Turqia e vet Skanderbeku i duket Personaxhi ideal që mund t’zgjtonjë Shqiptarët, që mund t’i bashkonjë dhe t’i udhëtonjë drejt lirisë. Nën urdhërin e tij Arbërorët luftojën kundër Turqvet në shek.XV, në ëmrin e tij Shqiptarët do të ngrëhen kundër Turqvet, në shek. XIX, pas 4 shekul e gjimës shtypje t’egër.

Lufta e „Dibrës s’Poshtë” është e para luftë e Skanderbekut kundër Turqvet dhe ka shumë rëndësi: ndëse bier, Arbri është i bjerrë; ndëse munden, Arbri zë një epopë të lavdishme. Hera është historike.

Poemi ndahet në dymbëdhjetë „Kangjele”, ngjatet në 1.764 sekstina, domethënë 10.584 vjershe, gjashtë-shtatë rrokjesh; rimë ABCBDD.

Gjuha

Gjuha e Poemit është „E Follmja Arbëreshe e Frasnitës”, e pastër; e bëgatur ka pak neologjizme të autorit, ka dica fjalë të marrë hua ka De Rada e Santori

dhe ka ndonjë fjalë italiane e arbreshizuar. Gramatikë e kulluar. Do thënë edhe se Bilota kish zënë të përpilonej një Fjalor Arbëresh (më se 5.000 fjalë), që pra stërnipi papas Manuill Giordano muar e vu mbrënda tek i tiji (Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë, Bari 1963).

Alfabetet

Ndë mes s'parës redacjonë (1874) dhe s'prasmes (1890) të poemit, Bilota ndërron pakund shkronja. Mbrey Afabetiti të Monastirit, tek e para redacjonë kemi 17 shkronja ndryshe; tek e dija, vet 8 shkronja ndryshe.

E Para (1874)

a – b – d – e – f – i – m – n – o – p – r – s – t – u – v (15 si italishtja)

δ, γ, κ, □, ζ (5 si greqishtja)

l, sh (2 si shqipja)

z(c), c/cj(ç), y(ë), gk(gj), c/ch/q(k), x(ks), lj/lh/gl(l), gn(nj), sh/sc/sci(sh), z(x), gi(xh), sg/sgi(zh) (12 ndryshe)

E Prasmja (1890)

a – b – d – e – f – i – m – n – o – p – r – s – t – u – v (15 si italishtja)

dh – ë – gj – h – hj – j – l – ll – nj – rr – sh – th (12 si shqipja)

z(c) – c/ci(ç) – c/ch/q(k) – k(q) – z(x) – gi(xh) – sz(z) – szg(zh) (vet 8 ndryshe)

Rrëfimi i luftës

„Shpata Skanderbekut’ zë kështu:

*Dihej dit e bār dh / ndër sheshet e Dibrës: / tëfalnej Arbresht /
me diellin, gjëll e hjës, / ë jeten zburon / e t’mirat i mburon. (I,1)*

Është dita e së parës luftë të Skanderbekut, në dhé arbëror, kundër Turqvet. E, ndër sheshet e Dibrës Poshtë, Skanderbeku

Mirr mot, vë j kufi / ku kish përlufosoj, / ë udhje me kaloret /

turkut kish strosej: / ndë ’vend shokt axātu / kish shtinej pra o mbjatu. (I,10)

E, pra ç’bën kriqë, kështu i folën ushtarëvet:

...Parkalesmi Krishtin, / shok, të mbānj me nē, / bēt’qellemi me hjē. /

Vi Kriqezen e tīj / krah-qifte sinodhī, / ndrë të parat ndëmi. /

Ju trima, shokt e mi, / shini t’i bēm ndër / ndë duemi ka ajo vrër. (I,12-13)

Të parat fjalë, të parët shëngje na buthtojën një Gjergj Kastriotë i krishterë. I pjerrë i krishterë, pra që Murati e shtrëngoi, kur ish peng i tij në Adrianòpull,

aq të rrethpritej sa të lënej besën e krishterë. E kështu vijon:

*Jemi ndë dit t' ljustur / e ë me mua dojet... / Kūr mua ndë dhët turk / shkronjet
tāj dërgojet, / djovasja e s'fjisja / e lutja mos vdisja
si vllertzit e mi, / prana bë t'shijet / kūr të piqej hera, /
si ju mund shtijet / turkun ka bazulji / mbi ku Djalli e ulji...
Gjith puthmi kët hër, / ë kūr të na ndërōnj!... / Dishruem kët dit, / ë kūr të na
mburōnj / besen, hājn e gjellen, / ë të mirat pjellen!...” (I, 25-26-27)*

E mbaron të folurit e tij ushtres, me këto fjalë:

*Gjith ju shok gjirī / ë nderen mbani shtrëjt, / kujtoni se me ëhjat /
na veshen besa shëjt, / kuj na nget ngahër / na t'i bëmi ndër.
Presmi ajo të mbānj / fort me dreqen të n. / Liqja, o gjirī, / është si ka ana
jōn!...
Ndomos se njōn shūm, / Turqit s'kān ë bëjen / me kë ruejen nderen /
ù dī si luftojen.. / U ë shok i pata, / zëmren tire mata'. (II, 107-108, 111)*

Skanderbeku i njeh mirë Turqit: qe komandanti i tyre te shumë lufta, i njeh fund e malë. E s'i trëmbet fare. E këtë fuqi ja shkon edhe ushtrës së tij. Me këto fjalë ja ngrohën zëmren, ja çelën gjakun.

Mbi Komandantin e Turqvet, Ali Pasha, Bilota shkruan:

*I keqi Ali Pasha / krie pjak i bushter / dizetet mīlj shok, /
të zgjedhuriz jushter / me ndri ur rri idhōj / e ndreqi e rrzōj.
Me zakōn e pjeqvet / ai nisi ciljōr / të ljuftes axàtrat. /
Kush i jipjen fōr / ishen Manxurri, / Buxeku e Aqburri. (II, 1-2)*

Personaxhet e ushtrës arbërore të Skanderbekut janë buleerë të njohur: Arianit Golem Topia / Andrea Topia / Gjergj Stresi Balsha / Muzaka / Nikollë e Pal Dukagjini / Lekë Zaharia / Pjetër Spani / Lek Dushmani / Stefan Çernoviçi; kurse komandantët e ushtrës turke, veç dy o treve të shënuar edhe ka Barleci, kanë ëmre fantazije, o për me shajtur.

E lufta çelet, e ashpër; e Arbëreshët luftojn si ja mbësoi Skanderbeku:

*... Thrrijsjen / gjithnjë sã gjimojen / llakat rrëz e mallet /
me thirrmat ë thojen: / Vrasmi kta bil qeni... / Shok, një mos leni!”
E vrisjen!... Ahiera / Shpata Skanderbekut / e para t'u ngjìe / te anti Buxekut,
/ çë i pari i ndëhet / i shtijtur të zëhet.
Atij ju fanaros / me gjirūt Arbresh / si lliun me ū mishi / stroset ku jān desh...
(III, 67-69)*

Kali i Skanderbekut, Korbi, merr pjesë te lufta edhe ai: sulet me grykë e shqyen me dhëmbë kocat e luftarëvet turq këmbësorë. Kal e kalor, gjithnjë, kundër Turqvet.

*Kali Skanderbekut, / kuj Korb ja thojen / - se si korbi nxinej. /
e mbë karrër shkonej / gjith kuelt e gjirivet – / zdrith trëmbësivet
turq, kuj kcenej / e zë j kriet me grik... (III, 74-75)*

Sipas modelit të Omerit, po edhe të autorëve italianë si Tasso e Ariosto, te lufta merr pjesë qielli e nëndheu. Fuqitë e mira shpirtërore ka një anë e të ligat ka jetra: të parat, me Tënzot, ndihjën Arbëreshët e Krishterë, të dijtat ndihjën Turqit musullmanë.

*Mbi thronin e Diellit / rrjij uljet Inzot / e ruenej aposhta /
ku kuernej si mort / gjellat Skanderbeku / te ku ish Buxeku. (IV,1)*

Skanderbeku kish, për shoqe, Trëmbsinë e Vdekjen, e vithe kalit Gavnjinë. Ndër llajët turke luftonej i bushtri Aqibë, dhëndri i Xoraidhës, ç'ish po t'errënej me 500 kalorë se t'i ndihnej Ali Pashës. E Bilota kështu na e buthton:

*Ish e mīr e ëmbel / vasha e kndimavet / e gjith katundit sāj: /
ish malli gjith trimavet / ajo që edhe e dojen / vashat e e shërtojen. (IV,25)*

Po i shkreti Aqibë atë ditë përpoqi Skanderbekun, e ki e vrau. NSkanderbeku: një komandant i egër, kundër Turqvet:

*Skanderbeku vrit / e mbaru sheshrrohej: / si shpata Tënzoti /
nd'at zbuli butthohej; / bënej sa dōj qiçe / për ndër Shëjtes Kriqe. (IV, 141)*

Egër luftohet. E Bilota kështu na e përshkruan përleshjen:

*... Di anat ë afrohen / të keqa të cënohen, /
si ujrat e di lumesh, / ë ka di male shkasen / mbëhënd e ndë llakt /
përpara duen ngasen / e shtihen e ngrëhen, / e rrihen e përposhen... (VI,62-63)*

Po Arbëreshët janë luanë, të komanduar ka një Fatos që lufton me ta, përpara atyre, për Lirinë, për Besën e Krishterë, për Atdheun:

*Si suval e madhe / këtu Arbresht sulshin / si ulqit ndër dhent /
ndëpër Turqit ngulshin / eger e vrisjen / e shpojen e prisjen,
si kush rrungon ferra / o kueren ndër copat; / e varra gjak mbjojen /
e dherat e gropat / e ajrin me rkime / me thirrma e ksime. (VI,78-79)*

Skanderbeku përpjek Kusibanin, shok ushtrije ndër Turqit, (me k's' dojt' matej), e kështu i folën:

*....Ti shoku im i heret, / i fort e i keq, / më se gjith të tjeret, /
se shprishe trëmbësīn / mbi Europen e Asīn,
kult sā shok qemi / sā u dishtim e sā bēm / bashk të sheshrrojem /
Feten, ka u lēn, / pra ë fort më ngau / zëmren, kūr më vrau
tre trima vëllezër; / e mëmen time nxuer / bashk me mī motra /
ka zotëria ë muer / sa tata mbilli sīt / i vrār ka helmūt... (VII, 93-95)*

Arbëreshët, kur mundjën, Turqvet ç'ngrejën duart i bëjen filaqirë, se t'ishen të shpërblyer pra ka gjiritë ka Turkia.

Si mbaron lufta, Inzot ka haré:

*Me gasin tÿj gzonej / tek u bëlëmashi, / si t'i thōj Arbreshvet: /
 'Bil, paq pavshi; / mbani, se si doni, / gjellen trashigoni'.
 Tue thën, ai thjellonej / Dibren si ndë mot' / ë dhën ka deti nxuer /
 e bëri Dhamin zot. / Gjithë ajret e lë / frijen nd'at dhé... (VIII, 71-72)*

Gjatë darkës s'madhe, bashkë me komandantët e ushtrës, Skanderbeku i pyen Nik Petës sa t'lidhur bëri:

... 'Dimil nëmrova – / i tha Nik Peta. / Të shumet pëngova / u me këto duer... (IX, 109)

Muzaqit i pyen sa Turq qëndruan të vrarë; e ky i shton edhe numrin e Turqvet që vrau dora e Skanderbekut :

*... Zot, nëmrëm / njëzet e dimilj / Turq, ë qëllëm /
 me gjumin e rë nd / ë qëllon një gjë mb.
 Për sã vura kufi / u, ë bashk qeva / me tÿj e luftova, /
 një katerqind vreva / shtë n ka jotja dōr / ë bÿj me aq fōr... (IX, 120-121)*

Ndrë Topisë Skanderbeku i lypën sa t'lavosur pat ushtra arbëreshe:

*.... 'Na, zot, mbë t'serposur / furnëmi t'i mbjidhjem, / t'i lājem, t'i lidhjem /
 lavomazit me gjak / të piksur: nëmrëm / kësish katerqind: /
 jatronjvet ja shkuem / t'i kën nënd sīt, / t'i japen jatrūt... (IX, 127-128)*

Sa Arbëreshë qenë vrarë, pra, Skanderbeku ja pyen Dukagjinit:

*.....
 'Mos xure, Dukagjin, / sa qën të vrarit / ànes të n bushter '. /
 'Jo më se nj'ushter / Njëqind e njëzetshë' - / tha zoti Drinot... (IX, 171-172)*

Gjatë darkës madhështore, Skanderbeku i jep të pinë, ka qelqi tij, komandantëvet të ushtrës s'tij.: Nderushit (të dhëndrrit Kont Uranit), ç'u qell i bushtër më se gjithë; pra Arianitit, Dusmanit, Golemit, Kont Uranit, Nik Petës, Xernoviqit, Muzaqit, Ndreut Topisë, Pjetrit Spanōit, Lekës Xakarisë, Dukagjinit.

Lajmi i gavnjisë arbëreshe mbi Turqit përhapet te nj'çikë herë, e në Dibër e në Krujë:

*Mbrënda atjè këmboret / e qishvet ndondōjen, / te vashat me valet /
 gjithonit gzojen; / e mënjān ve / këndojoen edhe pjeqt (IX,18)*

Te kampi i Skanderbekut jo gjithë fjënë: Nderushi i këndon Xhuditës, nuses s'tij, ç'është ndë Krujë e e pret:

*E kuqez e e bārdh / si molla ti jē; / të mirit e ëmbel /
 e molles ti kē, / hjemadhe e mes-hōll, / o e bukurez mōll.... (X, 19/1)*

Ditën pas, pra që Skanderbeku, me një pjesë të ushtrës, i nguret pas Turqvet që pështojën: hijën në territoret e tyre e djegën e vrasën e vjedhën sa më mundjen; jetra pjesë, nën urdhrin e Kont Uranit ka t'varrosënj, te një gropë gjithë bashkë, Arbëreshët e vrarë. E pra që zotrat e ardhur ka Dibra parkalestin mbi varret e Arbëreshvet, Skanderbeku zë jushtrinë, domethënë lozjet e trimavet. E mbaruar

këta, bën pjesët e ndan gjithë plaçkën ç' i muartin Turqvet:

Bën pjesë, erth zoti / e bën e u spënduen / kështu: qinten pjes / dish bën e dirguen, / ca Shën Kollit Bār, / ë Dekjes i librār, e ca Shën Mërizes, / ë t' i bëri ndër / e Skutar Qish kesh... (XII, 59-60) ...Di pjes / pān kush u cnuen, / trī kush lān gjellen / nënd të Dibres qiellen. Një pjes të sallvuerit / pat tin, ë vëlen / prë një shpī e vresht / e prë nj' rroqe dhen. / Krerat prë di pjes / pān petk e turre. (XII, 62-63)

E trimavet çë muartin pjesë te jushtrìa, Skanderbeku i jep një pend që e një mushk.

E pra çë hanë e pinë, niset korteu për në Krujë, ku errëjën pas tri ditësh. E Vallet i dalën përpara, me Xhuditën në krye:

Përpara i këndojen / ture luer e rrethuer / bukurith. Xhudita / me drit, si e dërguer / ka qielli, tue luer, / kangjelin me kënduer, ienej tue këcier / me shoqet kopile / hadhjare. Si kurōr / pikst me trendafile / vallja hër xhirarnej / hër ngjatej e rrangarnej tue këcier e shkonej / nënd krahëzit të ngrëjtur, / si uez ka di vet / dora dora zëjtur... (XII, 144- 146)

Priftrat i dalën përpara e i presën me Kriqen e i këndojën Dhoksen t' Inzoti, e nisen t' venë mbë Qishë.

Sa hijtin mbë Qish / Skanderbeku i pari / ndëmest gjith krerat / shtuera ka Autari / zū dhoksen e këndōj / Tënzoti 'e ndërōi. (XII, 160)

Pas çerimōnies mbë Qishë, Skanderbeku tēfalën gjithë e i mban mendë se lufta me Turkun sapo zu:

...Këtu Skanderbeku / kuj, te ndahet shteku, / Gavnjia drit bënej / ndë pjazmet nj' illi / çë naten zbukuron, / tha: 'Shok, na te millli / ëhjat pak i mbami, / se Turkun s' e vrami si dōj t' ish skotisur. / Rueni prematin / ë bëmi, t' e mbami, / ndë duem leftherin. / Na kështu, prematj t, / jami Turkut vot...'. (XII, 170-72)

Dhe festa mund t' zërë.

Bën di jāv krēmten / e gjith asāj harē, / me triesa nga dita, / të knduera me hjē: / me luta, me karrēr / e ndrishe luftuer asikūna. T' i vejen / këtu ndrishvet hōr / kërshhtë gjith gjuhsh / zotra me kurōr / e karta të shkruera / ka duer të dritsuera: të dhëna gjith shortish / j' arrëjen e të shtrëjt / me kuel, ëhja e ār. / Edhe Papa shëjt / hjēmth e këndōj / ndonj kart 'i dirgōj. (XII, 174-176).

E Poemin Bilota e mbëllin me këtë sekstinë, mbi Turqit e shkretë:

Turqit vën e vijen / bilt të rriskurojen / me petk e shum ār, / se ndër shpī i dojen / e jo ndër filaqit / e Arbrīs ngrit. (XII, 177).

Tek e dijta redacjonë (1878), pas kësaj s'prasje sekstinë, Bilota shënon:

'E furrnùera Kangjelit Dimbëdhjetë ndër 23 Shëndreut 1878. E past Dhoks e ndër Inzot e Shëmria

ë më dhān fuqī e bashk me mua kënduen nderen e Skanderbekut ë bëri kunder Turkut ndrë zbulit e Dibres Posht'.

Përfundime

Bilota, te vogëlia e tij, njeh Skanderbekun e historinë arbëreshe nga Rapsoditë frasnjote të kënduara ka *Vallet* e Pashkëvet; si edhe ka grupet e lashtë të *Cingarvet*, të *Ursit*, të *Pjelzëvet*, të *Atyre që nxijën*, të *Kutullës*, që kujtojnë rrënjat e Arbrit, epopëne Skanderbekjane, Besën e krishterë.

Tri ditë festash. Si ato tri ditë festash që Skanderbeku urdhëron pas mundjes së „Dibres Posht”. Një zakon i „Árbrit” i sjellë nd’ Arbëri!

Një Fatos, Skanderbeku. Më i madhi. Kujtimi i tij, i ndalur te Memëdheu ka Turku, rron i gjallë në dhë të huaj, në Arbërinë e Italisë.

Një pringjipë që s’i gjet mosnjeriu. Pringjipë e komandant, strateg e diplomat, luftar e bestar. Skanderbeku lehet i krishterë, turqit e bëjën musullman; pra pështon e priret i krishterë, rron si i krishterë, lufton Turqit si i krishterë, martohet si i krishterë, vdes si i krishterë. Është një personaxh historik i krishterë.

Skanderbeku duroi mbë vetëhé egersinë e Turqvete: ja thojen Gjergj Kastrioti e i ndërruan ëmër në Skanderbeg!

Gjithë Arbërorët, për katër shekul e gjymës, qenë shtrënguar ka Turqit të bëhshin musullmanë e të ndërrojen ëmret e krishterë;

për 46 vjet, pra, Shqiptarët e krishterë qenë shtrënguar ka Enver Hoxha musullman të mos praktikojën më besën e krishterë;

Skanderbeku Arbëreshëvet i hapi udhën e Italisë, dhe Arbëreshët Skanderbekun e kanë At. Arbërorët me Skanderbekun përvuan erën e Lirisë dhe Pavarësisë: mbësuan ka ai si luftohen Turqit, me trimëri-shpatë-besë të krishterë; mbësuan ka ai si mund t’bashkohet Atdheu. Skanderbeku qe Áti i Arbrit të ri: të lirë, të pavarur, të krishterë, europjan.

Bilota, me poemën „Shpata Skanderbekut ndër Dibret Posht” i kujton Shqiptarëvet se, nëse do të jenë vërtet të lirë, kanë t’i gjasen Skanderbekut.

Po Skanderbeku do kujtuar, studiuar e nderuar në tërësinë e personalitetit ‘tij. Do pranuar si është, jo ashtu si nganjëi i pëlqen.

Nëng është një personaxh për gjithë stinat.

Për gjithë Shqiptarët, kado rrojën, Gjergj Kastrioti Skanderbeku qëndron „Heroi i popullit shqiptar” dhe „Atleti i Krishtit”.

Jo për gjë, sot, „Fjámuri i Kastriotëve” është Flamuri i Shqipërisë. I kuq, me shqiponjë dykrenare të zezë.

Conclusions

During his childhood, Papa Bernardo Bilotta (1843-1918) knows Skanderbeg and the arbëreshe story from the Rhapsodies of Frascineto, sung by the Easter Vallje; as also represented by the historical groups of the Gypsies, the Bear, the Partorientes, the Tintori, the Skull, who recall the roots of Albania, the Skanderbeg's epic, the Christian Faith.

Three days of celebrations. Like those three days of celebrations that Skanderbeg requires after the victory of "Lower Debar". A tradition of Albania brought to Arbëria!

A Hero, Skanderbeg. The biggest. His memory, forbidden in his homeland by the Turks, lives in a foreign land, in the Arbëria of Italy.

A Prince who does not look like anyone. Prince and commander, strategist and diplomat, warrior and believer.

Skanderbeg was born Christian, the Turks converted him to Islam; then he flees and returns to be Christian, he lives as a Christian, he fights the Turks as a Christian, he gets married as a Christian, he dies as a Christian. He is a historical Christian character.

Skanderbeg suffered on his own skin the ferocity of the Turks: his name was Giorgio Castriota and they changed it to Skanderbeg.

All the Albanians, for 4 and half centuries, were forced by the Turks to change their Christian names; for 46 years, then, the Christian Albanians were forced by the Muslim Enver Hoxha not to practice anymore the Christian faith.

Skanderbeg opened to the Arbëreshës the way of Italy, and Skanderbeg is the Father for the Arbëreshës.

The Albanians, with Skanderbeg, felt the wind of freedom and independence: they learned from him how to fight the Turks, with value-sword-Christian faith; they learned from him how to unite the Fatherland. Skanderbeg has been the Father of the new Albania: free, independent, Christian, European.

Bilotta, with the poem "The sword of Skanderbeg in Lower Debar" reminds the Albanians that, if they want to be really free, they must resemble Skanderbeg.

But Skanderbeg must be remembered, studied, honored, celebrated in the entirety of his personality. He must be accepted as he is, not as everyone likes him.

He is not a character for all the seasons.

For all Albanians, wherever they live, Gjergj Kastrioti Skanderbeg remains 'the Albanian People's Hero' and the 'Athlete of Christ'.

That's why, today, the Flag of Kastrioti is the Flag of Albania. Red, with the

black double-headed eagle.

BIBLIOGRAFI

- **Compendio dell’Historia di Giorgio Castriotto soprannominato Scanderbeg principe dell’Albania** – tradotto dall’idioma greco-moderno e corredato di note dal dottor *Andrea Papadopulo Vretò*, tomo primo/tomo secondo, Napoli 1820.
- **De Rada Girolamo**, *La caduta della Reggia d’Albania*, 1870;
- **De Rada Jeronim**, *Vepra Letrare / 1-2-3*, (përgatitur nga Jup Kastrati, Klara Kodra e Perikli Jorgoni), Tiranë 1987;
- **Dhimitër Frangu**, *Veprat e lavdishme të Skënderbeut* (shkruar me dorën e tij nga Dhimitër Frangu, bashkëkohës dhe bashkëpunëtor i heroit legjendar), përktheu nga italishtja e vjetër Lek Pervizi, shtyp.Arbëria, Tiranë 2005
- **Fan S.Noli**, *Historia e Skënderbeut*, kryezotit të Arbërisë (1405-1468), Tiranë 1962.
- **Frang Bardhi**, *Skënderbeu* (apologji) – përktheu nga latinishtja Stefan J.Prifti, Tiranë 1967.
- **Gegaj at Athanas, ofm**, *Arbëria dhe Gjergj Kastrioti Skënderbë (1405-1468)*, Tiranë 1995.
- **Università degli Studi di Napoli ‘L’Orientale’**- Dipartimento di Studi dell’Europa orientale : Atti del Convegno Internazionale „Giorgio Castriota Scanderbeg nella storia e nella letteratura (Napoli 1-2 dicembre 2005), a cura di Italo Costante Fortino – Edmond Çali: *Italo Costante Fortino: Un poema inedito su Scanderbeg di Giuseppe Angelo Nociti, pp.153-194*, , Napoli 2008.
- **Università degli Studi di Napoli ‘L’Orientale’**- Dipartimento di Studi dell’Europa orientale : Atti del Convegno Internazionale „Giorgio Castriota Scanderbeg nella storia e nella letteratura (Napoli 1-2 dicembre 2005), a cura di Italo Costante Fortino – Edmond Çali: *Agostino Giordano, La ‘Shpata e Skanderbeku’ di B.Bilotta*’, pp.195-219, , Napoli 2008.
- **Universiteti shtetëror i Tiranës** – Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, *Historia e Shqipërisë*,
- vëllim i parë, hartuar si tekst nga Selim Islami e Kristo Frashëri, Tiranë 1959.
- **Universiteti Shtetëror i Tiranës**-Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë: *Marin Barleti, Historia e Skënderbeut*, përkthyer nga Stefan J.Prifti, Tiranë 1964.
- **Universiteti Shtetëror i Tiranës** –Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, *Binard Bilota: Shpata Skanderbekut në Dibrë Poshtë*, redaktuar, pajisur me shënime dhe me hyrje nga P.Emanuil Jordani, Tiranë 1967;

- * **B.Bilota**, mbi Luftën e Shqiptarëve kundër Turqvet - fund shek.XIX- fillim shek. XX - shkruajti e botoi edhe këta „Kangjele”:
- „Një mil vjet të bërth të shkëlqier me nusen e rë, ti, zoti G.Krisosmi Bulār, rrofsh’, poezi’ (në
- „*Stima agli ottimi, biasimo ai tristi*’, Castrovillari, tip.Patitucci, **1898**, f.12);
- *Italia e Francia, brindando, si scambiano i felici augurii per le rispettive loro Nazioni lottanti contro la barbarie tedesca e Musulmana*, Castrovillari, tipografia Vincenzo Macrini, **1916**, ff.22.

Migena SHEHU

KUFIRI JUGOR I SHQIPËRISË DHE ISHUJT E EGJEUT ANALIZË E KORRESPONDENCËS DIPLOMATIKE BRITANIKE PËRGJATË VITEVE 1913 - 1914

Abstract

Në këtë artikull synohet të analizohet lidhja e kufirit jugor të Shqipërisë me Ishujt e Egjeut, duke trajtuar duke trajtuar korrespondencën diplomatike britanike përgjatë viteve 1913 – 1914. Telegramet e pasqyruara në artikull ndahen në dy pjesë, në pjesën e parë janë analizuar telegramet që tregojnë propozimet e Fuqive të Mëdha perëndimore për kufijtë jugorë të Shqipërisë, Ishujt e Egjeut dhe Ishujt Aziatik nën pushtimin Italian, ndërkohë që në pjesën e dytë janë pasqyruar telegramet që tregojnë interpretimin e vendeve Ballkanike për propozimet e Fuqive të Mëdha rreth Ishujve të Egjeut dhe Ishujve aziatik. Në Konferencën e Ambasadorëve ishte pararendosur që këto dy çështje të ndërlihdeshin dhe të zgjidheshin me njëra-tjetrën. Aty ritheksohet vendimi për t'ia lënë të gjithë Ishujt Greqisë, me qëllim që të arrihej një marrëveshje për kufijtë jugorë të Shqipërisë.

Pikërisht në këto telegrame shohim sesi Britania e Madhe kërkon që vendet Ballkanike, por edhe shtetet e Europës të mbajnë parasysh ekuilibrat midis fuqive dhe stabilitet të paqen në rajon. Nuk është për faj të Greqisë, Turqisë apo Shqipërisë që marrëdhëniet midis tyre të ishin kontraditore. Kjo i faturohet drejtpërdrejt Fuqive të Mëdha për të vetmen arsye se asnjë zgjidhje nuk mund të konsiderohet e tillë (zgjidhje) për aq kohë sa ajo nuk vjen si artikulum i brendshëm i nevojave dhe interesave të shtetit që e prodhon dhe mbart problemin. Cilido të ishte vendimi që Fuqitë e Mëdha të merrnin, efekti i pritur do të ishte po i njëjtë me atë situatë që prodhoi zgjidhja e dhënë. Kjo sepse megjithë qëllimin e mirë për të shmangur çdo konflikt të mundshëm në Ballkan, Fuqitë e Mëdha nuk mund ta shkëpusnin dot interesin e tyre nga vendimi që do merrnin, pa llogaritur interesat dhe marrëdhëniet mes tyre. Nga gjithë kjo korrespondencë vërejmë se “çështja ballkanike” ishte tashmë çështje nën përgjegjesinë e tyre sepse secila prej këtyre Fuqive të Mëdha projektonte interesat e veta në secilin prej shteteve Ballkanike.

Fjalët kyçe: Kufijtë jugorë të Shqipërisë, Ishujt e Egjeut, ekuilibër midis Fuqive të Mëdha, stabilitet i rajonit.

Në këtë artikull synohet të analizohet lidhja e kufirit jugor të Shqipërisë me Ishujt e Egjeut. Punimi do të ndahet në dy pjesë kryesore, ku në pjesën e parë do të trajtohen telegramet që tregojnë qëndrimin e Fuqive të Mëdha europiane dhe propozimet e tyre për kufijtë jugorë të Shqipërisë, Ishujt e Egjeut dhe Ishujt Aziatik, nën pushtimin Italian. Ndërkohë në pjesën e dytë të punimit do të paraqiten telegramet që tregojnë interpretimin e vendeve Ballkanike për propozimet e Fuqive të Mëdha rreth Ishujve të Egjeut dhe Ishujve aziatik. Do të ndalem në mënyrë specifike te Greqia dhe Turqia duke qënë se këto të fundit ishin shtetet e prekura drejtpërdrejt nga ky vendim. Që në Konferencën e Ambasadorëve ishte paravendosur që këto dycështje të ndërlihdeshin dhe të zgjidheshin me njëra-tjetrën. Mund të citojmë telegramin nr. 536 Sër Edward Grey i shkruan ambasadorit anglez në Austro- Hungari, Sër M. de Bunsen: *“propozimi ynë që në Konferencën e Ambasadorëve në Londër ishte që këto dy çështje të ndërlikuara të zgjidheshin së bashku, sepse nëse çështja e ishujve shtyhej për më vonë, kjo rrezikonte zgjidhjen e Kufirit Jugorë të Shqipërisë, sepse të dyja çështjet ishin të ndërlihdura, dhe ishte rrjedhojë e mirëkuptimit që Greqia të mbante të gjithë ishujt që ishin nën pushtimin e saj, me përjashtim të dy ishujve Tenedos dhe Imbros, që u arrit një marrëveshje për ti dhënë Shqipërisë Korçën dhe kepin e Stilos”*.¹

Më 3 tetor 1912, pavarësisht nga kundërshtimi i fuqive të mëdha europiane, serbët, malazezët, bullgarët dhe grekët të bashkuar në Lidhjen Ballkanike, filluan Luftën kundër Portës së Lartë². Armëpushimi për t'i dhënë fund Luftës së Parë Ballkanike u nënshkrua në 3 dhjetor 1912. Fitorja e shpejtë e aleatëve Ballkanikë dhe dobësimi i madh i ushtrisë turke gjatë këtij konflikti solli ndërthurjen e interesave ndëreuropiane në çështjen e gadishullit dhe si pasojë më 17 dhjetor 1912 nisi punimet Konferenca e Ambasadorëve në Londër. Në këtë konferencë u diskutuan dy çështje të rëndësishme për Shqipërinë : a) statusi i shtetit shqiptar, për të cilin pas shumë diskutimesh, më 29 korrik 1913, ambasadorët morën një vendim formal për të njohur Principatën e Shqipërisë si shtet sovran të pavarur nga Perandoria Osmane; dhe b) Çështja e kufijve shqiptar. Lufta diplomatike për kufijtë e Shqipërisë u zhvillua midis Austro- Hungarisë dhe Italisë, mbrojtëse të çështjes shqiptare dhe Ruisë, mbrojtëse së çështjes slave³.

Për ravijëzimin e kufirit jugor të Shqipërisë u ngrit një komision ndërkombëtar, në të cilin nuk kishte përfaqësues grekë dhe shqiptarë. Që në mbledhjet e para, Komisioni u bë arenë e një lufte të ashpër midis përfaqësuesve të Bllokut Qendror dhe atyre të Antantës dhe ai ndeshi në pengesa shumë të mëdha në

¹ Duka, V., Dokumentet britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, vëllimi i parë, 2012, fq. 583

² Po aty, Duka, V., fq 583

³ Josef Swire, Shqipëria: Ngritja e një mbretërie, Tiranë:Dituria,

terren prej palës greke. Për këtë arsye komisionerët vendosën të largoheshin nga Gjirokastra për ta vazhduar punën e tyre në Firence, ku kishin mundësi të përgatisnin edhe hartat. Pikërisht në Firence, në mbledhjen e 17 dhjetorit 1913, u hartua dhe u miratua protokollit i kufirit Shqipëri- Greqi, që është dokumenti bazë dhe sot për kufirin midis dy shteteve⁴.

Me nënshkrimin e Protokollit të Firences, pritej që qeveria greke të largonte ushtrinë e saj nga Shqipëria Jugore, por nuk ndodhi kështu. Duke e parë të pamundur kundërshtimin e hapur të Protokollit të Firences, kryeministri grek Venizellos deklaroi se do t'i tërhiqte trupat e tij nga Shqipëria, kur të zgjidhej në favor të Greqisë problemi i Ishujve të Egjeut⁵. Me këmbënguljen e Austrisë, Fuqitë e Mëdha, siç ishte vendosur në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, i deklaruan qeverisë greke se ishin gati të plotësonin kërkesat e saj për ishujt e Egjeut, pasi ajo të largonte ushtrinë e saj nga tokat e Shqipërisë së Jugut. Sipas notës së Fuqive të Mëdha, Greqia duhej të fillonte largimin e ushtrisë më 1 mars 1914 dhe ta mbaronte më 31 mars 1914.

Në Konferencën e Ambasadorëve diskutohej realisht, ose të paktën në objektivin e saj të shqyrtimit ishte pikërisht përcaktimi i kufijve të Shqipërisë, por paralelisht me trajtimin e kufijve shqiptarë iudha zgjidhje tri çështjeve me interes dhe ndikim në arenën ndërkombëtare. Konkretisht 1) përcaktoheshin kufijtë e Shqipërisë, 2) ekuilibrat në Ballkan/ Mesdhe ruheshin, Greqisë iu përmbushën kërkesat e saj dhe 3) i jepej fund definitivisht hegjemonisë së Perandorisë Osmane në Ballkan.

Konferenca e Ambasadoreve, de facto u mblodh midis Fuqive të Mëdha, për të përcaktuar fatin/ecurinë e mëtejshme të raporteve midis shteteve të Ballkanit, pas Luftës së Parë Ballkanike, por që në diskutimin dhe shqyrtimin e këtij raporti nuk u konsideruan shtetet e Ballkanit, të cilët as nuk qenë prezent. Rrjedhimisht, vendimet që do merreshin nga kjo Konferenca do të qenë zgjidhje për të tri çështjet e përmendura më sipër, por që realisht nuk i zgjidhnin ato. Pra, çdo zgjidhje do të ishte e diktuar dhe nuk i jepte zgjidhje problemit.

Gjatë leximit të dokumentave britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, telegrami 373, i dërguar nga Sër Eduart Grey për z. F. Bertie është telegrami më i rëndësishëm, sepse në përmbajtjen e tij vendosen kushtet midis Fuqive të Mëdha për çështjen shqiptare. Aty ritheksohet vendimi për t' ia lënë të gjithë Ishujt Greqisë, me qëllim që të arrihej një marrëveshje për kufijtë jugorë të Shqipërisë. I po të njëjtës rëndësi është edhe telegrami 479, ku Sër Edward Grey i komunikon Sër F. Bertie, se kursi i ndërmarrë do të mundësojë mënyrën më të mirë për të arritur të sigurohet bashkëpunimi i qeverisë greke në një zgjidhje

⁴ Po aty, Duka, V., fq 24

⁵ Duka, V., Dokumentet britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, vëllimi i parë, 2012, fq 411

të përgjithshme, e cila ndër të tjera do të kapërcente vështirësitë në Shqipërinë e Jugut⁶. Çështja e kufirit jugor të Shqipërisë, në thelb nuk përbente interes. Fakti që i duhej dhënë një zgjidhje kufijve, shihej si kapërcim i vështirësive, për arritjen e qëllimit final: të mos cënoheshin marrëdhëniet e miqësisë midis Fuqive të Mëdha.

Një konflikt dhe kërcënim i mundshëm shihej edhe Turqia, e cila në rastin e një konflikti me Greqinë, do të rihapte çështje edhe më të mëdha në Ballkan, të cilat edhe këto ishin jashtë interesit të gjashtë Fuqive të Mëdha. Pra, zgjidhja që do jepej duhet të merrte parasysh njëkohësisht edhe Turqinë edhe Shqipërinë. Telegrami 479 pika 6mbart dhe trasmenton pikërisht këtë shqetësim se duke dështuar arritjen e një zgjidhjeje të njëkohshme, për Ishujt e Egjeut dhe Ishjut nën pushtimin Italian, atëherë do të ketë trazira në vetë Greqi dhe po ashtu rrezik për probleme të mëtejshme midis Greqisë dhe Turqisë që do të mund të rihapin edhe çështje akoma më të mëdha. Ishte në interesin e të gjitha Fuqive, duke përfshirë edhe Turqinë, që paqja e arritur më në fund në Ballkan mos të prishej pësëri. Qeveria e Madhërisë së Tij mbështet në mënyrë të vazhdueshme zgjidhjen e dhënë nga pala greke, ndoshta sepse ishte e vetmja palë ndër vendet Ballkanike që artikulonte kërkesat e saj praktikisht, ose ndoshta sepse vetë Britania e Madhe ishte e interesuar të plotësonte dhe përforconte pozitat greke në rajon dhe fton edhe fuqitë e tjera të bien dakord dhe të bashkëpunojnë në mënyrë të menjëhershme.⁷ Pikërisht në këtë telegram shohim sesi Britania e Madhe kërkon që vendet Ballkanike, por edhe shtetet e Europës të mbajnë parasysh ekuilibrat midis fuqive dhe stabilitetin e paqen në rajon. Vendime dhe qëndrimet e tyre të nisen vetëm nga kjo tablo makrostrategjike dhe jo nga interesa të ngushtë aleatësh dhe aleancash.

Në pikën 8 të po këtij telegram Sër Edward Grey specifikon qënrimin ndaj Turqisë dhe çështjes së Ishujve aziatik dhe shprehetse, është shumë e nevojshme që kushtet përfundimtare të këtyre ishujve të miratohen nga Fuqitë dhe t'i komunikohet Portës së Lartë, se ato kanë vendosur që të gjithë ishujt t'i ktheheshin Turqisë, me kusht që në ta të instalohet një formë e përhershme administrimi autonom nën sovranitetin e sulltanit dhe klauzolat për fortifikimet, do të jenë të ngjashme me ato që do të zbatohen për ishujt grekë. Britania e Madhe është kaq e kujdeshme për ti vënë në dukje fuqive europiane se me Portën e Lartë, duhet të tregohet kujdes që të informohet zyrtarisht dhe në kohë për vendimet e tyre në mënyrë që të mos humbas ekuilibri, dhe të plotësohen edhe kërkesat e saj, por zgjidhja që i'u dha problemit, zgjidhje që në fund të fundit favorizonte Greqinë, nuk synonte dhe nuk kishte qëllim primar të kënaqte këtë

⁶ Po aty, Duka, V., fq 506- 507

⁷ Duka, V., Dokumentet britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, vëllimi i parë, 2012, fq 507

të fundit, por ishte konsideruar si kompromis të cilin Greqia ishte e detyruar ta pranonte. Kjo pasqyrohet në pikën 9 të telegramit 479 *“Qeveria e Madhërisë së Tij ka besim se Fuqitë do ta vlerësojnë natyrën pajtuese të këtij kompromisi, mbi të cilin, ndryshe nga preferenca e tyre e fortë e shprehur më parë për dhënien Greqisë të të gjithë Ishujve të Egjeut, ato kanë rënë dakord tani, në interes të një mirëkuptimi miqësor midis Fuqive, kompromis të cilin z. Venizellos të nxitet ta pranojë.”*⁸

Fakti që i mëshohej zgjidhjes së dyçështjeve njëkohësisht dhe menjëherë, dëshmon edhe njëherë natyrën pajtuese të këtij kompromisi. Në të tillë mënyrë, vendimi në kurriz të Turqisë (që iu hoqën ishujt që ajo kish në zotërim dhe iu dhanë Greqisë), bëhej më i pranueshëm për Turqinë. Vendimi që Fuqitë e Mëdha i kishin dhënë Greqisë Ishujt e Egjeut, i vinte ato përballë detyrimit të shlyerjes së këtij dëmi Turqisë duke i dhënë ishujt nën pushtimin italian. Deri tani, çdo zgjidhje është në funksion të ruajtjes së ekuilibrit midis Fuqive të Mëdha, fakt që evidenton qartazi anashkalimin e çështjes së kufirit shqiptar dhe si pasojë zgjidhja e saj u diktua e kushtëzuar nganjë kërkesë që Fuqitë e Mëdha duhet të përmbushnin para zgjidhjes së çështjes së kufijve të Shqipërisë. Në axhendë prevalonte kënaqja e Turqisë dhe Greqisë, për rrjedhojë, kënaqte paralelisht edhe interesat e Fuqive të Mëdha të të dy blloqeve.

Ambasadori anglez në Athinë, Sër F. Elliot i shkruan Edward Grey në telegramin 496, rreth bisedës së tij me Z. Venizellos, i cili kërkon që të merren masa të menjëhershme çështjet e ishujve nën pushtimin grek dhe atyre nën pushtimin italian të zgjidhen në të njëjtën kohë më çështjen e kufirit jugorë të Shqipërisë⁹. Pavarësisht se Britania e Madhe e gjykonte si jo të mençur që Greqia të ngrinte çështjen e ishujve të cilët ishin ende nën zotërimin e saj, logjika e qëllimit për të cilin ishte mbledhur Konferenca e Ambasadorëve mund të përmbushej nëse konfliktet dhe problematikat në Ballkan do të zgjidheshin njëkohësisht dhe paralelisht me njëra tjetrën për shkak se ishin të ndërthurura. Nëse do të ndodhte ndryshe, që secila çështje të trajtohej veç e veç mund të lindnin natyrshëm diskutime dhe të vihej në pikëpyetje paanësia e vendimit të marrë për secilin nga rastet.

Kjo do të linte të hapur pretendimet e vazhdueshme të Greqisë, Turqisë apo Shqipërisë edhe pse kjo e fundit nuk konsiderohej si faktor për Fuqitë e Mëdha. Në fund të fundit konflikti do të mbartej dhe do të prodhohej pikërisht ajo që synohej të shmangej dhe që u përsërit në Luftën e Dytë Ballkanike. Megjithë strategjinë dhe taktikën e mirëmenduar të Fuqive të Mëdha për adresimin e çështjeve në Ballkan rast pas rasti, çështjet mbeten të pazgjidhura dhe mbarten

⁸ Po aty, Duka, V., f 508

⁹ Duka, V., Dokumentet britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, vëllimi i parë, 2012, fq 531

për një zgjidhje reale dhe jo për një gjetje të aty për atyshme. Pjesë të cilat ilustrojnë këtë fakt në mënyrë eksplicite jepen në dokumentin 505 ku thuhet: *“Fuqitë vendosën t’ia kalojnë Greqisë të gjithë ishujt e Egjeut që aktualisht janë nën pushtimin grek me përjashtim të ishujve Tenedos dhe Imbros, të cilët duhet t’i rikthehen Turqisë, si dhe me përjashtim të ishullit Kastelorizo. Fuqitë kanë vendosur që për ishujt që i janë lënë Greqisë duhet të ofrohen garanci të kënaqshme prej qeverisë Helene për Fuqitë dhe Turqinë që këta ishuj nuk do të fortifikohen dhe as nuk do të përdoren për qëllim ushtarak dhe se do të merren masa për parandalimin e kontrabandës midis ishujve dhe tokës turke.”*¹⁰

Nuk është për faj të Greqisë, Turqisë apo Shqipërisë që marrëdhëniet midis tyre të ishin kontraditore. Kjo i faturohet drejtpërdrejt Fuqive të Mëdha për të vetmen arsye se asnjë zgjidhje nuk mund të konsiderohet e tillë (zgjidhje) për aq kohë sa ajo nuk vjen si artikulum i brendshëm i nevojave dhe interesave të shtetit që e prodhon dhe mbart problemin. Cilido të ishte vendimi që Fuqitë e Mëdha të merrnin, efekti i pritur do të ishte po i njëjtë me atë situatë që prodhoi zgjidhja e dhënë. Kjo sepse megjithë qëllimin e mirë për të shmangur çdo konflikt të mundshëm në Ballkan, Fuqitë e Mëdha nuk mund ta shkëpusnin dot interesin e tyre nga vendimi që do merrnin, pa llogaritur interesat dhe marrëdhëniet mes tyre. Nga gjithë kjo korrespondencë vërejmë se “çështja ballkanike” ishte tashmë çështje nën përgjegjësinë e tyre sepse secila prej këtyre Fuqive të Mëdha projektonte interesat e veta në secilin prej shteteve Ballkanike.

Qëndrimi i vendeve Ballkanike rreth zgjidhjes së propozuar

Në pjesën e parë të këtij artikulli u paraqitën telegramet e Fuqive të Mëdha europiane në lidhje me propozimet e tyre për çështjen e kufirit jugorë të Shqipërisë dhe Ishujve të Egjeut. Në këtë pjesë të dytë do të paraqiten telegramet që tregojnë interpretimin e vendeve Ballkanike për propozimet e Fuqive të Mëdha. Janë zgjedhur telegramet e Turqisë dhe Greqisë sepse Shqipëria nuk kishte një autoritet qeverisës të njohur si subjekt politik në arenën ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe dhe nga vendi ynë në Londër telegramet vinin vetëm nga Konsulli i Përgjithshëm Lamb. Në telegramet e Sër Lamb, raportohen vetëm trazira në fshatra të ndryshëm kufitar të cilat jo rallë here janë aq të rënda sa përfundojnë në djegie dhe shfarosje të këtyre fshtrave.

1. Greqia

Duhet theksuar telegrami 464, i dërguar nga ambasadori anglez në Greqi, Sër F. Elliot për Sër Eduart Grey, 10 dhjetor 1913, ku tregohet biseda e Z. Venizellos

¹⁰ Po aty, Duka, V., fq. 545

me Sër Elliot. Fillimisht ai vë në dukje se “*popullsia e Epirit do t'i rezistojë me forcë bashkimit të saj me Shqipërinë. Ai (Venizellos) nuk i ka inkurajuar dhe as nuk i ka armatosur epiriotët, por as nuk i ka parandaluar ata të armatosen vetë*”¹¹ më tej Z. Venizellos shprehet i pavendosur ende nëse duhet ti tërheq trupat greke sipas kërkesës së Europës, ose nëse do të dorëhiqej, por ai këmbëngul se Çështja e ishujve duhet të zgjidhet njëkohësisht dhe e mbështet mendimin e tij në këtë analizë: Nëse do të mund të shihet që sakrifikimi i Epirit të Veriut është 1) pjesë e një zgjidhje më të madhe, e cila i njihte Greqisë zotërimin e Ishujve që ndodheshin nën pushtimin e saj me përjashtim të Imbros dhe Tenedos, 2) siguronte edhe tërheqjen e Italisë nga ishujtë e tjerë dhe 3) u siguronte atyre një autonomi të gjerë nën sovranitetin turk; atëherë ai do të mund të siguronte pranimin e saj. Kjo është një taktikë e zgjuar e Z. Venizellos, e njohur nga studiuëset e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe e hasur në të gjithë karrierën e tij diplomatike. Kujtojmë këtu prezencën dhe performancën e tij në Konferencën e Parisit 1919, ashtu si edhe në këtë rast, Venizellos arrin ti mbrojë interesat e Greqisë, me mprehtësi dhe negociata të sukseshme, të cilat i shkojnë përshat edhe interesave të Fuqive të Mëdha për rajonin. Në negociatat e tij pas fazës së parashtrimit të kërkesave, ai procedon me fazën e dytë atë të shpërblimit të Fuqive të Mëdha (palës tjetër negociuese) duke premtuar ndalim të rezistencës locale dhe stabilitet në Epirin e Veriut dhe përfundon në fazën e tretë pikërisht atë të kërcënimit dhe shprehet se nuk do të mund të mbante pozicionin e tij, nëse, pas tërheqjes nga zonat e kontestuara, nuk do të plotësoheshin kërkesat e sipërpërmendura. Kështu ai siguron që këto çështje të zgjidhen në të njëjtën kohë dhe menjëherë.

Në një tjetër telegram, pikërisht atë nr. 496, Sër F. Elliot iraporton Sër Edward Grey një tjetër bisedë me Z. Venizellos ku ritheksohej kërkesa e z. Venizellos për një marrëveshje për çështjet që kanë mbetur pezull me qëllim që ai mund të ishte në gjendje që ta pajtonte kombin me braktisjen e epiriotëve, megjithëse asnjë nuk do të mund të parandalonte rezistencën lokale¹². Në këtë telegram shpjegohet edhe arsyeja pse pala greke këmbëngulte kaq shumë në zgjidhjen e menjëhershme dhe të përbashkët për Ishujt e Egjeut dhe çështjen e Kufirit Jugor të Shqipërisë. Duke qënë se pushtimi Italian ishte i tejzgjatur, frika greke ishte se mos pushtimi bëhej i përhershëm dhe prandaj lind nevoja e një zgjidhjeje përfundimtare formale, e cila i garantonte Greqisë zotërimin e të gjithë Ishujve të Egjeut. Së paku kështu ajo përfitonte zotërimin e Ishujve përkundrejt sakrifikimit të territoreve në Epirin e Veriut.

Atëherë kur pala greke kupton se Fuqitë e Mëdha janë në rrugën e duhur

¹¹ Duka, V., Dokumentet britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, vëllimi i parë, 2012, fq 493

¹² Po aty, Duka, V., fq 494

për të përmbushur kërkesat e saj, ajo del me një tjetër pretendim. Pikërisht në telegramin 34, të datës 9 janar 1914, ambasadori anglez në Itali R. Rodd i shkruan Sër Edward Grey. Për një bisedë mes tij dhe Z. Venizellos ku ky i fundit kërkon miratimin e Fuqive të Mëdha për një shkëmbim teritorësh mes Shqipërisë dhe Greqisë. Bëhet fjalë pikërisht për kufirin që është përcaktuar pret një copë të vogël veriore të krahinës së Progonianit, e cila përmbante fshatra grek dhe ishte plotësisht greqishtfolëse. Krahina e kërkuar përfshinte vetëm rreth 500 km katror, por rreth 8000 veta nga kjo krahinë jetonin në fakt në Athinë dhe marrëdhëniet e tyre me popullsinë vendase e bënë paqetimin tepër të vështirë në të ardhmen. Në këmbim të një rripi të konsiderueshëm bregdetar që ishte dhënë asaj nga ana e komisionit, në jug të kepit të Stilos deri në Pagania. Së bashku me lëshimin e këtij rripi ai do të propozonte një pagesë për Shqipërinë prej 200 000 mijë sterlina si kompesim. Nëse ky propozim do të pranohej do të mundësonte atij të merrej me situatën në Greqi, ku ai besonte se mund të arrinte të siguronte pranimin e tij në përgjithësi. Ministri Italian nuk shihte ndonjë kundërshtim të mundshëm në parim por duhej të konsultohet me Aleatët.¹³ Kjo dredhi diplomatike është tipike e palës greke. Për të përfituar një lëshim në favor të saj për kufirin e vendosur mes Greqisë dhe Shqipërisë nga fuqitë. Ajo përdorë mekanizma të njohura e të vjetra në kurriz të shteteve të tjera Ballkanike. Përfiton nga pozita e saj gjeostrategjike dhe nga dobesitë e brendshme të vendeve Ballkanike për të arritur kompromise me Fuqitë e Mëdha.

Përgjigjia e Z. Edward Grey vjen në telegramin 74, më 21 janar 1914, për F. Elliot. Sër Grey është i kujdesshëm të distancojë veten e tij nga ndryshimet territoriale, pasi kishte qënë presidenti i Konferencës së Ambasadorëve dhe nuk mund të propozonte asnjë ndryshim të vendimeve që ishin arritur nga takimet, por deklaroi se *nuk do të kishte ndonjë kundërshtim për ndonjë ndryshim të kufirit të jugut të Shqipërisë për të cilin z. Venizellos mund të siguronte pranimin e Austrisë dhe Italisë.*¹⁴

Në telegramin 115, të datës 31 janar 1914, ambasadori anglez në Rusi z. Buchanan i kthen përgjigje Z. Grey dhe tregon në mënyrë eksplicite favorizimin e kërkesave të z. Venizellos nga Rusia me qëllim forcimin e pozitave të tij. *“Ministri i Punëve të Jashtme tha se nëse Franca dhe Britania e Madhe do të pranonin vijën e propozuar atëhere edhe Rusia do ta pranonte atë. Ai nuk dëshironte të këmbëngulte në modifikim e propozuar nga z. Venizellos, por mendonte se nëse kjo mund të arrihej atëhere kjo do të forconte pozitën e tij në Greqi.”*¹⁵ Më tej në telegramin 127 të datës 4 shkurt 1914, Sër Buchanan

¹³ Duka, V., Dokumentat britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, Vëllimi i dytë, 2013, f 58

¹⁴ Po aty, Duka, V., fq 107

¹⁵ Po aty, Duka, V., fq 108

informon se qeveria ruse me anë të një memorandumit lajmëron se “*Z. Venizellos ka arritur të marrë me sukses ratifikimin nga ana e Aleancës së Trefishtë. Qeveria ruse mendon se do të ishte ndoshta e dëshirueshme të përcaktohej në mënyrë të qartë dhe të përfshihej Ratifikimi në tekstin e komunikatës që do ti bëhej qeverisë greke. Ajo do të vlerësonte nëse do të kishte pikëpamjet tuaja lidhur me këtë çështje.*”¹⁶ Me miratimin e palës austro-hungareze në telegramin 130, përfundimisht zëvendësohet vija e re e kufirit, siç është sugjeruar nga z. Venizellos, me atë të vendosur në Firence dhe diplomacia greke arrin të korrë një tjetër sukses në favor të saj.

2. Turqia

Në telegramin 516 Sër Edward Grey e udhëzon Z. Mallet, ambasadori anglez në Konstandinopojë, që përballë çdo pyetje të ngritur nga qeveria otomane, të thellohet më tepër në faktin se vija e përgjithshme e përdorur nga ana e Fuqive ka qënë, në varësi të mbajtjes në këmbë të një Shqipërie të pavarur, për të njohur status quo-në territoriale, të krijuar si rezultat i thirrjes për të marr armët. Sër Grey e paralelizon këtë çështje me rastin e çështjes së Andrianopojës dhe Trakës Lindore dhe argumenton se mbi të njëjtin parim ishujt e fituar dhe të pushtuar nga Greqia duhet t’i mbeten asaj duke u bërë një përjashtim në favor të Turqisë në rastin e ishujve Tenedos dhe Imbros dhe duke propozuar garanci të vecanta për ruajtjen e Turqisë ndaj çdo rreziku, që te projektimi, ishujt që janë pranë bregdetit aziatik të mund të përdoren për t’i shkaktuar shqetësime asaj. Së fundmi Sër Grey kërkon që ambasadori Mallet të vërë fort theksin mbi faktin se Fuqitë duan që ishujt që gjenden në pushtimin Italian t’i kthehen Turqisë. Nëse do të pranohet propozimi ynë kjo çështje do të zgjidhet në favor të Turqisë duke siguruar dhe duke regjistruar një vendim formal me shkrim nga ana e Fuqive, që të thotë qartë se Italia duhet të tërhiqet.”¹⁷

Në telegramin 538, të datës 28 dhjetor 1913, Sër M de Bunsen i komunikon Sër Edward Grey, pikëpamjet e ambasadorit turk për propozimet britanike, që njëkohësisht ishin propozimet e të gjitha Fuqive të Mëdha. Ambasadori turk mendon se *nëse kushtet do të pranoheshin ashtu siç janë aktualisht, Turqia ishte e detyruar nga interesat jetike në Azinë e Vogël për të rimarrë me forcë zotërimin e ishujve që propozohet t’i jepen Greqisë. Konflikti që do të ndodhte midis Greqisë dhe Turqisë do të përfshinte në fushëbetejë edhe vende të tjera Ballkanike dhe Ballkani do të ndihej në flakë.*¹⁸ Duket qartë se Turqia kërcënon për luftë gjithëpërfshirëse në Ballkan, duke qënë se prekeshin interesat e saj në

¹⁶ Po aty, Duka, V., fq 152

¹⁷ Duka, V., Dokumentat britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, Vëllimi i dytë, 2013, fq 552

¹⁸ Duka, V., Dokumentat britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, Vëllimi parë, 2012, fq

Azi, por Fuqitë e Mëdha i kujtuan asaj nenin 5 të Traktatit të Londrës, të datës 17 maj 1913 dhe e detyruan ta respektonte verdiktin e tyre.

Natyra komplekse e zgjidhjes optimale të propozuar nga Fuqitë e Mëdha për çështjen e Ishujve të Egjeut vjen si pasojë e dy problemeve: së pari publikimi i parakohshëm i propozimeve të fuqive në gazetën “Temps” të Parisit, i cili ishte një version i paplotë dhe çon në një perceptim të gabuar dhe nxituar të palës turke rreth çështjes, duke sjellë një protestë të Turqisë ndaj këtyre vendime deri sa arrin të kërcënojë me luftë gjithëpërfshirëse në Ballkan. Së dyti pretendimi i Fuqive të Mëdha se publikimet, të cilat aludojnë për një zgjidhje optimale, mund të rrezikojnë kompromentimin. Opsionet për alternative të shumta zgjidhjesh nuk ekzistojnë më, pikërisht se në kërkesën për zgjidhje implikohen shumë interesa që përjashtojnë njëra-tjetrën, por dhe që u nevojitet zgjidhje e njëkohshme. Në telegramin 540, 22 dhjetor 1913, Sër R. Rodd informon Sër Edward Grey, se *“publikimi i parakohshëm i propozimeve në gazetën “Temps” të Parisit ka cuar në një komunikim nga Turqia se ajo nuk mund të bjerë dakord me dhënien e ishujve të bregdetit të saj Greqisë. Versioni francez i propozimeve, siç është publikuar në shtypin e këtushëm, ishte i paplotë dhe sugjeronte një notë paralajmërimi për Italinë se kishte ardhur koha që ajo të zbatonte evakuimin e premtuar të ishujve. Përgjithësisht, publikimii parakohshëm duket se rrezikon të kompromentojë atë që ishte një atmosferë goxha e favorshme për një zgjidhje.”*¹⁹

Në telegramin 543, të datës 24 dhjetor 1913, Sër M. De Bunsen raporton për Sër Edward Grey, shqetësimin e Fuqive të Mëdha për perceptimin turk. “Duke qënë se Çështja e ishujve ishte një çështje jashtëzakonisht e vështirë për tu zgjidhur nga ana e Fuqive, ambasadori shpresonte që Turqia dhe Greqia të liheshin ta zgjidhnin këtë çështje në mënyrë më të pavarur dhe drejtpërdrejt midis tyre, edhe pse e keqja ishte se as Greqia dhe as Turqia nuk kishin gjasa të pranonin në mënyrë pa rezerva vendimin e marrë prej Fuqive. Siç kemi vënë re Turqia tashmë po deklaronte zhurmshëm se ajo nuk mund të pranonte kurrë që të dorëzonte në mënyrë paqësore sovranitetin e saj mbi ishujt Kios dhe Mítilena dhe ajo ishte e bindur për fuqitë e saj ushtarake për të pushtuar këta dy ishuj dhe dukej tepër e gatshme të provonte një larje hesapësh me Greqinë, në vend që ta linte atë në zotërimin e ishujve. Madje flitej se Turqia do ta kundërshtonte, në gjendjen e saj aktuale, edhe ruajtjen e sovranitetit mbi ishujt, nëse kjo do të kombinohej me autonominë për popullsinë greke sisoj diskutimet e Fuqive të Mëdha duhej të konkludonin sa më parë për të arritur një përgjigje të përbashkët, e cila të kthehej në emrin e Aleancës së Trefishtë.”²⁰

Telegrami 112, i datës 27 janar 1914 M. de Bunsen për Grey, përmban

¹⁹ Duka, V., Dokumentat britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, Vëllimi i parë, 2012, fq f 584

²⁰ Po aty, Duka, V., fq. 589

bisedën me ambasadorin turk në Vjenë, zotin Hilmi Pashën dhe shpreh qartë pozicioni turk rreth çështjes së Ishujve. Në këtë telegram raportohet se toni i Turqisë ishte shumë më pak kërcënues se më pare dhe dukej se kjo e fundit nuk kishte më ndonjë mendim për luftë.²¹ Ajo nuk po shqyrtonte ndonjë fushatë të menjëhershme për rimarrjen e ishujve, ose për ripushtimin e Maqedonisë greke, ajo donte vetëm të rifitonte kohën që i duhej, por Turqia do të inkurajonte, ose do të përkrahte formimin e bandave plaçkitëse në Greqinë veriore dhe Serbi, si dhe nuk do të kishte paqe të qëndrueshme në Ballkan derisa të përmbusheshin kërkesat e Turqisë. Edhe pse Turqia e kishte kuptuar se nuk mund të pritej që Fuqitë të ndryshojnë vendimin e tyre lidhur me ishujt, ajo ishte kokëfortë në pretendimin dhe besimin e fuqisë së saj për të ndihmuar apo penguar paqen e Ballkanit.

Mund të arrihet lehtësisht në përfundimin se politika e këtyre dy vendeve Ballkanike ndryshon shumë nga njëra-tjetra. Në njërin anë kemi Turqinë që karakterizohet nga vendosmëria e saj për ta bërë veten sa më të papëlqyeshme që të jetë e mundur për fuqitë dhe të duket sa më rebele dhe antikomformiste, në anën tjetër kemi Greqinë e cila karakterizohet nga politikat servile dhe finoqe për të arritur qëllimet e saj ekspansioniste në Ballkan.

²¹ Po aty, Duka, V., fq. 141-142

BIBLIOGRAFIA

- Josef Sëire, Shqipëria: Ngritja e një mbretërie, Tiranë:Ditura.
- Valentina Duka, Dokumentet britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, vëllimi i parë, Tiranë: Toena, 2012.
- Valentina Duka, Dokumentat britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, Vëllimi i dytë, Tiranë: Toena, 2013.

Dr. në proces Luljeta TAFANI

SKENDERBEU STRATEG GJENIAL ME JETESHKRIMIN MË TË PËRHAPUR NË EVROPË

Abstrakt

Skënderbeu është rreshtuar me meritë në penteonin e figurave të ndritura të historisë botërore. Si çdo kujtim e evokim edhe 550 vjetori i vdekjes ka zërin e tij se “Skënderbeu në çdo kohë është shqiptari më i gjallë ndër gjithë shqiptarët e tjerë, sepse është më frymëzuesi për ndjenjën kombëtare, është më përbashkuesi për të gjithë shqiptarët kudo ku janë” (Noli). Jetës dhe bëmave të heroit nga kronikanë, biografë, shkrimtarë, studiues e historianë të panumërt, vendas e të huaj i janë kushtuar me qindra e mijëra libra e studime “qindra monografive dhe mijëra artikujve shkencorë kushtuar heroit kombëtar të shqiptarëve të botuara në gjuhë të huaja gjatë qindra viteve që pasuan vdekjen e tij” (Frashëri). Si një figurë historike “përcillet” me dengje dokumentesh nëpër arkivat e vendeve të fuqishme e biblioteka të panumërta gati në të gjithë botën.

Figura Skënderbeut mbetet përherë madhore në historinë e motit të Arbrit dhe atë shqiptare në vijimësi. Ajo gjallon fort në kujtesën kolektive dhe shqiptare. Skënderbeu nuk ishte “vetëm njeri i shpatës, por edhe i vizioneve të mëdha pro-evropiane, iashte vizionari më modern jo vetëm i Shqipërisë, por edhe i Ballkanit”(Kadare). Shqiptarët në momente kryesore kanë ndjerë peshën e frymëzimit të epokës së Skënderbeut. Ato do të kenë nevojë në të ardhmen për ruajtjen e vlerave konstante kombëtare, formësimin dhe çimentimin e karakterit e të identitetit kombëtar e si motivues i shkëlqyer i integritetit euro-atlantik.

Gjergj Kastriotin, është modeli i idealit të atdhetarit shqiptar, që duhet të ndiqet edhe sot, nga kushdo që pretendon një emërtim të tillë, qoftë përballë Shqipërisë e pavarësisë së saj reale, por sidomos përballë Europës dhe kauzave të përbashkëta për të gjithë popujt e saj. Personaliteti i veprimtarisë së strategut brilant, kalorësit të pathyeshëm, mburojë e qyterimit evropian bënë atë që për 25 vjet realizoi të pamundurën dhe të pabesueshmen, duke na lënë të habitur dhe sot. Skënderbeu është përcaktuar nga historiografia shqiptare dhe ajo evropiane mbivlerë e historisë sonë kombëtare se atë e kanë nderuar pjesëtarët e kombit shqiptarë të të gjitha brezave, pavarësisht bindjeve të tyre politike.

Hyrje

Historiografia jonë tashmë i ka dhënë përgjigje disi shtershëm premisave objektive shoqërore politike të domosdoshme për shpjegimin e luftës titanike që ka bërë populli ynë nën udhëheqjen e Skënderbeut.

Së pari, niveli ekonomik mjaft i lartë i pasqyruar sidomos në prodhimin e drithrave dhe përpunimin e metaleve, në lulëzimin e qyteteve etj. Në prag të shekullit XV zhvillimi politik-shoqëror e kulturor i vendit ecte me ritme të barabarta me vendet e tjera të zonës ballkanike e adriatike. Së dyti, interesimi jetësor i masave të prekura drejtpërdrejtë nga vërshimet e pushtuesvë të huaj e nga pasojat e tyre. Së treti, egzistenca e një shtrese shoqërore të aftë dhe e interesuar për të kryer funksione drejtuese. “Njerëz të shkolluar që luajtën një rol drejtues në luftë, kancelar, magjistër, klerikë e oratorë shqiptarë, i gjejmë në shërbim të Skënderbeut”.¹ Të tillë ishin dhe ata udhëheqës luftarakë të kërkuar si mjeshtra të artit të luftës dhe jashtë Shqipërisë në mbretërinë e Napolit, Venedik, Dalmaci, Sicili.

Të dhënat arkivore dhe studimet e shumta flasin se lufta e madhe që u zhvillua në Shqipëri nuk e nxori në mënyrë të befasishme Skënderbeun në skenën historike. Ai u përgatit disa vjet për kthesën historike, forcoi lidhjen me popullin e vet duke mos lënë pas dore dhe lidhjet me botën e jashtme, “njohu forcën dhe pulsën e bashkatdhetarëve por edhe masat njohën talentin dhe urtësinë e kapitenit para se t’i përvisheshin epopesë legjendare”².

Emri i tij u shndërrua jo vetëm si simbol i mbrojtjes së qytetërimit, por dhe një përmendore e rrallë e historisë së lavdishme kombëtare, e fuqisë së bashkimit të shqiptarëve në luftë për ruajtjen e identitetit të tyre. “Skenderbeu thotë M. Shufflaji – është pjella më e shkëlqyer e popullit të tij dhe luftëtari më i tmerrshëm që krijoi në pergjithësi luftrat e Evropës me turqit”³.

Gjergj Kastrioti ishte përfaqësuesi më konsekuent dhe më i shquar i elitës drejtuese shqiptare, që udhëhoqi me vendosmëri frontin e luftës së shqiptarëve kundër pushtuesve osmanë. Në dokumentet e kohës Skënderbeu del si e vetmja figurë drejtues e jetës politike të vendit. Ai do të përmendet “zot” i Krujës, më pas do të cilësohet si “zot i Arbërisë” dhe më 1464, me rastin e ardhjes së Papa Piu II në Ballkan, ai do ta kurorëzonte mbret Skënderbeun.

¹ A. Buda, *Skënderbeu dhe epoka e tij*, referat, marrë nga Studime për epokën e Skënderbeut, Tiranë, 1989,20

² K. Frashëri, *Gjergj Kastrioti në pragun Kryengitjes së Përgjithëshme 1443*, Studime historike, nr.4. V.1967. 221

³ M. Shyflau, cituar nga F. Bytyçi, Konferenac e Studimeve Albanologjike,271.

Skënderbeu strateg gjenial

Mbi të gjitha, Skënderbeu vlerësohet nga studjues të shumtë kryesisht të kohës moderne e asaj bashkëkohore si strateg gjenial. Siç del dhe nga veprat e M. Barletit, Skënderbeu ishte dhe një edukator i shkëlqyer dhe gjeneral i ushtrisë së tij. Energjia e tij ishte e pashtershme, “gjithnjë në levizje e kurrë në prehje”, luante me ushtarët, flinte i armatosur në kampin me gunën dhe mbi rrogëz. Shumë të rralla kanë qenë në mesjete rastet kur një bujar fisnik vizitonte kasollet e fshatarëve, bisedonte me ta përzemësisht dhe kërkonte pjesëmarrjen e tyre të ndërgjegjeshme në luftë kundër armikut të fuqishëm. Kurrë ndonjë princ si ai pati ushtarë kaq besnik e të disiplinuar si ata të ushtrisë së tij.

Skënderbeu ka meritën e edukimit e të përgatitjes të një brezi të tërë komandantësh të shquar që jo vetëm në trimeri por edhe në shkallë dijeshe e kalitjesh të lartë thyen disa gjenerale me në zë të Turqisë. Të tillë ai përgatiti Tanush Topine e Kont Uranin, Andrea Gjinyin, Pjeter Perlati etj. Cilësitë morale të luftëtarëve shqiptarë dhe aftësitë e tyre tekniko-taktike në përdorimin e armëve, mënyrat e të vepruarit të komandantëve dhe prijësve ushtarak, para dhe pas betejave, motivet patriotike që i shtynin ata në luftë, llojet e stërvitjeve me karakter aftësimin dhe kalitjen e rinisë shqiptare që Barleti dhe shkrimtarë të tjerë na i përshkruajnë në veprat e tyre, na bëjnë të formulojmë tezën mbi ekzistencën e një pune edukative ushtarake të organizuar në periudhën e Skënderbeut, në tokën e Arbërit⁴.

Besimi i masave ndaj tij dhe ndaj Lidhjes që kryesonte, bënë që të shkruhej një kapitull lavdiplotë në historinë tonë kombëtare dhe evropiane. Faqe të ndritura të kësaj epoke përbëjnë gati të 31 betejat e Skënderbeut, midis të cilave veçohet Albulena (Ujëbardhës) dhe 3 rrethimet e Krujës. Kruja u bë një nga ata shembuj të mëdhenj që tregonte se përpara zemrës burrërore të një populli liridashës, dështon me turp çdo agresor⁵.

Taktikat e tij ishin të tilla si, shqetësimi i kundërshtarit me sulme të vogla e të papritura, alarme të vazhdueshme të armikut, prerja e rrugëve të furnizimit të ushtrisë, veprimet diversioniste brenda kampit, futja në kurth, pritja, sulmet e befasishme natën nga një ushtri me njerëz që cilësoheshin “tigrat e luftës malore”. Për këto, sikurse thotë Noli, ai meriton lavdërimin e gjeneralit Xhejms Uells: “Ai shkëlqeu mbi gjithë gjeneralët e vjetër dhe modern në drejtimin e një ushtrie të vogël mbrojtëse”⁶. Por lufta e çetave ose lufta për lodhjen e armikut

⁴ Shih dhe Ribaj.P. *Kosova nyje kyçe e sigurisë ballkanike*, Tiranë,2011,13

⁵ Po aty

⁶ Referuar nga Ribaj.P, vepër e përmendur

nuk ishte e vetmja armë e tij. Ai vinte në përdorim edhe goditje ofensive. Në sajë të karakterit sulmues si arma e fortë e strategjisë mbrojtëse, ai asgjësoi e shpartalloi disa herë ushtri shumë të mëdha me një ushtri të vogël ofensive.

Sipas studjuesve Skenderbeu kapërceu jashtëzakonisht shumë, si pararendësit ashtu dhe bashkëkohësit e gjeneralë modernë që u përpoqën të imitonin atë në një art aq të vështirë. Ballkani dhe Evropa shikonin tek Skenderbeu një kapiten të madh, bile edhe në Berat, e vetmja betejë e humbur. Prandaj siç pohon Fallmeyer, Gjergj Kastrioti, njihet në artin e luftës “si një nga kryeluftëtarët më faqebardhë e më të mëdhenj të të gjitha kohërave, fitonjës i kurorëzuar me dafina, që u thye vetëm prej vdekjes”⁷.

Strategjisë osmane për të zgjidhur fatin e luftës në një betejë të përgjithshme të rregullt fushore, Skenderbeu i kundërvuri strategjinë e zinxhirë betejash e veprimesh luftarake duke konsumuar deri në shpartallimin e asgjesimin e kundërshtarit. Skënderbeu realizonte variante veprimi duke goditur ushtrinë armike para se të fillonte mësymjet duke u prishur komandave planin e fushatave. Ushtritë relativisht të vogla, deri në 25 mijë veta, i asgjesonte në zona kufitare, ushtritë e mëdha me anën e betejave të rregullta në thellësi të vendit, në perleshje të përgjithshme në muret e kështjellës si dhe në pjesmarrjen në luftë të gjithë popullit. Strategjia mbrojtëse e Skenderbeut ka karakter sulmues, sepse ai mbrohej duke sulmuar e jo i mbyllur në kështjella si strategët e tjerë mesjetarë⁸.

Skënderbeu ishte i pakapërcyeshëm në artin e manovrimit të ushtrisë qoftë para betejës, gjatë zhvillimit dhe jashtë saj. Ai sulmonte gjithmonë në çastin vendimtar dhe “një mijë ushtarë të tij dukeshin dhjetëmijë”⁹. Ai realizonte sulme të shpejta dhe efikase “pa lejuar grupin e vet të vogël që të përhapej e të shpërndahej, por të qëndronte i bashkuar mirë, duke formuar një masë kompakte dhe të pazgjidhshme”¹⁰. Skenderbeu njihte përsosshmerisht terrenin dhe shfrytezoonte mjeshtërisht vetitë e tij, duke i kushtuar kujdes fortifikimit e ndërtimit të pengesave. Gurëdhësi i përdorur për herë të parë në Krujë, mbetet origjinal dhe ka hyrë në historinë ushtarake botërore “Gurëdhësi shqiptar”.

Skënderbeu bashkonte përsosshmerisht autoritetin e burrit të shtetit me atë të kryegjeneralit, megjithëse pati në dispozicion më pak burime dhe forca materiale, më pak mundësi se cilido nga strategët e shquar pararendës në artin e luftës dhe për këtë bëhet më e padiskutueshme gjenia e Skënderbeut. Vetem

⁷ Fallmeyer, v.8,372, cituar nga F. Nol, vepra IV, Prishtinë, 1988, 182

⁸ Sh.Leka, *Skënderbeu Strateg e Komandant Legjendar*, Tiranë, 1994,75

⁹ G. O .Beken, “Gjergj Kastrioti dhe Murati”, Vjenë 1813, f. 42,perkthim shqip, Arkivi I institutit të Historisë

¹⁰ Robert d’Angely, *L’enigme*, vol,I (les pelages), Parisë, 1919, 114,cituar nga Ribaj. P, vepër e përmendur

beteja e Ujëbardhës (Albulena), ku Skënderbeu pas një manovre energjike të habitshme me shpejtësi rrufe, asgjësoi dhe shpartalloi plotësisht një ushtri gati 4 herë më të madhe, si një strateg i denjë për nderimin më të madh. Albulena është një çudi strategjike dhe me vlera unikale e të pa përsëritshme¹¹.

“Skënderbeu është talent dhe strateg i shquar, katror nga lartësia dhe nga baza” po të përdornim shprehjen orgjinale të Napolonit, sintetizojnë cilësitë dhe virtytet e një gjenerali të madh. Napoloni do ta vlerësonte Skënderbeun si një ndër katër strategët më të shquar të të gjitha kohërave¹². Ndërkohë historiografia jonë ka vërtetuar se vetitë themelore të Skenderbeut, si burrë shteti dhe strateg janë dy anë të të njëjtit personalitet, shpjegohen nga i njëjti vlerësim e realitet i të dhënave të situatës të cilave Skënderbeu diti t’u përshtatej duke marrë parasysh karakterin e agresorëve osmanë në kushtet e Shqipërisë.

Mjafton të kujtojmë veprimet e spikatura të Skënderbeut në betejën e Barletës (një kështjellë në lindje të Napolit) në Itali, ku ushtria shqiptare e drejtuar nga kryetrimi shpartalloi ushtrinë e Jak Piçinino, kondotierit më të zot të Italisë në atë kohë. Në fushatën italiane, shkruan M.Barleti, Skënderbeu ngjalli kohën e Aleksandrit të Mollosisë dhe të Pirros me ndryshimin që doli me faqebardhë¹³. Skenderbeu ishte jo vetëm shembulli i luftëtarit të shquar në beteja e në stërvitje, por dhe organizatori dhe instruktori i asaj ushtrie duke qenë i pari që krijoi ushtrinë e rregullt në Evropë. Ai e krijoi këtë organizim dy vjet para Karlit të VII të Francës¹⁴.

Vlerësimi i karakterit popullor të ushtrisë së Skënderbeut nuk do të na lerë të harrojmë se në të bënin pjesë edhe reparte të rregullta të specializuara, si repartet e ruajtjes së kështjellave, repartet e rregullta të Gardës së Ushtrisë, të qëndrueshme dhe që paguheshin me rrogë. Ato shërbenin për detyra të veçanta kundër armikut në frontin e jashtëm dhe për detyra të brendshme. Shteti i Skenderbeut i kishte të gjitha karakteristikat e një shteti të përparuar të kohës (kishte aparatit karakteristik për shtetin feudal, aparatit e financave, të rekrutimit, të kancelarive diplomatike, lëshonte dokumente të ndryshme me vulen e vet, kishte flamur karakteristik kombëtar).

Shumëkush i njeht tashmë epërsinë e kalorësisë së ushtrisë së Skënderbeut, si një nga armët më efikase, vlerat e të cilës u bënë dominuese në artin e luftës dhe mjaft të përhapura në ushtrinë europiane në betejat e shek. XV dhe XVI. Është rasti të theksojmë se vlerat e kësaj kalorësie janë gati unikale. Pas Marin Barletit, janë mjaft historianë e analistë të huaj, të cilët ndriçojnë problemin e

¹¹ Ribaj Kosova *nyje kyçe e sigurisë ballkanike*, Tiranë, 2011, 15

¹² Po aty

¹³ M. Barleci, vepër e përmendur, 995

¹⁴ Sh. Leka, *Skënderbeu Strateg e Komandant Legjendar*, Tiranë, 1994, 36

pranisë së formacionit të Gardës Pretoriane në Ushtrinë e Skënderbeut. Kryesisht ata janë të trevës italiane, midis të cilëve zënë vend të veçantë, Melkior Mikaeli (Melchior Michaeli) dhe Xhemaria Biemi (Giamaria Biemmi). Mikael hedh një hap të guximshëm, kur pohon se Barleti e nënvizon disa herë praninë e Gardës, por nuk jep shpjegime të hollësishme për organizimin e saj.

Më autoritar dhe më i besueshëm i Historisë së Skënderbeut na prezantohet Biemmi, i cili në vitin 1742 dhe 1756, boton në Breshia (Brescia) librin “Historia e Gjergj Kastriotit - të quajturit Skënderbe”, ose “Istoria di Giorgio Castrioti, detto Scanderbegh”. Në trajtimin e këtij problemi, autoritar dhe i besueshëm mbetet Fan S. Noli, i cili dy herë (më 1921 dhe 1949 L.T.), botoi “Historinë e Skënderbeut”. Pas një pune studimore serioze, duke iu referuar mjaft historishkruesve dhe analistëve për Skënderbeun, si dhe duke shfletuar, studiuar e nënvizuar mjaft literaturë bashkëkohore, arrin në përfundimin se, Skënderbeu, që në fillimet e karrierës si Kryekomandant i forcave ushtarake të Arbërisë, krijoi një trupë të zgjedhur të quajtur “Garda Pretoriane”¹⁵ Një trupë të tillë të përbërë prej jeniçerëve, e pati themeluar sulltan Orhani, prandaj këtë sistem organizimi, e integroi edhe në Shqipëri, duke formësuar një trupë të zgjedhur prej nja tremijë vetash, të cilët për nga disiplina, trimëria dhe besnikëria ishin të gatshëm gjithmonë.

Skënderbeu ka zhvilluar luftime fitimtare gjatë 25 viteve me “ushtrinë e madhe të sulltanit që numëronte nga 80.000 deri në 140.000 njerëz dhe këtë me fuqinë e një grushti shqiptarësh të stërvitur dhe drejtuar prej tij”¹⁶. Mjafton të dihet se çfarë përfaqësonte Perandoria Osmane dhe ushtria e saj, për t’u bindur për vlerat e padiskutueshme të ushtrisë shqiptare. Turqit osmanë me luftrat dhe fushatat plaçkiste ishin kthyer në një shtet të fortë. Ajo “zotëronte territore të mëdha në Evropë, Azi, Afrikë, me siperfaqe 8 milion km katrorë”.

Të rralla janë ato figura si Skënderbeu që kanë patur udhëheqje me zgjatje kohore e bilanc të tillë fitoresh. Huniadi i madh, bashkëkohës i Skënderbeut, vijoi luftën për 14 vjet. Sipas Barletit “Huniadi nuk provoi kurrë ndonjë armik tjetër përveç barbarit, ndërsa Kastrioti nuk fitoi me më pak emer e lavdi “nga lufta në Itali dhe nga çlirimi i mbretërisë së Napolit”. Edhe një gjeni si Napoleoni që luftoi

¹⁵ Shih dhe Ramooli.S,Gazeta Dita 2018

¹⁶ Robert d’Angely, vepër e përmendur,114.(Ribaj shkruan se. për sasinë e trupave pjesëmarrëse në beteja, luftime etj, si dhe numrin e humbjeve të vrarë e të plagosur etj.) janë referuar sipas burimeve të kohës. P. Sh në rrethimin e parë të Krujës numri i trupave osmane arrinë 100.000 veta. Ndërsa sipas rrëfimeve të bashkohësve që e kanë njohur nga afër organizimin e ushtrisë osmane, numri maksimal i trupave të rregullta, që mund të merrnin pjesë në beteja larg viseve të tyre ishte rreth 30. 000 vetë. Gjithësesi, duke i shtuar këtij numri dhe sasinë e shumtë të trupave mbështetëse (logjistike) kjo shifër mund të rritet.

aq sa Skenderbeu, e mbylli karrierën me disfatë, ndërsa Skënderbeu me vdekje, “I vetmi armik që nuk mund të mundej”, do të shkruante Bekoni¹⁷ dhe duke ju dhënë mundësi shtetasve të tij të provojnë shijen e fitores dhe të lirisë për një kohë të gjatë. Epilog i denjë për këtë epokë lavdiplotë skenderberjane qëndrojnë mbrojtja heroike 10 vjeçare e Krujës, qëndrojnë dy rrethimet e Shkodrës (1474 dhe 1478-1479), kala që u mundën më në fund nga uria dhe jo nga armiku.

Simboli i lirisë, me jetëshkrimin më të përhapur në Evropë

Janë të paktë heronjtë e vjetër të Europës që janë kaq të njohur sa Gjergj Kastrioti¹⁸, që ka patur fatin e kaq shumë jetëshkruesve, madje jetëshkrues “të llojit okular” dhe që ka patur jetëshkrimin kaq të përhapur nëpër mbarë Europën, sa Gjergj Kastrioti për të cilin folën gati të gjitha gjuhët e saj. Në zemrat e shqiptarëve figura e Skenderbeut shkoi duke u rritur e duke u bërë legjendare.

Për shqiptarët Skenderbeu qe “kuçedra e botës së Arbrit”¹⁹ dhe “Lavdia e nderi i gjithë dorës arbëreshe”, si kundër e cilësoi Fran Bardhi. Idetë dhe fryma e lëvizjes humaniste evropiane, që ishte përhapur në atë kohë dhe te shqiptarët, ndikoi që lufta e tyre titanike kundër pushtimit osman dhe, sidomos, figura e Skënderbeut të çimentoheshin në vetëdijen kombëtare shqiptare dhe të materializoheshin në krijimtarinë e tyre jo vetëm nëpërmjet gojëdhanave, tregimeve dhe këngëve popullore, por edhe nëpërmjet veprave të para të historiografisë kombëtare, të cilat i përshkruan një pathos i fuqishëm patriotik, siç janë veprat e Marin Barletit, Dhimitër Frangut, Frang Bardhit etj. Studimet monografike fillojnë që nga Marin Barleti, Athanas Gega, Fan Noli, Vahid Kormakut Sabri Godo, Aleks Buda, Kristo Frashëri, Oliver Schmitt, Aurel Plasari, Shahin Lekaj dhe shumë të tjerë.

Noli është i pari historian që ka bërë përpjekje për të ndërtuar bazën shoqërore mbi të cilën Skënderbeu u mbështet dhe e cila i siguroi atij suksese në beteja të shumta që zhvilloi kundër ushtrisë perandorake osmane. Sipas Nolit, Skënderbeu nuk ishte një feudal i modeli evropian, as feudal i ngjyrës ballkanike. Ai mendonte se Skënderbeu ishte një kapedan i talentuar që mbrojt kryesisht interesat e malësorëve të lirë, të cilët deri atëherë i kishin rezistuar presionit të huaj feudal²⁰. Njëherazi, ndihmesë me vlerë përbëjnë disertacioni i Xhevat Korça i mbrojtur në universitetin e Vjenës më 1923, me titull “Tre pyetje nga jeta e Skënderbeut”, si dhe Disertacioni i A. Gegajt që u mbrojt në Universitetin e Leovanit (Belgjikë) në vitin 1937, me titull L’Albani et l’invasion turque au XV-em siècle”.

¹⁷ G. O. Beken vepër e përmendur.

¹⁸ Shi dhe Kulla.Nd, G. Mapo, 27 prill, 2018

¹⁹ Fran Bardhi, Skënderbeu, Tiranë, 1957,73.

²⁰ Frasheri,K, *Skenderbeu i shperfytyruar*.Tiranë,2009,57

Në vijim në Aktet e Konferecës së II Albanologjike në dy vëllime, e cila u mbajt në Tiranë me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut në janar të vitit 1968, aktet e Simpoziumit që u mbajt në Prishtinë etj, Skënderbeu trajtohet si hero jo vetëm nga historianët shqiptarë por dhe ata të huaj. Madje dhe historianët serb si, S Cirkoviç, N. Filipoviç, A. Handziç, R Mihajliç, O. Jasar, etj, të cilët ndryshe nga historianët e dikurshëm nacionalistë serbë, e vlerësuan Skënderbeun për kontributin e madh që dha për popullin e tij.²¹

Si një dhuratë për ta kuptuar më mirë në ndihmë na vijnë veprat e albanologut me famë ndërkombëtare, profesor At Giuseppe Valentini. Ato janë rreth 32 vepra që janë botuar deri më sot dhe qëndrojnë si risia më e madhe kulturore dhe shkencore e viteve të postkomunizmit, në shumicën e të cilave shqyrtohet historia e Shqipërisë, Skënderbeu dhe koha e tij.

Janë të paktë udhëheqësit e luftimeve çlirimtare që kanë gjetur pasqyrim të gjerë në letërsinë botërore. Sigurisht në këtë letërsi burim kryesor letrar ka qënë vepra e M. Barletit e botuar dhe ribotuar në vende të ndryshme, por dhe vepra të autorëve të tjerë. Veçohet këtu në Evropën perëndimore vepra e Zhak Lavardenit : “ Histoire de George Castriot, surname’ Scanderbeg Roy d’ Albanie”, botuar në Paris më 1576 dhe në Evropën lindore vepra e humanistit polak Martin Bjelskit, botuar në Krakov, më 1564, etj. Nxitja themelore e këtyre veprave ka qënë në fund të fundit përpjekja e popujve të Evropës për t’u mbrojtur nga rreziku osman. “Në kohën e Skenderbeut, shkruan humanisti Kasper Hidi, të gjithë së bashku përsëritim njëzëri emrin e ëmbël të lirisë, zemrat e njerzve të lartësuar nga ky emër si nga zëri i trumpetës, përipiqeshin të mbronin lirinë, luftonin për të njësoj si për altaret e vatrat e veta. Sigurisht në qoftëse se nuk na bashkojnë të këqijat që na kanosen, kam frikë se brenda një kohe të shkurtër do t’i shkruajmë epitaf lirisë”²².

Në një masë veprash të autorëve evropianë nën shembullin e betejave e të taktikës fitimtare të Skënderbeut kërkoheshin sa më shpejtë rrugët për dëbimin e osmanëve nga Evropa. “Nuk dua të mbyll sytë pa parë malet e Shqipërisë, dëshmitare të luftës së atij gjeniu luftëtar”, do të shkruante me admirim Ernesto Sabato²³.

Mbi sfondin e Evropës që grindej, figura e Gjergj Kastriotit vjen e rritet nga shekulli në shekull dhe objektivist bëhet një akuzë e rëndë për gjithë politikën e shteteve feudale evropiane. Në historiografinë botërore ndër shekuj janë shkruar shumë monografi të veçanta për Skënderbeun, disa prej të cilave janë ndërthurur me vepra me natyrë tjetër dhe të tjera janë botuar si libra më vete. Figura e Kryetrimt shqiptar është trajtuar gjerësisht edhe në historitë e popujve të ndryshëm, si historia e perandorisë Osmane, historia e Italisë, Greqisë si edhe

²¹ Po aty, 52

²² A. Kostallari, Konferenca e dytë e Studimeve Albanologjike, Vol.I, Tiranë, 1989, 6

²³ Revista Mikste, Tiranë, 1996, 6

në histori të përgjithshme të shteteve të tjera europiane.

Deri në shekullin e XIX historia nuk paraqitej si shkencë më vete, por ishte thuajse gati një gjini letrare edhe për vetë faktin që nuk ka pasur rreptësinë shkencore që ka sot dhe nuk mbështetej mbi dokumente apo burimet arkivale që në ditët e sotme krijojnë bazën e historiografisë moderne²⁴.

Një kontribut të madh në gjetjen e biografive të shkruara për Skënderbeun ndër shekuj ka dhënë edhe Michael Schmidt-Neke, i cili ka publikuar një përmbledhje biografish të panjohur deri më sot, ku trajtohet edhe biografia e Skënderbeut. Kjo vepër është shkruar nga një prift puritan anglez me emrin Samuel Clark dhe mban titullin *“Palca e historisë kishtarë”*. Përkrah ribotimeve franceze u shfaq në Francë në vitin 1855 dhe një monografi e re mbi Skënderbeun që kishte për autor Camille Paganel (1797-1859) një historian. Ai botoi monografinë për heroin tonë kombëtar me titull *“Historia e Skënderbeut ose turqit dhe të krishterët në shekullin e XV”*. Vepra e Paganel-it është e rëndësishme sepse autori u mundua të shkruante një histori mbi baza shkencore për Skënderbeun. Kjo është jo vetëm përpjekja e parë e këtij lloji në Francë, por edhe në historikun e studimeve Skënderbejane deri në shekullin e XX në tërësi²⁵.

Autor i rëndësishëm është dhe Julius Pisko, i cili kur shkroi monografinë *“Skënderbeu. Një studim historik”*, botuar në Vjenë në vitin 1894, ai ishte zv./ Konsull dhe drejtues i konsullatës austro-hungareze në Janinë. Qysh në hyrjen e veprës së tij ai shkruan: *“Gjergj Kastrioti Skënderbeu, heroi kombëtar shqiptar, është padyshim një nga figurat më të spikatura të mesjetës. E gjithë Evropa dridhej nga ecuria e fitoreve të pandalshme të Kalifëve Otomanë, ndërkohë që në një vend idilik të veçuar thërrmoheshin të gjitha përpjekjet e kësaj perandorie nga vendosmëria e hekurt e një personi, i cili ishte në gjendje që me një vështrim ti kthente ushtarët e tij në heronj. Talenti strategjik i shkëlqyeshëm i Skënderbeut, gojëtaria entuziaste, e gjithë magjia që dilte nga personaliteti i tij, e vendosin atë denjësisht në anën e heronjve më të rëndësishëm të gjitha kohërave”*.

²⁴ Kasmi.M, *Mbi disa ngjasime apo krahasime që janë bërë mes Skënderbeut dhe figurave të tjera të shquara evropiane, kumtesë e mabajtur në Simpoziumun shkencor të 540 vjetorit të Skendërbeut në AFA, Tiranë, 16 janar, 2008*

²⁵ Për më gjerë shih Kasmi, vepër e përmendur

Përfundime

Trajtimi tërësor i figurës së Skenderbeut si strateg përmes studimeve bashkohore, nuk është detyrë e kesaj kumtese. Atë nuk e kanë rrokur dot qindra e qindra veprimtari studimore e mijëra botime. Ajo fton e josh gjithashtu studjues të shumtë, midis të cilëve dhe historianë.

Studim të veçantë meriton akoma ndërtimi i aparatit ushtarak e vetë ushtrisë, gjurmimi dhe përcaktimi e preçizimi më mirë i fushë betejave, i kohës së zhvillimit të tyre, i kalave, rrugëve të ndjekura nga ushtritë ndërluftuese, gjeografinë e luftimeve, zbulimi i veprave fortifikuese. Studim të mëtejshëm meritojnë rrugët që lidhin kryeqendrat e kalatë, rrugët e furnizimit, ato të evakuimit e të manovrës etj, që do të përbënte një kontribut për historinë ushtarake e historinë mesjetare në tërësi.

Mes të tjerash do të theksoja, që ende nuk kemi përcaktuar shkencërisht vend betejat e Skënderbeut. Që më 1901 Konica²⁶ i madh shkruante se "...askush s'është marrë me gjetjen e vendeve ku janë zhvilluar betejat fitimtare të Skënderbeut...". Gjithësesi janë bërë përpjekje të lavdërueshme për të realizuar këtë sfidë të historiografisë skënderbereiane. Është rasti të kujtojë me respekt punën e Vahid Kormakut me monografinë e tij "Sheshet e betejave të Skënderbeut në dritë të realitetit", një punë tetëvjeçare (1938-1946), por vdekja e parakohshme nuk e la ta përfundonte dhe të shihte dritën e botimit. Ky pionerë i shkencës së historisë shqiptare, siç e ka vlerësuar A. Buda, kishte shkëlur pothuajse të gjitha vend betejat e Skënderbeut në Dibër, Pollog e Ohër²⁷. Përpjekje të tjera janë bërë dhe nga studiuesë të tjerë, por ende rezultatet nuk janë arritje shkencore bindëse.²⁸

Kështu dihet se nga numri i betejave kryesore të zhvilluara në luftën shqiptaro-osmane, shumica e tyre, 19 beteja, janë zhvilluar jashtë kufirit aktual shtetëror, ndërsa 8 prej tyre janë zhvilluar në pellgun Ohër-Strugë etj. Pa asnjë hezitim figura e Skënderbeut mbetet madhore në historinë e Arbërit dhe në atë shqipëtare në vijimësi. Me të lidhet fakti i një identiteti të fortë shtetëror, i një organizmi institucional të fuqishëm, i një diplomacie të suksesëshme, i një lidhje mes masave e prijësit, pra i një shtetari e strategu brilant.

Çdo kundërvënie nga do që të vijë e për çfarëdo motivi, nuk e zhbënë dot këtë figurë. Ajo gjallon në kujtesën kolektive të shqiptarëve. Dhe ky komb ka mendje dhe energji që ta rikthejë atëhere kur duhet e si duhet. Rilindja e një energjie shtetformuese që i mbledh shqiptarët në një përpjekje të institucionalizuar do të ndjehet, se në fund të fundit kombet formohen në luftë.

²⁶ Faik Konica, Topografia e fushatave të Skënderbeut kundër turqëve, Albania ,nr 7,106-107,

²⁷ L. Tafani, ju kujtoj se në këtë hapsirë Skënderbeu ka zhvilluar mbi 70% të betejave të zhvilluara kundër osmanëve

²⁸ P.sh. për lokalizimin e betejës së Torviollit, autorë të ndryshëm që nga Barleci, Noli, Dilaver Radshi, K. Frashëri e deri te studiuesë ushtarak të AFA, etj e vendosin atë në vende të ndryshme

Conclusions

The thorough handling of Scanderbeg's figure as a strategist through contemporary studies is not the task of this paper. It has not attracted hundreds of hundreds of study events and thousands of publications. She invites and seduces many scholars' authors, including historians.

A special study still deserves the construction of the military apparatus of the army itself, better tracking and defining of the battleground, their time of development, the horse, the roads followed by the warring armies, the geography of the fighting, the discovery of the fortifications. Further study deserves the roads connecting the forts, supply routes, evacuation and maneuvering etc, which would be a contribution to military history and medieval history as a whole.

Among other things, I would point out that we have not yet scientifically determined the Scanderbeg battlefield. Since 1901 Konica the great wrote that: ... no one has to deal with finding the places where Skanderbeg's victorious battles have been developed ... ". However, praiseworthy efforts have been made to realize this challenge of the Scanderbeg story. It is a good idea to remind Vahid Kormaku's work with his monograph "Skanderbeg Squares in the Light of Reality", an eight-year work (1938-1946), but premature death did not stop and see the publication light . This pioneer of the history of Albanian history, as A. Buda has praised, had violated almost all the battlefields of Scanderbeg in Diber, Polog and Ohrid. Other efforts have been made by other scholars, but the results are not convincing scientific achievements.

Thus it is known that from the number of major battles developed in the Albanian-Ottoman war, most of them, 19 battles, were developed outside the current state border, while 8 of them were developed in the Ohrid-Struga basin. Without any hesitation Skanderbeg's figure remains major in the history of Arber and the Albanian one in continuity. Linked to the fact of a strong state identity, a powerful institutional body, a successful diplomacy, a link between the masses of the leader, a brilliant statesman and strategist.

Any opposition from coming to and for whatever reason can not undo this image. She lives in the collective memory of Albanians. And this nation has the mind and the energy to bring it back when needed and properly. The revival of a state-building energy that gathers Albanians in an institutionalized effort will feel that in the end nations are formed into war.

LITERATURA E PËRDORUR

1. Buda.A, *Skënderbeu dhe epoka e tij*, referat, marrë nga Studime për epokën e Skënderbeut, Tiranë, 1989.
2. G.Shqiptare, 11 shkurt,2018
3. D'Angely Robert, *L'enigme*, vol,I (*les pelasges*), Paris, 1919
4. Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, I, Tiranë, 1969.
5. Godo Sabri, Romani “*Skënderbeu*”.
6. Kadare Ismail, Romani “*Kështjella*”.
7. Bardhi Fran, “*Skënderbeu*”, Tiranë, 1957.
8. Frashëri Kristo, *Skënderbeu i shpërftyruar*.Tiranë, 2009.
9. Barleti Marlin, “*Historia e Skënderbeut*”, Tiranë, 1983.
10. Beken. G.O, “*Gjergj Kastrioti dhe Murati*”, Vjenë 1813, Arkivi i institutit të Historisë (perkthim).
11. D'Angely Robert, “*L'enigme*”, vol,I (*les pelasges*), Parisë, 1919.
12. Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, I, Tiranë, 1969.
13. Leka Shahin, ”*Skënderbeu Strateg e Komandant Legjendar*”, Tiranë, 1994.
14. Sovjetskaja Vojenaja Enciklopedia, Moskva, 1980.
15. Bardhi Fran, *Skënderbeu*, Tiranë, 1957.
16. Revista Mikste, Tiranë, 1996.
17. Noli Fan, vepra IV, Prishtinë, 1988.
18. Kormaku Vaid, *Sheshet e betejave të Skënderbeut në dritën e realitetit*, Tiranë, 2012
19. Ribaj Pajtim, *Kosova nyje kyçe e sigurisë ballkanike*, Tiranë, 2011.
20. Studime historike, nr.4. V.1967
21. G. Mapo, 27 prill, 2018

Besnik RAMETI

SA ISHIN TË PËRGATITUR SHQIPËTARET NË ASPEKT DIPLOMATIK NDAJ VENDIMEVE TË KONGRESIT TË BERLINIT (1878-1881)

Abstrakt

Për nder të 140 vjetorit të lidhjes Shqiptare të Prizrenit të organizuar nga Univerziteti Aleksandër Moisiu – Durës” në këtë kumtesë do të paraqes tezën se sa ishin të përgaditur Shqiptarët në aspektin diplomatik ndaj vendimeve të Kongresit të Berlinit 1878-1871.

Në vitet e 70-ta në Evrop kishte përfunduar faza e bashkimit kombëtar por në të njëjtën periudhë do të fillon edhe kriza lindore ku Shqiptarët i gjeti në gjendje shumë të vështir politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe arsimore. Në ballkan sundonte perandoria Osmane e cila ishte në gjendje të vështir andaj me çdo kusht ishte e detyruar që të bënte reforma. Në korik të vitit do të fillojnë kryengritjet në Ballkan kundër Perandoris Osmane nga Rusia cariste.

Me 24 Prill të vitit 1877, do të fillon lufta Ruso-Osmane, ku ushtria Ruse kërkonte përkrahje të popujve të Ballkanit por për Shqiptarët ishte një çështje e ndërlikuar dhe e vështir duke mos i ditur lojrat e fshehta të fuqive të mëdha.

Me disfatën e perandoris Osmane nga Rusia cariste u detyrua që me 3 mars 1878, të nënshkruaj Traktatin e Shën Stefanit ku do të krijohet Bullgaria e Madhe dhe kjo marveshje do të dëmton rënd pozitën e Shqiptarve dhe tërësin territoriale. Qëllimet e Ruis kanë qenë të dal në ujrat e ngrohtë të Mesdheut dhe të Adriatikut. Fuqit Evropiane të pakënaqur me vendimet të paqes të Shën Stefanit pët të reviduar këtë çështje do të thirrën Kongresin e Berlinit që do të mbahet më 13 qershor 1878.

Periudha tre mujore nga Shën Stefani deri të Kongresi i Berlinit Shqiptarët i gjeti të papregaditur në aspektin diplomatik fal përfaqësuesve të rilindjes kombëtare si Sami Frashëri, Abdyl Frashëri, Mehmet Ali Vrioni, Iljaz Pash Dibra e panë të arsyeshme se duhet të mbahet një kuvend i përgjithshëm shqiptar para Kongresit të Berlinit.

Veprimtarët shqiptar thirrën nga të gjitha krahinat delegat për tu tubuar me 10 qershor në Prizren ku në fillim do të marin pjesë 110 delegat të cilët do të votojnë platformën shqiptare ku më 15 qershor do tja dërgojnë Kongresit të Berlinit. Kongresi i Berlinit aspak nuk e mori përsydhë kërkesën e shqiptarëve dhe këtë lidhje e shuan me gjak si Porta e Lartë, Shtetet Ballkanike dhe Fuqit Evropiane po kjo lidhje do të ketë jehonë deri me aktin e pavarësisë së Shtetit Shqiptar më 28 Nëntor 1912.

Kriza Lindore dhe Çështja Shqiptare

Në vitet e 70 të shekullit të XIX shoqëria kapitaliste kalon në fazën më të lartë të zhvillimit të saj në imperializëm që do të thotë sundues i rendit të ri botëror. Në këtë periudhë në Evropë me bashkimin e Italisë dhe të Gjermanisë kishte përfunduar faza e bashkimit kombëtar ku do të fillonë koncepti i ri diplomatik në mes fuqive evropiane ku më vonë do të paraqiten edhe kundërtënie të mëdha për interesat koloniale.

Me daljen në skenë Perandoria Gjermane, kishte filluar të trondiste pozitën ndërkombëtare të dy perandorive koloniale, të Anglisë dhe të Francës. Disfatën që e pësoi Franca nga Gjermania (1871), i dha rast Rusisë cariste të hidhte poshtë nënet e Traktatit të Parisit (1856), që e pengonin të armatosej në Detin e Zi kundër Perandorisë Osmane.¹ Po ashtu Austro-Hungaria, pas disfatës që kishte pësuar politikën e zgjerimit të saj në Gjermani e në Itali, kishte filluar të aktivizohej në derjtim të Gadishullit Ballkanik dhe të Detit Egje.²

Gjithashtu fillimi i krizës lindore të viteve të 70 të shekullit XIX i gjente trevat shqiptare në gjendje shumë të vështirë politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe arsimore.³ edhe Perandoria Osmane, gjendej në një situatë të rëndë ekonomike, politike dhe financiare. Me anën e kapitulacioneve dhe kriza e saj financiare e detyruan Portën e Lartë çdo vit të merrte nga jashtë borxhe të reja sepse me të ardhurat e veta buxhetore nuk mundte të përballonte dot as gjysmen e shpenzimeve të veta. Në vitin 1875 të ardhurat ishin 800 milion frang arri, kurse borxhi i saj ishte 5.3 miliard frang ari.⁴

Dobësimi i vazhdueshëm dhe i pandalshëm i Perandorisë Osmane, themelet e saj po i shkatronin jo vetëm kombësitë e shtypura me kryengrytjet e tyre të vazhdueshme, jo vetëm fuqitë perndimore me grabitjet që u bënin pasurive të

¹ *Historia e popullit Shqiptar*; vëll. II. Tiranë, 2002. f.132-133

² *Po aty*. f.133

³ Gazmend Shpuza, *Kuvendime për Historinë Kombëtare*, Tiranë, 2000. f.81

⁴ Shukri Rahimi, *Vilajeti i Kosovës Më 1878-1912*, Prishtinë, f.49, *Historia e popullit Shqiptar*, vëll. II vep e cit f.133

saj, por edhe vetë qeveritarët Osman të Stambollit me verbërin e tyre politike, me shtimin e vazhdueshëm të taksave, me abuzimet e përditshme të administratës dhe me anarkinë që sundonte në të katër anët e perandorisë.⁵

Në korik të vitit 1875 do të fillon kryengritja në Bosnjë dhe Hercegovinë e mbështetur në mënyrë sekrete nga Sërbija dhe Mali i Zi, këto kryengritje do të përhapen në Ballkan kundër Perandorisë Osmane në maj të vitit 1876 në Bullgari, Serbi dhe në fund të qershorit edhe në Mal të Zi në korik. Në Rusi egzistonte nje simpati e gjërë për rebelimet ballkanike. mijëra vullnetar rusë vërshuan në kryengritjen Sërbe.

Çështja Shqiptare ishte në gjendje të vështirë me vendimet që morrën Fuqitë e mëdha në Konferencen Ndërkombtare të Londrës e cila i mbylli punimet me nënshkrimin e protokollit në mars të vitit 1877. Kjo konferencë nuk e morri fare ne shqyrtim çështjen Shqiptare.⁶

Më 24 prill në vitin 1877 do të fillon lufta ruso-osmane ku ushtritë ruse në qershor kaluan Danubin.⁷ Rusia ftoj të gjith kombësitë krishtere të Ballkanit të rrëmbenin armët krahas ushtrive Ruse për tu çliruar nga sundimi osman Shqiptarët kishin mësuar lojën sllave për tradhëtit që bënin ndaj Shqiptarëve. Lufta ruso-turke paraqiti një gjendje të ndëlikuar dhe të vështir për Shqiptarët duke mos ditur marëveshjet e fshehta në Budapest dhe Shqiptarët i priste një katastrof e madhe. Mbrojtjen e interesave kombëtare do ta mer komiteti i Janinës që u formua në maj të vitit 1877, në krye me Abdyl Frashërin njëri nga ideologët dhe diplomatët kryesor të Rilindjes Kombëtare Shqipëtare. Përfaqësues kryesor të këtij komiteti janë nga krahinat e vilajetit të Janinës si: Mehmed Ali Vrijoni, Sulejman Tahiri, Sabri Gjirokastra, Vesel Dino, Mehmed Gorshijani, Mustafa Nuri Vlora, Mislim Vasjari etj. Udhëheqësit e komitetit vendosën që në aspekt diplomatik të mbrojnë interesin kombëtar dhe mendonin se në këto rrethana duhet të krijohet një aleancë politike ushtarake me Greqinë që të hynë në Luftë kundër Perandorisë Osmane.

Bisedimet u zhvilluan në mënyrë të fshehtë në Janinë gjatë gjysmës së dytë të korikut 1877, ndërmyet Abdyl Frashërit, i cili shoqërohej nga Mehmet Ali Vrijoni dhe nga një funksionar i Ministris së Jashtme greke Epaminonda Mavromatis. Qysh në fillim të dy palët erdhën në takim me pikpamje të pajtueshme. Qëllimi i Greqisë ishte të aneksoj gjithë vilajetin e Janinës dhe në korik do të ndërpriten të gjitha bisedimet greko-shqiptare.

Çështja shqiptare dhe teritori i saj gjithmonë vihej edhe në rezikun më të madh duke i parë interesat dhe programet famëkeqe të shteteve apo monarkive

⁵ Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881*, Tiranë, 1989 vëll.II, f.109-110

⁶ *Historia e popullit Shqiptar*, vëll. II. Tiranë, 2002. f.138

⁷ Norman Rich, *Diplomacia e fuqive te mëdha 1814-1914*, Tiranë, 2006, f.221,223

ballkanike ndaj trojeve shqiptare të cilat ishin nën administratën dhe sundimin osman, ideologët e Rilindjes Kombëtar e panë të arsyeshme që të formohet një komite i përbahkët me emrin Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të drejtave të Kombsisë Shqipëtare ose ndryshe Komiteti i Stambolit i krijuar më 18 dhjetor 1877 ku kryetar u zgjodh Abdyl Frashëri ndërsa anëtar të këtij komiteti kanë qenë Pashko Vasa, Ymer Prizreni, Sami Frashëri, Zija Prishtina, Mehmed Ali Vrijoni, Ahmed Koronica, Jani Vreto etj. Anëtar të këtij komiteti kërkonin kryengritjen e armatosur kundër osmanëve dhe krijimin e shtetit Kombëtar Shqipëtar.

Ushtria Ruse në fillim të vitit 1878, në çdo front kornin fitore ndaj ushtrisë osmane, disfata e ushtrisë osmane i shqetësoj të gjitha fuqitë e mëdha e posaçërisht Britaninë e Madhe e cila dërgoj flotën luftarake në detin Marmar. Pas këtyre humbjeve në Evropë dhe Azi, Perandoria Osmane ishte e detyruar të pranojë armëpushimin me Rusët dhe të zhvilloj bisedime me ta. Kështu ndërmjet dy palëve erdhi deri te nënshkrimi i marëveshjes së Shën Stefanit më 3 mars 1878. Atë e nënshkroi Safvet Pasha sepse ajo gjithësesi përmban kushte të rënda për Perandorin Osmane ⁸

Traktati i Shën Stefanit nuk kishte shqetësuar vetëm Shqipëtarët, por me të ishin shqetësuar edhe shtetet e mëdha Evropiane Anglia dhe Austro-Hungaria, të cilat nuk dëshironin që ndikimi Rusë të shtohet në Ballkan. Kushtet e paqes të jenë tepër të rënda për perandorinë Osmane e cila parashihte 9 kërkesa dhe me këtë marëveshje Rusia cariste i shkëputte Perandorisë Osmane në Ballkan dhe në Kallkaz territore me një sipërfaqe prej 350 mijë km². Qëllimi i Ruses ishte që me krijimin e Bullgarisë së madhe të dale në ujrat e ngrohtë të Mesdheut dhe Adriatikut.

Në bazë të traktatit të Shën Stefanit tre shtetet (Bullgaria, Sërbia dhe Mali i Zi) kishin këto përfitime territoriale: Bullgaria e cila ishte pjesë e Perandorisë Osmane merrte një sipërfaqe prej 172,5 mijë km², Mali i Zi i cili më 1877 kishte një sipërfaqe prej 4,7 mijë km² e rriste deri 15,7 mijë km², kurse Sërbia nga 37.7 mijë km² arinte deri 52,7 mijë km².⁹

Paqja e Shën Stefanit jo vetëm që i përlligjete pushtimet e fqinjëve Ballkanik mbi trojet periferike Shqipëtare, por edhe u aneksonte vise të tjera. Perandoria Ruse e gjymtonte rëndë tërësinë toksore të Shqipërisë dhe e vështironte tejet luftën e Popullit Shqipëtar për krijimin e shtetit kombëtar ¹⁰.

Perandoria Ruse tokat Shqipëtare i konsideronte si toka Osmane me 12 prill të vitit 1878 Abdyl Frashëri shkruante Cari Rusë nuk do të ndalej vetëm me këtë coptim të trojeve Shqipëtare ki traktat ishte vetëm hap i parë drejtë asgjësimit të

⁸ Ali Mhamed Salabi, *Perandoria Osmane Faktorët e Ngritjes dhe Rënies së sajë*, Prishtinë 2009, f.444

⁹ Zeqirja Idriz, *Historia e Diplomacisë*, Prishtinë 2013 f.92,93

¹⁰ Shaban Braha, *Gjenocidi Sërbo-Madh dhe qëndresa Shqiptare 1844-1990*, Tiranë, 1992, f.55

plotë të Shqipërisë.¹¹ Dukej se shumica e Shqipërisë do të vihej nën dominimin e sllavëve edhe të kishës ortodokse.¹²

Shtetet e Evropës Perëndimore Britania e Madhe, Austro-Hungaria, Gjermania, të pakënaqur me vendimet e Paqes së Shën Stefanit të nënshkruajtur nga Rusia cariste dhe Perandoria Osmane do të thirrën kongresin e Berlinit që do të mbahet më 13 qershor 1878 për të rivzhdur paqen e Shën Stefanit.

Lidhja Shqipëtare e Prizrenit, 10 Qershor 1878 dhe Kongresi i Berlinit 13 Qershor 1878

Lidhja Shqipëtare e Prizrenit është njëra nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Rilindjes Kombëtare Shqipëtare, të luftës së Popullit Shqipëtarë për mbrojtjen e tërësisë territoriale të vendit edhe për çlirimin Kombëtar.¹³ Lidhja Shqipëtare e Prizrenit u krijua nga ideologot dhe veprimtarët më të shquar të Rilindjes Kombëtare të cilët kuptuan lojrat diplomatike të fuqive të mëdha të cilat për interesat e veta ruanin ekulibrin e ballancuar ndërmjet vete të cilet erdhën si rezultat i viteve të 70 të shekullit XIX të cilet kishin qëllim për dominim kolonial në botë duke shkelur dhe bërë padrejtësi mbi tërësinë territoriale të popullit Shqipëtarë të cilët ishin pjesë përbërse e Perandorisë Osmane kur ajo gjendej me një gjendje të vështirë ekonmike, politike, financiare dhe ushtarake kjo do të vije si rezultat i revidimit të paqes së Shën Stefanit dhe paknaqsive të krjuar nga fuqitë evropjane që do të thirin Kongresin e Berlinit, edhe pse për një periudhë shumë të shkurtë kohore, 3 mars 1878 dhe 13 qershor 1878, trangu i intelegjences Shqipëtare vetëdisoj popullin Shqipëtarë që brenda 3 muajve të motivon të gjitha krahinat, që 3 ditë para Kongresit të Berlinit më 10 qershor 1878 do të thirnin Kuvendin e Lidhjes Shqipëtare të Prizrenit (B.R). Me këtë akt Populli Shqipëtarë provoj jo vetëm se egzistonte tani më si një kombë i formuar dhe i bashkuar por krahas kësaj tregoj dëshirën e tij të zjartë dhe të aftë si në aspektin diplomatik dhe atë luftarak për të mbrojtur paprekshmërinë e trojeve të veta, dhe për të themeluar shtetin e vetë kombëtar.

Lidhja Shqipëtare e Prizrenit do të mbahet më 10 qershor të vitit 1878 ku do të marrin pjesë të gjithë delegatët nga trojet Shqipëtare të 4 vilajeteve të Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe të Janinës kuvendi kombëtar i Prizrenit punimet i filloi më 10 qershor 1878 por atë ditë nuk morrën pjesë të gjithë delegatët nga trojet

¹¹ Kristo Frashëri, *Vep e cit f.144,145*

¹² Edwin Jacques, *Shqipëtarët Historia e popullit Shqipëtarë nga Lashtësia deri në ditët e sotëme*, Tiranë 1995 f.286

¹³ Instituti i Historisë, *Lidhja Shqipëtare e Prizrenit në dokumentet Osmane 1878-1881*, Tiranë 1978 f.3

Shqipëtare në fillim marrën pjesë 110 figura të delegatëve Shqipëtarë të të gjitha shtresave të ndryshme ndër figurat më të shquara që merrnin pjesë në kuvendin e përgjithshëm ishin: Ali Pash Gucia, Iljaz Pash Dibra, Hasan Pash Tetova, Imer Prizreni, Abdullah Bej Dreni, Ahmed Koronica, Sulejman Vokshi, Zija Bej Prishtina, Jashar Bej Shkupi, Ali Ibra, Abdyl Frashëri dhe delegat nga Bosnja. Ku kryetar i kuvendit u zgjodh delegati më i moshuar Iljaz Pash Dibra.

Në ditën e parë të punimeve në kuvend folën të gjitha grupet politike, ku vlenë të theksohet fjalimi i Abdyl Frashërit ku tha: “*Qëllimi i kuvendit është që tu presim hovin armiqve të pashpirt, duke lidhur besën shqiptare dhe duke u betuar që ti mbrojnë me gjakë trojet që na kanë lënë gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë*” në këtë kuvend u përballën delegatët në mesë grupeve kombëtare dhe atyre që mbanin qëndrimet e qarqeve sulltaniste. Programi sulltanist i njohur me emrin Kararnamen prej 110 delegatve e votuan vetëm 49 delegat reth 44% e pjesëmarrësve këtë platformë nga 12 delegat të Shkupit e votuan 4, nga 11 delegat nga Gjakova e votuan 4, nga 11 delegat nga Dibra e votuan 7, nga 9 delegat nga Prizreni votuan 4, nga 9 delegat nga Peja e votuan 5, nga 9 delegat nga Tetova e votuan 5, nga 7 delegat nga Prishtina votuan 6, nga 6 delegat nga Mitrovica e votuan 2, nga 5 delegat nga Gjilani e votuan 2, që do të thotë delegatët që përmban frymën kombëtare dështuan ndërsa misionin kombëtar e realizuan me triumfë që Shqipëtarët të bashkohen në interes të çështjes kombëtare dhe në mbrojtje të atdheut dhe idealeve kombëtare¹⁴.

Pas themelimit të Lidhjes u formuan organet më të larta në krye të lidhjes qëndronte këshillin e përgjithshëm ndërsa kryetar u zgjodh Iljaz Pash Dibra.

Për të ushtruar funksionet ekzekutive u formua komiteti qendror i Lidhjes Shqipëtare, i përbër nga tri komisione 1. Komisioni i punëve të jashtme Abdyl Frashëri 2. Komisioni i punëve të brendshme Haxhi Shabani 3. Komisioni i të ardhurave financiare Sulejman Vokshi për të realizuar kërkesën krahu patriotik nuk kishte tjetër hap veç se të formojnë një program ose statut i ndërtuar mbi platformën e Rilindjes Kombëtare¹⁵. Kjo platformë njihet si Kanuni një peticion që do t’i dërgohet Kongresit të Berlinit dhe portës së lartë të dyjat peticionet u miratuan më 15 qershorë të vitit 1878 që do t’i tregon Kongresit të Berlinit dhe portës së lartë se shqiptarët janë të gatshëm për të mbrojtur me çdo kusht tërësinë territoriale. Platforma e Lidhjes së Prizrenit parashehë një autonomi në kuadër të Perandorisë Osmane dhe qëllimi i saj ishte për të mbrojtur fronin e përbashkët të të gjitha forcave shoqërore, për të mos i dhënë shkak të shkëputej nga lëvizja krahut të saj të moderuar përfaqësuesit e të cilët ndonëse të cilit ishin

¹⁴ Kristo Frashëri, *vep e cit*, f.190,191, 154,155, Historia e popullit Shqiptar, vëll. II. Tiranë, 2002. f.154-155

¹⁵ *Po aty*.

të interesuar në ruajtjen e tërësisë territoriale të vendit.¹⁶

Kongresi i Berlinit punimet i filloj më 13 qershor 1878 dhe i përfundojë më 13 korrik 1878, ky kongres ishte një nga mbledhjet më të mëdha diplomatike të shekullit XIX, ai ndryshonte nga kongresi i mëparshëm i Vienës sepse kësaj here, fuqitë e mëdha nuk bënë ndonjë perpjekje për të fshehur faktin se ishin ato që do ti merrnin vendimet¹⁷. Udhëheqës kryesor ishte Otofoni Bizmarku ai mbizotëroj mbledhjet dhe vendimet e kongresit të Berlinit ndaj çështjes Shqipëtare vepruan në menyrë të padrejtë sepse shteteve ballkanike si Serbia, Mali i Zi dhe Rumania u njohën si të pavarurat nga sundimi Osman.

Në krahasim me traktatin e Shën Stefanit Ruisë iu zvogëluan përfitimet politike dhe territoriale viset e Maqedonisë së bashku me krahinën Lindore të Shqipërisë mbeten nën sundimin Osman çështja Shqipëtare nuk u diskutua në kongresin me gjithë Lidhja Shqiptare e Prizrenit i qe drejtur këtij forumi me anë të memorandumeve, ndër të cilët më i njohur ishte memorandum i drejtuar kryeministrit Britanik Dizrael ky dokumet ju dergua delegatit kryesor të Britanisë për këtë arsye së pari Anglia ishte fuqi më e interesuar që të mos zevendsohet Perandoria Osmane nga një sundim më i dëmshëm dhe kjo ishte jetike për ta parandaluar për parimin e sllavëve drejt Adriatikut.

Së dyti, me që Shqipëtarët nuk mund të përfaqsonin veten në kongres, P.Osmane nuk mund të ishte zëdhënsja e tyre, ata kishin nevojë për mbështetjen e një fuqie të madhe. Kjo mbështetje mund të ishte vetëm Anglia i vetëmi vendim i Kongresit të Berlinit drejt për drejtë ndaj çështjes Shqiptare ishte protokollin nr.13, ku bëhet fjalë për privilegjet dhe lirinë e popullsisë katolike të Mirditës, kjo u realizua me nismën e Francës dhe Austro-Hungarisë.¹⁸

Në përgjithësi Kongresi i Berlinit veproj padrejtsisht ndaj Shqipëtarëve duke i nda disa territore në të mirë të shteteve Ballkanike. Lidhja Shqipëtare e Prizrenit ndaj veprimeve të kongresit të Berlinit aktivitetet e saja i filloi në fushën diplomatike, ajo i dergoj kongresit shum protesta dhe memorandume për ruajtjen e integritetit të tokave Shqipëtare, Duke u mbështetur në dokumentet Angleze, Franceze, Austro-Hungareze dhe Osmane për mes memorandumeve, Patriotët Shqipëtarë iu drejttoheshin fuqive të mëdha dhe konjunkturave politike ndërkombëtare që të jenë pro Shqipëtare duke shpresuar në Anglinë e cila ishte për krijimin e një Shqipërie të fortë që do ti kundërvihet interesave grabitqare të Ruisë cariste dhe shteteve sllave në Ballkan që përkraheshin Rusin, memorandum i parë që iu dërgua Kongresit të Berlinit ishte aij i 13 Qershorit,

¹⁶ Kristaq Prifti, *Koncepti i Lidhjes së Prizrenit për shtetin kombëtar shqiptar*, Prishtinë 2008, f. 28.

¹⁷ Norman Rich, vep e cit, f.226 ; Zeqirja idrizi, vep e cit, f.94

¹⁸ Zeqirja Idrizi, vep e cit, f.100-101

ky memorandum u përpilua nga një grup patriotësh Shkodranë.

Memorandumi iu dërgua Kryeministrit Anglezë Lordit Bikonsfill, përfaqësuesi Anglisë në kongresin e Berlinit, ku kërkohej që qështja Shqiptare të shqyrtohet pasi që kombësitë tjera, në Perandorinë Osmane kanë një qeveri dhe një Diplomaci që iu shpreh dëshira vetëm Shqiptarët nuk kanë asnjëfar përfaqësues.¹⁹

Fuqitë e mëdha të Evropës janë mbledhur për të zgjedh çështjet e ligjëshme në përbërje të çështjes së Evropës Juglindore, sigurisht nuk do të jetë i huaj zëri i shqipëtarëve midis shumë të tjerëve, që kërkojnë drejtësi duke tërhequr vëmendjen e përfaqësuesve fuqplotë. Në këto kushte lidhja mori në duar të veta fatin e kombit duke deklaruar në arenën ndërkombëtare se kërkush nuk kishte të drejtë të vinte dorë mbi tokat e banuara prej shqipëtarëve e t'i bënte ato monedhë këmbimi dhe se Zoti i vetëm i tyre ishte populli shqiptarë.²⁰

Problemi i njohjes së kombit shqiptarë, i tërësisë së tij territoriale dhe i luftës për mbrojtjen e saj zë një vend të rëndësishëm në mendimin politikë dhe në gjithë veprimtarinë e lidhjes dhe përfaqësuesit të Rilindjes Kombëtare Shqipëtare. Fati i shqipëtarëve gjithnjë e më tepër po vështirsohej në këto rrethana udhëheqësit e Lidhjes u treguan të zdhërvjellët dhe u përpoqën të manovronin, Abdyl Frashëri në memorandumun që i dërgojë Sulltanit, më 13 tetor të vitit 1880, ku u duk qartë se porta e lartë nuk do të miratonte kërkesat autonomiste të Lidhjes. Në këtë kohë "Flota e gjashtë Fuqitë e Mëdha bllokuan Ulqinin", për t'ia dorëzuar atë pas 1 muaji Malit të Zi, kur Shqipëria kërcënohej nga rreziku i një coptimi të plotë.

Lojrat diplomatike të Kongresit të Berlinit mbi fatin e shqipëtarëve si pjesë e Perandorisë Osmane Shtetet Ballkanike Serbia, Mali i Zi dhe Greqia sipas vendimeve që kishte caktuar Kongresi i Berlinit dhe Fuqit tjera Evropiane trojet shqiptare do të ndahen në të mirë të fqinjëve ballkanik dhe pjesa tjetër do t'i takon Perandorisë Osmane. Kryengritësit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit i dëshmuan Kongresit të Berlinit, Perandorisë Osmane se gabimisht kanë vepruar ndaj trojeve dhe çështjes shqipëare edhe pse Lidhja do të shuhej me gjakë nga porta e lartë nga Shtetet Ballkanike dhe Fuqitë Evropiane ajo do të ketë jehonën e vetë në ngritjen e vetëdisimit të kombit shqipëtar dhe përpjekja e Lidhjes së Prizrenit kishte në epiqendër themelimin e një shteti të bashkuar kombëtar.

Vepra e kësaj Lidhje edhe sot e kësaj dite kërkon përgjegjësi, nderë dhe punë për të bërë realitet platformën politike të ideologëve të saj për bashkimin e kombit shqipëtar edhe sot e kësaj dite.

¹⁹ Qamil Gexha, *Marrëdhëniet Shqiptar-Malazeze 1839-1912*, Gjakovë, 2003, f.72-73 ; Gazmend Shpuza, *vep e cit*, f.87.

²⁰ Stefanaq Pollo, *Lidhja shqiptare e Prizrenit dhe lufta e saj për çlirim dhe bashkim Kombëtar*, Tiranë 1990, fq. 158.

Përfundim

Ngjarja më e rëndësishme e historisë tonë kombëtare është Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe platforma e saj politike që 140 vite frymon dhe jep fryt në ruajtjen e tërësis territoriale, kombëtare që bashkon të gjithë shqiptarët me një ideologji të përbashkët andaj ne edhe sot e kësaj dite duhet punuar me të gjitha metodat për të bërë realitet platformën politike të rilindasve tanë kombëtar dhe për ti bashkuar të gjitha trojet Shqiptare në një shtet.

Conclusion

The most important national happening of Albanians was the The Albanian League of Prizren and his political platform that 140 years was leading and saved its territorial, national aim that reunions all Albanians in one ideology, taking in consideration the past, now we have to work with all the methods in order to make real the political platform and to be together all Albanians in one country.

Bibliografia

- Historia e popullit Shqiptar, vëll. II. Tiranë, 2002.
- Gazmend Shpuza, Kuvendime për Historinë Kombëtare, Tiranë, 2000.
- Shukri Rahimi, Vilajeti i Kosovës Më 1878-1912, Prishtinë.
- Norman Rich, Diplomacia e fuqive të mëdha 1814-1914, Tiranë, 2006.
- Ali Mhamed Salabi, Perandoria Osmane Faktorët e Ngritjes dhe Rënies së sajë, Prishtinë 2009.
- Zeqirja Idriz, Historia e Diplomacisë, Prishtinë 2013.
- Shaban Braha, Gjenocidi Sërbo-Madh dhe qëndresa Shqiptare 1844-1990, Tiranë, 1992.
- Edwin Jacques, Shqipëtarët Historia e popullit Shqipëtarë nga Lashtësia deri në ditët e sotme, Tiranë 1995.
- Instituti i Historisë, Lidhja Shqipëtare e Prizrenit në dokumentet Osmane 1878-1881, Tiranë 1978.
- Kristo Frashëri, Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881, Tiranë, 1989 vëll. II.
- Kristaq Prifti, Koncepti i Lidhjes së Prizrenit për shtetin kombëtar shqiptar, Prishtinë 2008.
- Qamil Gexha, Marrëdhëniet Shqiptar-Malazeze 1839-1912, Gjakovë, 2003.
- Stefanaq Pollo, Lidhja shqiptare e Prizrenit dhe lufta e saj për çlirim dhe bashkim Kombëtar, Tiranë 1990.

Prof.as.dr. Lavdosh AHMETAJ

RADIKALITETI POLITIK I LIDHJES SË PRIZËRENIT NXIT INSTIKTIN USHTARAK TË PORTËS SË LARTË

Abstrakt

Nëmarrëdhëniet e Perandorisë Otomane me popujt dhe kombësitë e përfshira brenda saj, si dhe me fuqitëeuropiane, lufta Ruso-Turke e vitit 1877 dhe kongresi i Berlinit i vitit 1878 përbejnë një pikëkulminante, nëmarrëdhënjetë reja gjeopolitike. Në këtë kontekst lëvizja politike e Prizërenitpërmban nëvetëvete dhe në raport me Portën eLartë disa momente të rëndësishme të lidhura dhe të harmonizuara me njëra tjetrën:

së pari,nga njëra anë studimi shpreh përpjekjet dhe qëndrimet e moderuara politike, për krijimin e një vilajeti shqiptar, i cili duhej të ishte nën sovranitetin e shtetit osman me shqetësimin e ruajtjes sëstatusquosë, për shkak se shqiptarët konsideroheshin ende të papërgatitur, për të formuar shtetin e tyre të pavarur

së dyti, ndërsa, nga ana tjetër shprehen prirjet radikale, në drejtim të përgatitjes së shkëputjes së Shqipërisë, nga sovraniteti i shtetit osman, dhe të hedhjes së themeleve të organizimit të ri shtetëror. Kjo përbënte njëherash shqetësimin edhe të Portës së Lartë, e cila i konsideronte shqiptarët të pa përgatitur, për ekzistuar të pavarur politikisht, për më tepër monarkitë fqinje do të përfitonin nga kjo situatë dhe do të ndërhyenin nëcështjen shqiptare

së treti, vet lëvizja politike dhe ushtarake e Prizëresnit me ngizjen e sajradikaliste e kishte vënë në pozita të vështira politikën e Portës së Lartë në Ballkan. Në këto kushte shteti osman, duke u nisur nga interesat e tij gjeopolitike, nuk kishte rrugë tjetër veçse, të vepronte ushtarakisht, për shtypjen e Lidhjes sëPrizërenit.

Studimi, nuk mund të anashkalonte kontributin e lëvizjes shqiptare, në funksion tëharminizimit të ideve dhe qëndrimeve të rrymave politike, të cilat edhe pse kishin koncepte të ndryshme, për zgjidhjen e krizës aritën të afroheshin me njëra tjetrën. Vështruar në këtë rrafsh evidencohen jovetëm idetë e tyre, por

edhe hulumtohet raporti i rrymave politike radikaliste me atë tëmoderuar, për një Shqipërie autonome dhe të pavarur apo nën sovranitetin e Portës së Lartë.

Fjalë kyçe: autonomi administrative, shtet, administrat, politikë, territor, radikalizëm, ekujlibër, status-quo, rryma politike.

Duke u nisur nga shumë burime historike, të cilat vërtetojnë formimin elidhjes shqiptare tëPrizërenit, nismënpër thirrjen e Kuvendit të Përgjithshëm e mori Komiteti i Stambollit, i cili ishte më i infomuar, në lidhje me situatën politike tëPortës, por edhe i shikonte ngjarjet e gjeopolitikës, në funksion të ekzistencës jo vetëm shqiptare si subjekt politik, por edhe të vet interesave politike të shtetit osman, i cili ishte nën efektin e fuqishëm të krizës sëbrendëshme të strukturave institucionale. Në këto kushte krize epiqendra e lëvizjes politike shqiptare dukej se ishte përcaktuarPrizreni, qyteti kryesor i Kosovës dhe një nga më të mëdhenjtë e Shqipërisë, që ndodhej në afërsi të krahinave të tjera shqiptare. Nga të dhënat burimore bëhen të njohur rreth 110 emra, shumica e të cilëve vinin nga trevat e Kosovës. Këto personalitete ishin përfaqësues të shtresave të ndryshme shoqërore, çifligarë e agallarë, tregtarë e zejtarë, klerikë, bajraktarë, të cilët po hynin në jetën politike të shqiptare si figura që kishin marrë pjesë në lëvizjen politike shqiptare dhe që kishin luftuar kundër politikës ekspansioniste të monarkive fqinje¹.

Ajo që është e rëndësishme, nga pikpamja politike, është e lidhur me faktin që Lidha ePrizërenitarriti të prodhonteorganet e saj të larta², të cilat përbëninnjë haptë konsiderueshëm me prirje të dukshme radikale, pasi me anën e këtyre institucioneve konceptohej krijimi i premisave të qarta, për formimin e njëadministrate e cila do të funksiononte, nëshërbim të shtetit shqiptar.³

Ndërsa, krahas me krijimin e institucioneve politike Kuvendi hodhi një hap tjetër politik, duke miratuar tekstin e një proteste, drejtuar Kongresit të Berlinit,

¹ - Ali bej Gucia, Iljaz pashë Dibra, Hasan pashë Tetova, Ymer Prizreni (kryetar i komisionit organizator të Kuvendit), Abdullah pashë Dreni, AhmetKoronica, Shaban bej Prizreni, Zija bej Prishtina, Jashar bej Shkupi, Shaban bej Peja, FilipDoda, SulejmanVokshi, Shuajip Spahiu, AliIbra(Neza).

² -Në krye të Lidhjes qëndronte Këshilli i Përgjithshëm me funksione legjislative dhe me seli në Prizren, nga i cili do të vareshin degët krahinore. Kryetar i tij u zgjodh Iljaz pashë Dibra. Për të ushtruar funksionet ekzekutive u formua Komiteti Qendror i Lidhjes Shqiptare, i përbërë nga tri komisione, secili me një përgjegjës të veçantë: komisioni i punëve të jashtme (AbdylFrashëri), komisioni i punëve të brendshme Haxhi Shabani dhe komisioni i të ardhurave financiare (SulejmanVokshi).

³ - SulejmanVoksh, ose që u takonin qarqeve të moderuara (Iljaz pashë Dibra e Haxhi Shaban Prizreni). Për fitoren e plotë të krahut patriotik nuk mbetej tjetër hap, veçse pajisja e besëlidhjes me një statut ose kanun, siç quhej në atë kohë, të ndërtuar mbi platformën rilindëse.

me anën e së cilës ngrihej zëri kundër shkëputjes së krahinave shqiptare në favor të shteteve fqinje⁴. Nëkohën kjo ngjarje u shoqëruan me prirje radikaliste, për të kundërshtuar mepërdormine armëvevendimet e Kongresin të Berlinit,⁵ të cilatcënonin tërësinë e trevave shqiptare. Radikalizmi politik ishte përfaqësuar në përgjithësi nga Komiteti Kombëtar i Stambollit, i cili mbronte pikpamjen se lidhja shqiptare, duhej të organizonte shqiptarët në emër të së drejtave kombëtare të Shqipërisë dhe t'i drejtonte ata në luftë për ruajtjen e tërësisë tokësore, duke kërkuar në të njëjtën kohë krijimin e një vilajeti autonom shqiptar ose, po ta lejonin rrethanat ndërkombëtare, të një shteti shqiptar autonom⁶. Dhe për të arritur ruajtjen e tërësisë territoriale shqiptare, duhejqëshqiptarët, të organizoheshin ushtarakisht për të luftuar⁷, në përshtatje me rrethanat që do të krijoheshin, jo vetëm kundër shteteve shoviniste fqinje, por, pse jo edhe kundër vet sovranit, Perandorisë Osmane⁸.

Përfaqësuesitradikalist, të cilët njiheshin si grupimit politik kombëtar, iu desh tëpërballeshin me qëndrimet e të klaneve politike sulltaniste e shoqëruar me trysinë e autoriteve zyrtare osmane, të përfaqësuar nga mytesarifi turk i Prizrenit, Qamil Beu, që ishte njëzë i fuqishëmnbrendësitë Lidhjes. Megjithatë, Kuvendi i Prizrenit formuloi një nga aktet e para, i cili kishtetëbënte me krijimin e një organizate me karakter politik e ushtarak, të një Lidhjeje (Itifaku)⁹, me njëqëndër të vetme drejtuese dhe me degë të saj nëpërkrahinat shqiptare, e cila merrte iniciativën politike që të mbronte me çdo mjet interesat kombëtare¹⁰.

Ndërsa një rrymë e dytë në lëvizje, e cila kishte nuanca kombëtar ishte ajo e të moderuarve, e cila përfaqësohej nga personalitete të njohura shqiptare.¹¹ Ata, arsyetonin se, vilajeti shqiptar mund të krijohet vetëm përmes vullnetit politik të Portës së Lartë, pasi, sipas tyre, ndërtimi i këtij vilajeti ishte në interesin politik të vet Perandorisë Osmane, për të ruajtur statusquonë në Ballkan. Nga ana tjetër

⁴ - HHStA, PA, Konsullata e Shkodrës XXXVII/186, memorandum italisht bashkangjitur raportit të që konsulli I Austro-Hungarisë në Shkodër Lipih, I dërgon më 20 korrik 1878 Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, nr. 66 (Shiko, Aktet të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, Tiranë 1978, f. 17-22)

⁵ - Shiko, vep, cit. Akte të Rilindjes Kombëtare..., Tiranë 1978, f. 43 "Urdhëresë e Lidhjes Shqiptare për organizimin e administratës dhe të ushtrisë së saj të vecantë"

⁶ - Po aty, f. 44 "Neniinjëmbëdhjetë"

⁷ - AMPJ LP Ambasada e Francës pranë Portës Osmane, vëllimi 420, fl. 83-88 (Shiko, vep. Cit. Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I, Tiranë 1978, f. 193)

⁸ - Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit II, Tiranë 1986, f. 439

⁹ - Shiko, vep, cit. Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri, Tiranë 2007

¹⁰ - Shiko, vep. Cit. Akte të Rilindjes Kombëtare shqiptare 1878-1912, Tiranë 1978, f. 62-64

¹¹ - Ali bej Guçia, Iljaz pashë Dibra, Abedin pashë Dinoja, Mahmud pashë Biçaku, Omer pashë Vrioni, Col Deli Qerimaj

të moderuarit, duke u nisur ngainteressant eshteteve fqinje, prireshin ta kufizonin lëvizjen vetëm me mbrojtjen e territoreve të kërcënuara, vetëm me luftën kundër copëtimit të vendit¹². Si rrjedhim, ata e konceptonin lidhjen shqiptare jo si një organizëm i veshur me attribute shtetërore, por si njëaleancë krahinash të krijuar vetëm për të luftuar bashkërisht kundër interesave teritoriale tështeteve fqinjë¹³.

Megjithatë, ndërmjet pikpamjeve së lëvizjes radikale dhe të moderuarve kishte disa pika takimi, siç qe ajo e karakterit kombëtar shqiptar të lidhjes së përgjithshme dhe pranimi në parim i formimit të një vilajeti autonom shqiptar¹⁴. Në situatën e krijuar në pranverën e vitit 1878, këto ide të përbashkëta merrnin rëndësi të dorës së parë përballë pikëpamjeve të ndryshme që kishin ato për kohën e mënyrën se kur dhe si duhej tëkonstruktohej ky vilajet, të cilat mund të zgjidheshin pasi lëvizjashqiptare të merrte karakter edhe mëtëmatuar¹⁵.

Por si radikalët, edhe të moderuarit kërkonin që lidhja të kishte karakter kombëtar. Ata e pranonin në parim edhe idenë e një vilajeti të bashkuar autonom shqiptar, të pajisur me një autonomi administrative e kulturore. Por, ndryshe nga elementët radikalë të Komitetit të Stambollit, këta nuk e shikonin vilajetin e bashkuar shqiptar si një hallkë, si një shkallë për të shkuar më tej drejt një shteti të bashkuar e të pavarur shqiptar¹⁶.

Në këtokushteerrethana, u arrit bashkëpunimi i të dy rrymave politike për formimin e një lidhjeje shqiptare me karakter kombëtar, që do të udhëhiqte luftën e popullit shqiptar kundër copëtimit territorial të atdheut dhe do të parashtronte nevojën e bashkimit administrativ të mbarë viseve shqiptare në një vilajet autonom shqiptar¹⁷.

Ndërsa, duhet theksuar se jashtë këtyre dy grupimeve politike, në jetën politike Shqiptare vepronte edhe një grupim i tretë me shije politikësulltaniste¹⁸.

¹² - Shiko, vep. Cit. *Akte të Rilindjes Kombëtare shqiptare 1878-1912*, Tiranë 1978, f. 75-79

¹³ - Shiko, vep, cit. *Akte të Rilindjes*, Tiranë 1978, f. 75 "Shtonjë e informacionit të ambasadorit austro-hungarez në Stamboll datë 11 shkurt 1879, nr. 15"

¹⁴ - *Akademia e Shkencave e R.SH, Shqipëria ne vitet e LidhjesëPrizërenit*, Tiranë 1978, f. 249

¹⁵ - Shiko, vep. Cit. *Akte të Rilindjes Kombëtare*, Tiranë 1978, f. 62-63 "Programi i Lidhjes Shqiptare botuar të gazetën *Terxhuman Shark*"

¹⁶ - Shiko, vep, cit. *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare tëPrizërenit II*, Tiranë 1986, f. 441

¹⁷ - *Po aty*, f. 238-241

¹⁸ - *Ata udhëhiqeshin nga nëpunësit e administratës së vilajeteve, nga elementë feudalë e klerikë turkomanë, të cilët e identifikonin veten me qarqet sunduese perandorake, anonin plotësisht nga vija politike e Portës së Lartë dhe i shërbenin asaj. Të interesuar për të kundërshtuar vendimet e Traktatit të Shën-Stefanit, edhe pasuesit e këtij grupimi u bashkuan me lëvizjen për organizimin e qëndresës së armatosur nëpërmjet "lidhjes" së përgjithshme, e cila duhej të vepronte sipas orientimeve të sulltanit. (Shiko. *Lidhja Shqiptare e Prizërenit nëdokumenta osmane 1878-1881*, Tiranë 1978)*

Ata ishin për një lidhje islamike, ku të merrnin pjesë të gjitha popullsitë myslimane përtej trevës shqiptare madje, duke përfshirë Ballkanin islamik, pavarësisht nga kombësia e tyre, nga e cila, logjikisht, do të përjashtoheshin shqiptarët e krishterë, si ortodoksë, edhe katolikë. Kjo rryme politike, nuk e pranonte as idenë e një vilajeti shqiptar, sepse ky vilajet, sipas tyre, do t'i ndante shqiptarët myslimanë nga "vëllezërit" myslimanë të Gadishullit Ballkanik dhe të Perandorisë Osmane¹⁹. Sulltanistët u kundërshtuan nga radikalë dhe të moderuar, për karakterin e lidhjes islamike, e cila sipas tyre, në kushtet që ajo mundet të krijohej, do ta rrezikonte seriozisht ekzistencën politike të Shqipërisë.

Por, nëkëtë lëvizje sa politike po aq edhe diplomatike arriti të merrte pjesë edhe figura e shquar Pashko Vasa, i cili i paraqiti ambasadorit britanik në Stamboll një memorandum, në të cilën lufta kundër copëtimit territorial të Shqipërisë lidhej organikisht me kërkesën për autonominë e saj administrative. Shqiptarët, thekson Vaso Pasha janë bindur t'i shkëputin të gjitha lidhjet që i bashkojnë me Turqinë dhe nuk duhet të përjashtohen nga ajo e drejtë që kanë popujt sllavë të Ballkanit për të formuar shtete të pavarura ose autonome²⁰. Ai së bashku me Zef Jubanin arriten të studiojnë konceptin e kombit si bashkësi historike, shpirtërore dhe gjuhësore, duke vënë theksin në aspektin territorial dhe përmbajtjen ekonomike dhe rrjedhimet shoqërore që duhej të kishte krijimi i një formacioni shtetëror shqiptar²¹.

Kjo pikpamje mbi nocionin e kombit u shoqërua, nga Abdyl Frashëri nëpërmjet një seri artikujsh të botuar në organin austriak "Messenger de Vienne" "Mesazherdë Vjenë", i shpjegonte opinionit evropian të drejtat politike që i takonin popullit shqiptar. Kombi shqiptar, nënvizon ai, nuk aspiron asgjë tjetër, veçse të jetojë i lirë, të dalë nga prapambetja dhe të zërë vendin që meriton në radhët e kombeve të qytetëruara të Evropës. Në rast se shqiptarëve do t'u njiheshin të drejtat e tyre kombëtare, Shqipëria do të bëhet faktor i paqes dhe do të kthehet në një digë kundër ekspansionit të Perandorisë ruse²².

Tensioni i madh politik²³ u reflektua edhe në opinionin publik shqiptar krijoi një situatë të favorshme për rritjen e autoritetit të Lidhjes dhe për shtrirjen e saj organizative, brenda pak javëve, në të katër anët e vendit delegatët që kishin

¹⁹ - Shiko, vep. Cit. Arben Puto, *Lidhja Shqiptare në mbrojtjen e të drejtave të kombit të viteteve të krizës lindore, Tiranë 1979*. 89-107 (*Lidhja shqiptare e Prizërenit, Tiranë 1979 (botim në ndihmë të shkollës)*)

²⁰ - Shiko, vep, cit. *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1978-192, Tiranë 1978*

²¹ - Aleks Buda, *Lidhja shqiptare e Prizërenit dhe rrënjët e saj historike, Tiranë 1979, f. 51-65*

²² - *Lidhja shqiptare e Prizërenit, Tiranë 1979, f. 147 "Letërkëmbime"*

²³ - *Aktet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1978-1912, Tiranë 1978 "Memorandum I Komitetit të Stambollit" "Vendim I Lidhjes Shqiptare të Toskërisë" Stambol, 31 tetor 1878*

marrë pjesë në Kuvendin e Prizrenit, besëlidhjet lokale ose komisionet e vetëmbrojtjes, që ishin krijuar më parë, u kthyen menjëherë në degë të Lidhjes Shqiptare.²⁴ Ndërsa në këto kushte, në fund të korrikut 1878 u organizua në Janinë një Kuvend i gjerë Ndërkrahinor me përfaqësues të të gjitha degëve të vilajetit. Ky kuvend e radilazoi edhe më shumë situatën, duke shprehur publikisht vendimin e shqiptarëve për të kundërshtuar me armëçdo lëshim të trojeve të tyre në favor të monarkisë greke, Kuvendi Ndërkrahinor caktoi për çdo kaza numrin e forcave vullnetare, që do të mobilizoheshin për të hyrë në luftë menjëherë sapo të ishte e nevojshme²⁵. Në të njëjtën kohë përfaqësuesit e degëve të Jugut miratuan një memorandum, me të cilin paralajmërohej Porta e Lartë se shqiptarët ishin të vendosur të viheshin edhe kundër saj²⁶, në rast se ajo do të tërhiqej përballë pretendimeve shoviniste të Athinës.

Radikalizmi si frymë, por edhe si veprim politik, i cili reflektohej në vendimmarrjen e organeve politike të Lidhjes u shprehu, në mbledhjen e 24 korrik 1878,²⁷ Kuvendi Ndërkrahinor i Janinës, krahas vendimeve që mori për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Shqipërisë, shqyrtoi edhe çështjen e formimit të vilajetit autonom shqiptar. Për këtë qëllim, më 24 korrik 1878, u hartua një rezolutë e veçantë, në të cilën aspirata e shqiptarëve për autonomi u formuluar nëpërmjet tri kërkesave²⁸: së pari, bashkimi i trojeve të tyre në një vilajet të vetëm; së dyti, zhvillimi i gjuhës shqipe si gjuhë kombëtare; së treti, zbatimi menjëherë në Shqipëri i reformave të përshtatshme me nevojat e saj, sikurse ishte krijuar i “milicisë shqiptare” me forca të rekrutuara nga e gjithë Shqipëria. Lidhja parashikonte që vetëm në vilajetin e Janinës të mblidhte 30 mijë burra të armatosur.

Ndërkaq, në dhjetëditëshin e tretë të korrikut u acaruan marrëdhëniet e Portës së Lartë me shqiptarët²⁹, për shkak të qëndrimit të këtyre të fundit ndaj pushtimit të Bosnjës e të Hercegovinës nga Austro-Hungaria. Kur më 22 korrik ushtritë austro-hungareze filluan marshimin drejt Bosnjës dhe Hercegovinës, autoritetet

²⁴ - Duke marrë parasysh vështirësitë e ndërlidhjes së degëve të shumta me Komitetin Kombëtar dhe për ta rritur operativitetin e këtyre degëve në përshtatje me rrethanat lokale, në fillim të korrikut u formuan në bazë vilajetesh tri komitete ndërkrahinore të Lidhjes Shqiptare me qendër në Prizren, në Shkodër dhe në Janinë. Lidhjet ndërmjet Komitetit të Janinës dhe komiteteve të Prizrenit ose të Shkodrës kryheshin sipas rastit, nëpërmjet degës së Elbasanit ose nëpërmjet degës së krijuar posaçërisht për këtë qëllim në Selanik, e cila shërbente si ndërmjetëse për lidhjet e komiteteve ndërkrahinore të vilajeteve me Komitetin e Stambollit. (Shiko, vep. Cit. Akte të Rilindjes Kombëtare..., Tiranë 1979)

²⁵ - ASH RSH, Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizërenit I, Tiranë 1978, f. 181

²⁶ - Shiko, vep. Cit. Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizërenit II, Tiranë 1978, f. 110

²⁷ - Po aty

²⁸ - Shiko, vep. cit. Shqipëria në vitet e Lidhjes së Prizërenit I, Tiranë 1978, f. 238-241

²⁹ - Po aty

shtetërore osmane u kërkuan krerëve të Lidhjes Shqiptare që t'u vinin në ndihmë me forcat e tyre të armatosura boshnjakëve, që kishin rrëmbyer armët kundër pushtuesve të huaj. Kërkesën e Stambollit e miratuan vetëm qarqet sulltaniste, të cilat u përpoqën të bindnin Këshillin e Përgjithshëm të Lidhjes për të marrë pjesë në luftën kundër Austro-Hungarisë, ndërsa anëtarët e tij nuk pranuan, duke përdorur si argument nevojën e ngutshme për mbrojtjen e trojeve shqiptare³⁰.

Lidhja vendosi të mos dërgonte forcat e saj të armatosura kundër austro-hungarisë në Bosnjë, me arsyen e thjeshtë se ato ishin krijuar për të mbrojtur interesat shqiptare e jo të Perandorisë Osmane. Njëkësituate kritike Porta e Lartëfilloj të shqetësohej, për tre arsye kryesore; së pari, rruga e veprimeve të pavarura në të cilët tashmë kishte hyrë Lidhja Shqiptare; së dyti, trysnia e madhe diplomatike që ishin duke ushtruar Fuqitë e Mëdha në lidhje me zbatimin e Traktatit të Berlinit kundrejt Malit të Zi e Greke³¹; së treti, Trysni diplomatike të fuqishme ushtronte edhe Rusia, e cila po e kushtëzonte tërheqjen e ushtrive të veta nga Rumelia Lindore me dorëzimin nga ana e Perandorisë Osmane të tokave që i qenë premtuar Malit të Zi³².

Nën presionin evazhdueshëm të Fuqivëe të Mëdha, Porta e Lartë ndërmoi disa hapa: së pari, nëpërmjet Mehmet Ali pashës, i cili erdhi në Prizren më 25 gusht 1878 u përpoq të sqaronte lidërshtipin e saj për dëmin e konsiderueshëm që po sillnin shqiptarëve, ndaj vendimeve të Berlinit pasi, sipas tij, jo vetëm Porta e Lartë, por as Fuqitë e Mëdha nuk do të tërhiqeshin; ato do ta zbatonin me çdo kusht Traktatin e Berlinit³³; së dyti, në mbledhjen e 26 gusht, ai përdori kërcënimin, duke u lënë një afat prej 24 orësh për t'u menduar, të nesërmen askush nuk u paraqit në mbledhje. Për më tepër, atë ditë u vra nga anëtarët e Lidhjes në mënyrë publike, në kafenenë "Marash" të Prizrenit, telegrafisti i Mehmet Ali pashës, të cilin mareshali e kishte sjellë me vete për të ruajtjen e raporteve që do t'i drejtonte Portës së Lartë. Vrasja e telegrafistit shprehte qëndrimin radikalist që Lidhja e Prizrenit i drejtonte Maxhar Pashës dhe nëpërmjet tij qeverisë osmane, për të hequr dorë nga zbatimi praktik i vendimeve të Kongresit të Berlinit³⁴.

Më 3 shtator, pasi mbaroi afati i ultimatumit, natyrshëm pritej represioni ushtarak i Portës³⁵. Luftimet e Gjakovës patën impakt të fuqishëm publik në tri

³⁰ - *Po aty*

³¹ - *Shiko, vep.cit. Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizërenit II, Tiranë 1987, f. 248 - 254*

³² - *Po aty, f. 75 - 79*

³³ - *Shiko, vep. cit. Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizërenit I, Tiranë 1978, f. 197 "Krajevski, konsull i Francës në Selanik"*

³⁴ - *Vep, cit. Shqipëria në vitet e Lidhjes së Prizërenit I, Tiranë 1978, f. 196-197*

³⁵ - *Më 5 shtator gjendja e të rrethuarve u keqësua, pasi shumica e ushtarëve që mbronin sarajet u dorëzuan. Batalioni që u nis nga Mitrovica për t'i ardhur në ndihmë Maxhar Pashës u shtur*

drejtime: sëpari, si një akt që cenonte Traktatin e Berlinit në lidhje me detyrimet territoriale të Perandorisë Osmane ndaj Malit të Zi; së dyti, si një aksion që kishte ligështuarnëmënyrëtë pa rikuperueshme marrëdhëniet e Portës së Lartë me shqiptarët; së treti, si një veprim qëradilizonte edhe më shumë situatën dhe vështirësonte më keq zgjidhjen e problemeve të krijuara nga Kriza Lindore në Gadishullin Ballkanik³⁶.

Në këtë kontekst sa politik po aq edhe ushtarak forcat politike shqiptare e përqendruan vëmendjen në dy çështje kryesore: në atë të pretendimeve greke ndaj Çamërisë dhe në problemin e të drejtave autonomiste të Shqipërisë; së treti, ndërsa forcat radikale kërkonin që Protokollin nr.13 të korrigohej në mënyrë të tillë që Greqia të kënaqej jo me vise shqiptare, por me troje greke në Thesali³⁷.

Ndërsaështpër tu theksuar se, krahu i moderuar i Lidhjes Shqiptare hoqi dorë nga lufta për autonominë e Shqipërisë, atdhetarët radikalë e vazhduan atë më me forcë pas ngjarjeve të Ulqinit. Në një mbledhje të veçantë të Komitetit të Lidhjes që u mbajt në Ulqin në 24 tetor 1880, u vendos që të protestohet kundër vendimit të qeverisë osmane për të dorëzuar me dhunë Ulqinin dhe Malin e Zi. Kjo situatë u shoqërua edhe në 16 nëntor 1880,³⁸ ku Komiteti i Lidhjes së Ulqinit i drejtohet konsujve të Fuqive të Mëdha në Shkodër, kundër masave ushtarake të Dervish Pashës për t'u dorëzuar me dhunë Ulqinin malazezëve.

Ndërsa qysh në javën e parë të muajit dhjetor 1880 Porta e Lartë filloi të kalonte shkallë-shkallë në sulm kundër lëvizjes autonomiste shqiptare. Goditjen e parë ua dha forcave atdhetare në Shkodër. Menjëherë pasi përfundoi dorëzimin e Ulqinit, Dervish Pasha me egërsinë e tij, të jashtëzakonshme kundër të Lidhjes së Prizrenit në vilajetin e Shkodrës, të cilat arriti t'i shpërndante përmesforcës ushtarake, duke rivendosur pushtetin e Portës së Lartë

Mareshali turk u tregua më i egër me partizanët e lëvizjes autonomiste, sesa me pjesëmarrësit e luftës së Ulqinit. Më 11 dhjetor ai arrestoi pabesisht dhe internoi në Anadoll edhe figura të tilla si Hodo Sokolin e Preng BibëDodën, të cilët nuk morën pjesë në luftën e Ulqinit, por ishin përkrahës të kërkesave

rrugës dhe shumica e ushtarëve të tij, duke qenë shqiptarë, u bashkuan me kryengritësit. Më 6 shtator 1878, pas një sulmi të rreptë që ndërmorën luftëtarët e Lidhjes Shqiptare, edhe mbeturinat e kompanive turke që mbronin mareshalin osman u dorëzuan. Pastaj kryengritësit arritën t'u vënë zjarr sarajeve. MehmetAli pasha dhe Abdullah pashë Dreni mbetën të vvarë gjatë sulmit të fundit. Col Deli Qerimaj me synimin për të ndaluar gjakderdhje të metejshme, me një veprim vetëmohuesdepertoi në brendesi të sarajeve, ku edhe ra heroikisht pasi arriti të vriste Pashain turk. Me vrasjen e tyre luftimet morën fund me fitoren e forcave të Lidhjes Shqiptare (Shiko, vep. Cit. Akademia e Shkencave, Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit II, Tiranë 1986)

³⁶ - Shiko, vep. cit. Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, Tiranë 1978, f. 114

³⁷ - Shiko, vep. Cit. Shqipëria në vitet e Lidhjes së Prizrenit II, Tiranë 1978

³⁸ - Shiko, vep. Cit. Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, Tiranë 1978, f. 118

autonomiste, ndërsa DautBoriçin e izoloi në Stamboll. Arrestime të tjera ndërmori ai në qytetin e Shkodrës.

Disa ditë më vonë Porta e Lartë e thirri në Stamboll Dervish Pashën dhe i ngarkoi detyrën të hartonte planin e një ekspedite të madhe ushtarake kundër Shqipërisë, për të shtypur në mbarë vendin Lidhjen Shqiptare dhe prirjen e saj për kryengritje të armatosur kundërosmane. Në relacionin që i paraqiti sulltanit më 27dhjetor, Dervish Pasha kërkonte që lëvizja autonomiste shqiptare të shtypej para se të shpërthente një kryengritje e përgjithshme e armatosur dhe për këtë qëllim të dërgoheshin në Shqipëri 40 batalione ushtarësh me dy qendra drejtuese, njëra në Shkodër, tjetra në Shkup, që ekspedita ushtarake të fillonte në Veri dhe pas zgjidhjes së çështjes së Çamërisë të shtrihej edhe në Shqipërinë e Jugut. Në të njëjtën kohë sulltan AbdylHamiti II u drejtoi shqiptarëve një thirrje të jashtëzakonshme, ku i cilësonte të gjithë ata që kërkonin krijimin e një vilajeti të vetëm shqiptar si armiqtë më të rrezikshëm të Perandorisë Osmane.

Në këto kushteanëtarët e Lidhjesu afruan nëqytetin e Prizrenit, të bënin hapat e parë për zbatimin e programit të tyre autonomist. Në fund të dhjetorit ata riorganizuan Komitetin Kombëtar të Lidhjes Shqiptare, ku mbeti shumica e anëtarëve të mëparshëm, që ishin edhe ndër themeluesit e saj, si Ymer Prizreni, SulejmanVokshi³⁹, Shuaip Spahiu, AliIbraetj. Komiteti Kombëtar vendosi të përhapte kryengritjen kundërosmane në krejt vilajetin e Kosovës dhe të thërriste mbledhjen e Kuvendit të Përgjithshëm të Lidhjes Shqiptare për të formuar qeverinë e përkohshme. Kuvendi i Jashtëzakonshëm i Lidhjes Shqiptare u mblodh në Prizren në fillim të dhjetëditëshit të dytë të muajit janar. Në përfundim të punimeve Kuvendi i Jashtëzakonshëm miratoi, me pak ndryshime, Komitetin Kombëtar të mëparshëm të Lidhjes Shqiptare. Duke marrë parasysh detyrën e re që shtrohej para vendit - zëvendësimin e administratës osmane me administratën shqiptare autonome - Kuvendi e veshi organin qendror të Lidhjes Shqiptare me funksione të plota pushtetore. Për këtë qëllim ai e shpalli Komitetin Kombëtar qeveri të përkohshme me kryetar Ymer Prizrenin, nënkryetar Shuaip Spahiu dhe me dhjetë anëtarëAbdylfrashëri⁴⁰, i ngarkuar për punët e jashtme dhe SulejmanVokshi, i ngarkuar për punët ushtarake.

Radikaliteti i Lidhjes u bë edhe më i dukshëm nëkohënqë po vepronte kundër nëpunësve turq, të cilët u dëbuan nga administrata dhe në vendin e tyre u vendos

³⁹ - Shiko, vep. cit. *Relacionin e nënkolonelit turk MehmetMesuderguar Komandës së jashtëzakonshme tëPrizërenit për arresitimn e udhëheqësittëLidhjesShqiptare, SulejmanVokshit. (LidhjashqiptarePrizërenitnëaktetOsmane 1978-1912, Tiranë 1978, f. 250)*

⁴⁰ - Shiko, vep. Cit. *Kryesekretari i pallatit i kumton kryeministrit urdhrin e sulltanit për internimin përgjithmonë të AbdylFrashërit dhe të familjes së tij në Anadoll. (Lidhja Shqiptare e Prizërenit në dokumentet osmane 1878-1912, Tiranë 1978, f. 246)*

pushteti i Lidhjes. Forcat ushtarake të Lidhjes zunëpikat nyje të komunikimit si urat hekurudhore, në mënyrë që të pengohej ardhja e përforcimeve ushtarake osmane. Shoqëria e trenave me qendër në Shkup mori urdhër të mos transportonte trupa e municione për ushtrinë turke.

Por interesantë është fakti, që radikaliteti politik shqiptar shprehet edhe përmes një letër që Sami Frashëri i dërgonte nga Stambolli Jeronim de Radës në Itali në valën e këtyre ngjarjeve, më 20 shkurt 1881, shkruante.⁴¹

Qeveria e përkohshme synonte ta shtrinte kryengritjen e armatosur çlirimtare në krejt viset shqiptare, në vilajetin e Shkodrës, në Shqipërinë e Mesme e të Jugut. Një kujdes të veçantë i kushtoi ajo sanxhakut të Dibrës, si një hallkë që lidhte gjithë trevat shqiptare. Veprimtaria e qeverisë së përkohshme u përqendrua në ngritjen e forcave të armatosura shqiptare, në vendosjen e rendit publik, në organizimin e administratës së re e sidomos të gjykatave shqiptare (që u krijuan në çdo sanxhak duke zëvendësuar ato osmane), në krijimin e një buxheti të shtetit shqiptar, nëpërmjet përqendrimit në duart e Lidhjes të taksave shtetërore⁴². Administrata e Lidhjesi dhënë të posacme vendosjes së rendit publik, organet e Lidhjes Shqiptare harmonizuan të drejtën zakonore me ligjet që prodhoi vete Lidhja

Për natyrën radikaliste të politikës së Lidhjes ishte shprehur kryekonsulli austro-hungarez, i cili raportonte nga Shkodra, më 5 mars 1881, midis të tjerave: “Edhe nëpunësit më të vegjël janë caktuar nga Lidhja; gjyqtar është një qytetar i Prizrenit; taksat që nxirren nga popullsia derdhen në llogari të Lidhjes; nëpunësit i marrin rrogat rregullisht. Lidhja ka kujdes për mbajtjen e rendit qoftë në qytet, qoftë në fshat. Sigurimi publik tani është shumë më në rregull se ç’ ishte në kohën kur administratën e drejtonin funksionarët e sulltanit”⁴³.

Ngjarjet në Shqipëri, të cilat po çonin në prishjen e status quo-së në Evropën Juglindore, tronditën jo vetëm Portën e Lartë, por edhe Fuqitë e Mëdha.

⁴¹ - “Lidhja e Shqiptarëve që ka kërthizën në Prizren, në Gegëri, ka kërkuar shumë herë, që nga tre vjet e tihu, bashkimin e Shqipërisë me një provincë me autonomi; po mbretëria gjer më sot e kish gënjer me fjalë. Këtë herë shqiptarët e kuptuan fort mirë që mbretëria nuk do të bënë gjë kurrë për ta, dhe Lidhja e Prizrenit ka nevojë të bashkojë Shqipërinë e ta bënë një me autonomi, a mbase me shkepjtje fare pas punësë. Kështu Lidhja mori emrin e guvernës së përdorme (qeverisë së përkohshme - shën. i aut.) dhe përzuri guvernatorët turq nga gjithë vilajeti i Kosovës dhe nga Prizreni, nga Gjakova, nga Tetova, nga Dibra etj. 10 000 shqiptarë të armatosur kanë zënë Shkupin dhe udhënë e hekurtë; 10 000 të tjerë po bëhen gati për t’u unjur në Toskëri. Për pak kohë do të dëgjoni një kryengritje të madhe në Shqipëri”. (Shiko, vep. Cit. Lidhja shqiptare e Prizrenitw dokumentet osmane 1878-1912, Tiranw 1978)

⁴² - Refero Gjyqi i S V

⁴³ - Akademia e Shkencave RSH, Shqipëria në Vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Tiranë 1978, f. 105

Shqetësimin e tyre e rriti më tej qëndrimi i Greqisë, e cila, duke përfutur nga kryengritja shqiptare, filloi ta kërcënonte Perandorinë Osmane me luftë për ta detyruar që t'i lëshonte asaj Çamërinë e Thesalinë. Kriza që ishte duke përjetuar Ballkani nga Lëvizja Kombëtare Shqiptare i detyruan Fuqitë e Mëdha të ndërhyjnë për t'i detyruar Stambollin e Athinën që t'i jepnin fund çështjes së kufirit turko-grek, me qëllim që Porta e Lartë të ishte e lirë për të shtypur Lidhjen e Prizrenit.⁴⁴

Për të kuptuar ngutjen e veprimeve ushtarake të Portës së Lartë ndaj Lidhjes së Prizrenit po i referohemi protokollit, që u nënshkrua më 27 mars 1881, Perandoria Osmane pranoi t'i lëshonte Greqisë pjesën më të madhe të Thesalisë, afërsisht deri në lumin Selevria dhe një pjesë shumë të vogël në këndin juglindor të Epirit, konkretisht qytetin e Artës së bashku me rrethinat e tij. Ky vendim i Fuqive të Mëdha u mor për shkak të qëndresës radikaliste të trevjeçare të Lidhjes, e cila veçoi me ngulm, për të mos lëshuar asnjë pëllëmbë tokë shqiptare në vilajetin e Janinës⁴⁵.

Goditjen e parë ushtarake ia dha Komitetit të Lidhjes Shqiptare në Shkup, të kryesuar nga Jashar bej Shkupi. Ky komitet, ndryshe nga ata të qyteteve të tjera të Kosovës, nuk preku as administratën osmane, as mytesarifin dhe as garnizonin turk të qytetit. Ai nuk pengoi gjithashtu futjen e forcave të tjera ushtarake osmane më 27 shkurt 1881 dhe vendosjen këtu të Ibrahim Pashës si komandant i garnizonit. Më 23 mars Ibrahim Pasha thirri në selinë e tij 11 anëtarët e Komitetit të Lidhjes për Shkupin me Jashar bej Shkupin në krye, të cilët i arrestoi pabesisht.

Krahas përgatitjeve ushtarake, Lidhja e Prizrenit më 15 prill 1881 u drejtoi një memorandum ambasadorëve të Fuqive të Mëdha në Stamboll, që ishte dhe akti i fundit diplomatik i saj, me anën e të cilit, pasi shprehte vendimin që kishte marrë për të mbrojtur me armë të drejtat kombëtare, për të siguruar autonominë e Shqipërisë dhe për ta futur vendin në rrugën e përparimit e të qytetërimit, kërkonte ndërhyrjen e kancelarive evropiane për të ndaluar ekspeditën

⁴⁴ - sipas së cilës, në përfundim të luftës së përbashkët kundër Stambollit, Athina do të aneksonte provincën greke të Thesalisë, kurse shqiptarët do të fitonin pavarësinë kombëtare në kufijtë e tyre etnikë, duke përfshirë këtu edhe viset shqiptare të Çamërisë. Në fillim qeveria e Athinës u tregua e interesuar për bisedimet shqiptaro-greke, të cilat u zhvilluan në Korfuz. Por shpejt u pa se ajo nuk kishte hequr dorë nga platforma e saj, që parashikonte aneksimin e vilajetit të Janinës nga Greqia dhe bashkimin e Shqipërisë me Greqinë në formën e një shteti dualist. Veçkësaj, ndërsa vijonin bisedimet e Korfuzit, presioni i Fuqive të Mëdha ndaj Stambollit dhe Athinës u rrit aq shumë, sa Porta e Lartë e qeveria greke u detyruan të bënin lëshime dhe t'i jepnin fund grindjes rreth kufirit të tyre të ri. (Vep. Cit. Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente osmane 1878-1912, Tiranë 1978)

⁴⁵ - Shiko, vep. Cit. Dokumnete..., Tiranë 1979, f. 128-146)

ndëshkimore osmane.

Perballj e parë me ushtritë osmane ndodhi më 20 prill në Slivovë⁴⁶. Beteja e dytë ndodhi të nesërmen, më 21 prill 1881, në Shtimje⁴⁷. Në betejat e Slivovës e të Shtimjes të dyja palët patën shumë të vrarë e të plagosur, të cilat përfunduan me shtypjen epërgjakshme të shqiptarit ushtarak të Lidhjes⁴⁸.

Si përfundim mund të themi se qëllimi i Portës nuk ishte vetëm që të shtypte kryengritjen e armatosur kundërosmane, por të shuante edhe idenë e autonomiste të lëvizjes shqiptare, duke përfshirë këtu edhe kërkesën për formimin e një vilajeti të vetëm shqiptar. Për këtë, pasi shtypi qëndresën në Prizren, Porta e Lartë thirri këtu më 30 prill krerët e dikurshëm të Lidhjes për sanxhakët e Prizrenit, të Prishtinës, të Pejës, të Mitrovicës, të Shkupit, të Dibrës, të Shkodrës, të Manastirit etj., si edhe përfaqësuesit e qarqeve sulltaniste.

Ajo që ishte më e rëndësishme, për politiken e Portës se Lartë kishte të bënte me kërkesën e firmosjes së njënjë akt zyrtar, përmes së cilit të deklarohesh e dënuar lëvizja politike e Lidhjes, të cilën e quante njëakt armiqësor⁴⁹. Këtu erdhën kryesisht krerët sulltanistë dhe vetëm disa nga drejtuesit e moderuar të Lidhjes, si Ali pashë Gucia, Iljaz pashë Dibra, Hasan pashë Dervalla dhe Esat pashë Tetova, të cilët e nënshkruan deklaratën e Dervish Pashës. Si rrjedhim, krerët e moderuar, që e dënuan me shkrim idenë e vilajetit autonom, u quajtën nga sulltani të falur, madje disa prej tyre, si Ali pashë Gucia etj., u emëruan në poste të rëndësishme

⁴⁶ - *Edhe pse me municion të pakët, në saje të qëndrueshmërisë së tyre shqiptarët e ndalën për mjaft orë përparimin e armikut. Por gjendja e tyre u keqësua kur hyri në veprim artileria fushore turke. Duke parë dëmin që po u shkaktonte luftëtarëve një bateri e armikut, komandanti i këtij sektori, Mic Sokoli nga Bujani i Malësisë së Gjakovës, së bashku me disa luftëtarë të tjerë, lanë pozicionet mbrojtëse dhe u hodhën drejt kodrës ku ishte vendosur artileria turke. Qëllimi i tyre ishte të sulmonin dhe të asgjësonin baterinë e armatosur, që po u shkaktonte dëme shqiptarëve. Por të gjithë këta luftëtarë trima, së bashku me komandantin e tyre Mic Sokolin, u vranë përpara grykave të topave të artilerisë osmane. Përballë epërsisë së armikut në numër e në armatime, shqiptarët, me gjithë heroizmin që treguan, u detyruan të tërhiqeshin nga Slivova në Shtimje, ku qëndronin forcat kryesore të Lidhjes së Prizrenit.*

⁴⁷ - *Këtu luftimet qenë më të përgjakshme se në Slivovë. Në luftimet e ashpra, të cilat vazhduan më tepër se 2 orë, morën pjesë edhe vetë anëtarët e shtabit shqiptar, si Sulejman Vokshi, Ali Ibra, Binak Alia, Rustem Sadria e të tjerë. Edhe këtu vullnetarët shqiptarë luftuan me heroizëm të rrallë, por nën breshërinë e dendur të artilerisë së armikut dhe kur*

⁴⁸ - *Turqit rreth 800 veta, ndërsa shqiptarët 1 200 veta. Pas Shtimjes forcat e Lidhjes Shqiptare u bënë më 22 prill 1881 tri prita të tjera ushtrive osmane, në Grykën e Carralevës, në fshatin Dule dhe në hyrje të Suharekës, por marshimin e tyre nuk e ndalën dot. Të nesërmen, më 23 prill 1881, pasi theu qëndresën e shqiptarëve, Dervish Pasha, i shoqëruar nga 7 gjeneralë dhe me 24 batalione, hyri në Prizren ku shpalli menjëherë shtetrrëhimin dhe bëri arrestime të shumta.*

⁴⁹ - *Shiko, vep. cit. Dokumentet osmane 1878-1912, Tiranë 1978 "Procesi gjykimittë krerëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit" Vendimet e gjykatwsushtarake" f. 224-240*

në administratën e vilajeteve të Kosovës e të Manastirit. Si rezultat i ushtrimit të dhunës ushtarake shtetërore osmane, Lidhja Shqiptare e Prizrenit u shpërnda. Pushtetin në vilajetin e Kosovës e mori kudo administrata e Portës së Lartë. Kjo administratë filloi të qeveriste përmes dhunës e shprehur nëpërmjet arrestimeve dhe dënimeve panjehë proces të rregullt gjyqësor. Këto ishin veprime të një shtetëror feudal, i cili njihete vetëm të drejtën e tij, për të uzurpuar pushtetin dhe të drejtën natyrore të popullit shqiptar, që ky i fundit e kishte në frymën e tij.

In conclusion we can say that the goal of the High Gate was not only to suppress the armed rebellion against the counter-revolution, but also to extinguish the idea of autonomy of the Albanian movement, including the demand for the formation of a single Albanian vilayet. For this, after pressuring the resistance in Prizren, the High Gate summoned here on April 30 the former leaders of the League of Prizren, Pristina, Peja, Mitrovica, Skopje, Dibra, Shkodra, Bitola, etc., as well as representatives of Sultan's Circuits.

What was more important, from the political point of view for the High Gate had to do with the requirement of signing of one official act, by which he was accused of condemning the political movement of the League, moreover its request for joining the Albanian vilayet, which he called a hostile act. Here came mainly the sultan leaders and only some of the moderate leaders of the League, like Ali Isaë Gucia, Iljazsaë Dibra, Hasansaë Dervalla and Esat saw Tetova, who signed the statement of Dervish Pasha. Consequently, the moderate leaders, who were condemned in writing the idea of autonomous vilayet, were recalled by the forgiving sultan, and some of them, such as Ali Pasha Gucia, etc., were appointed to important positions in the administration of Kosovo's vilayet and monastery.

As a result of the exercise of Ottoman state military violence, the Albanian League of Prizren was distributed. The power in Kosovo's vilayet was taken everywhere by the administration of the High Gate. Its establishment was accompanied by an unspecified violence in Albania. There were arrested and sentenced without trial about 7 thousand activists and leaders of the League, 3,000 in Kosovo and 4,000 in Shkodra, Manastir and Ioannina villages.

REFERENCAT

1. Akademia e shkencave të RSH, Akte te Rilindjes Kombetare Shqiptare 1878-1912, Tiranë 1978
2. Akademia e Shkencave të RSH, Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizërenit I, Tiranë 1978
3. Akademia e Shkencave të RSH, Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizërenit II, Tiranë 1986
4. Akademia e Shkencave të RSH, Lidhja Shqiptare e Prizërenit në dokumente osmane 1878-1881, Tiranë 1978
5. KristoFrashëri, Lidhja Shqiptare e Prizërenit 1878- 1881, V-I Tiranë 1987
6. KristoFrashëri, Lidhja Shqiptare e Prizërenit 1878- 1881, V-II Tiranë 1989
7. Lidhja Shqiptare e Prizërenit, Tiranë 1979 “botim në ndihmë të shkollave” “Dokumente”

Dr. Nuridin AHMETI¹

FIGURA E SKËNDERBEUT NË SHTYPIN FETARË SHQIPTARË NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Abstrakti

Gjergj Kastrioti Skënderbeu, mbetet një nga figurat më frymëzuese për popullin tonë dhe, po ashtu, edhe ndër më të diskutuarat që nga periudha e Rilindjes Kombëtare e deri në ditët e sotme.

Ndër ato periudha, në të cilën figura e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut u bë pjesë e debatit, ishte edhe ajo në mes të dy luftërave botërore. Në këtë debat, natyrisht, pashmangshëm, nuk mbetën pa u përfshirë edhe revistat me karakter fetar që botoheshin asokohe nga komunitetet tona fetare në Shqipëri.

Revistat më në zë që botoheshin nga komunitetet tona fetare ishin: “Hylli i Dritës” (1913-1944) dhe “Leka” (1929-1944), të cilat i nxirrnin klerikët katolik shqiptarë, dhe revistat “Zani i Naltë” (1923-1939), “Kultura Islame” (1939-1946) dhe “Njeriu” (1942-1944), organe këto të Komunitetit Mysliman Shqiptar.

Në këto revista janë botuar një mori shkrimesh që për subjekt kanë Skënderbeun dhe bëmat e tij. Dhe jo vetëm kaq, por në faqet e këtyre revistave gjejmë edhe poezi e tregime që i kushtohen heroit tonë kombëtar-Skënderbeut.

Pikërisht këto shkrime të botuara në këto revista të kohës, do të merren në shqyrtim dhe do të analizohen e trajtohen veç e veç në kumtesën tonë.

Fjalët çelës: *Skënderbeu, “Hylli i Dritës”, “Leka”, “Zani i Naltë”, “Kultura Islame”, “Njeriu”, hero kombëtar etj.*

¹ *Instituti Albanologjik - Prishtinë*

Hyrje

Periudha ndërmjet dy luftërave botërore për shtypin fetarë shqiptarë shënon edhe një fazë të rëndësishme. Sepse në këtë kohë, me nismën e krerëve tanë fetarë, filluan të dilnin edhe revistat e para të cilat përfaqësonin komunitetet përkatëse, por të cilat përtej qëllimit të tyre në ngritjen fetare të besimtarëve të tyre, patën ndikim të ndjeshëm edhe në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme intelektuale dhe kulturore të lexuesve të tyre. Disa nga këto revista, për arsye të ndryshme, nuk patën jetë të gjatë, por disa prej tyre përjetuan daljen e shumë numrave, kishin një ndikim më të madh në shoqërinë e asaj kohe dhe arritën të mbushnin vite e dekada.

E, pikërisht këto të fundit i kemi marrë në shqyrtim në këtë kumtesë tonën, pra kemi marrë në shqyrtim paraqitjen e figurës së Skënderbeut në revistat fetare shqiptare që kishin ndikim në shoqërinë e asaj kohe dhe që dolën ndërmjet dy luftërave botërore.

Së këndejmi, po të shkonim sipas parimit kronologjik të botimit të këtyre revistave të botuara pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, del se e para revistë që u botua ka qenë *“Hylli i Dritës”*,² që u botua më 1913 me iniciativën e françeskanëve të Shqipërisë dhe nën udhëheqjen e At Gjergj Fishtës. E dyta pas kësaj, vjen revista e parë në gjuhën shqipe e Komunitetit Mysliman Shqiptarë, që doli në vitin 1923, me emrin *“Zani i Naltë”*,³ e pas këtyre dolën edhe revistat *“Leka”*,⁴ të cilën e drejtonin jezuitët që aso kohe udhëhiqnin edhe *“Kolegjin Saverian”* të Shkodrës. Dalja e revistave fetarë të shqiptarët, vazhdoi me revistat

² **“Hylli i Dritës”(1913-1944).** Revistë e përmuajshme kulturore-letrare e klerit katolik të Urdhrit Françeskan. Dilte në Shkodër. Ka botuar shkrime kulturore, shoqërore, letrare etj. Doli në tri periudha: tetor 1913-korrik 1914; maj 1921-dhjetor 1924; janar 1930-korrik 1944. Botohej pjesërisht edhe italisht, frëngjisht, gjermanisht. Themelues dhe drejtor i parë për 25 vjet (1913-1938) ishte Gj. Fishta. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar 2*, ASHSH, Tiranë, 2008, f. 966.

³ **“Zani i Naltë” (1923-1938).** Revistë fetare, organ i klerit mysliman, nga numri 1 i v. 1929, botim i Komunitetit Mysliman Shqiptar. Numri i parë doli në tetor 1923. Një pjesë e shkrimeve ishin arabisht. Revista mbulonte një tematik të gjerë: morale, shoqërore, kulturore, letrare etj., shtjelluar në trafsh kombëtar. Botoi edhe trajtesa filozofike nga autorë të njohur të kohës”. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar 3*, ASHSH, Tiranë, 2009, f. 2976-2977.

⁴ **“Leka”(1929-1944).** Revistë e përmuajshme e klerit katolik shqiptar. Organ i shoqatës “Leka”, e themeluar më 9 dhjetor 1928 nga ish-nxënësit e Shkollës së Jezuitëve në Shkodër (Kolegja Saveriane). U ideua nga etërit jezuitë Z. Valentini e F. Kordinjano si revistë kulturore, politike, filozofike, etj. Numri i parë qarkulloi në muajin prill 1929. Në v. 1941 u ndërpre botimi, ndërsa në v. 1942 doli një numër i veçantë me materiale arkivore e publicistike, në vijim të numrave përkujtimor me rastin e 25-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë”. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar 2...*, f. 1460.

“*Kultura Islame*”⁵ dhe “*Njeriu*”,⁶ të cilat ishin organe të Komunitetit Mysliman Shqiptar.

Duhet theksuar edhe një herë faktin se këto revista edhe pse botoheshin dhe drejtoheshin nga njerëz që vinin nga komunitetet fetare përkatëse, ato trajtoni tema edhe me karakter politik, kombëtare, kulturor etj.

Në këto revista, ku më shumë e ku më pakë, rëndësi iu kushtua, - e kuptueshme dhe e natyrshme, - edhe figurës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

Skënderbeu hero kombëtar i shqiptarëve

Revista “*Hylli i Dritës*” po thuhet nga numrat e parë të daljes sa saj, figurën e Skënderbeut e ka trajtuar dhe atë në disa aspekte si:

1. Në *aspektin historik*, Në vitin 1924, botohet një shkrim kritikë ndaj një fletushke me titull: “Tri pyetje nga jeta e Skender Beut” të autorit Djevat Korça. Për më tepër autori i shkrimit, të botuar në “*Hylli i Dritës*” shkruan me pseudonim “*Criticues*” dhe shkas për këtë siç vërehet nga rreshtat e shkrimit, autori merr nga hyrja e fletushkës, ku kritikohen fretërit françeskan, se nuk kanë bërë shumë për ta ndriçuar jetën dhe veprën e Skënderbeut ”Sivjet një farë z. Djevat Korçet po boton një broshyrë nen titulln: “Tri pyetje nga jeta e Skander Beut, edhe vetë auktori e quen ”veper shkencore”, e ma teper shkruen neper fletore, “se Fretent e Shqipëris në 600 vjet nuk kan botue as një libër historik që të mund të perkrahet me librin t’em”,⁷- shkruan autori i shkrimit në “*Hylli i Dritës*”. Një konstatim i tillë i z. Djevat Korça, ndaj fretërve françeskan është i pa pranueshme dhe për më tepër konstatimet e tij, autori Criticus i quan “pallavra”.⁸

Në qoftë se për z. Djevat Korça, aspekti shkrimor i fretërve françeskan për ta ndriçuar jetën dhe veprën e Skënderbeut ka munguar për 600 vjet, për Antonin Fishtë, françeskanët ishin prezentë me kontributet e tyre që nga koha e Skënderbeut në hapësirat shqiptare dhe se ata e ndihmuan edhe drejtpërdrejtë Skënderbeun, sepse respekti që populli shqiptar ka për françeskanët “na e bajn

⁵ “**Kultura Islame**”(1939-1946). Revistë e përmuajshme fetare, filozofike, letrare, morale e shoqërore, organ e Komunitetit Mysliman Shqiptar në Tiranë. Botohej pjesërisht edhe italisht. Numri i parë qarkulloi më 1 shtator 1939. Revista botonte artikuj letrarë me ngjyrë fetare-morale; artikuj kulturorë mbi sociologjinë, filozofinë etj”. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar 2...*, f. 1407.

⁶ “**Njeriu**” (1942-1944). Revistë e përmuajshme fetare e besimit mysliman, me lëndë morale, shoqërore, letrare, kulturore etj. Organ i organizatës “Drita hyjnore” të klerit mysliman. Botohej në Tiranë. Dolën 27 numra. Me gjithë orientimet fetare, ajo trajtoi gjerësisht probleme letrare, filozofike dhe kulturore nga autorë shqiptarë e të huaj. Numri parë doli në janar 1941”. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar 3...*, f. 1862.

⁷ Criticus, ”Bibliografi”, *Hylli i Dritës*, nr. 1-2, Kallnduer-Fruer, Shkodër, 1924, f. 69.

⁸ *Hylli i Dritës*, nr. 1-2, Kallnduer-Fruer, Shkodër, 1924, f. 69.

dishmi sidomos nderemjetsit e tyne ndershej Princavet shqyptarë, kuer kta kishin ndo'i çashtje me njani tjetrin, e legacjonet qi kta Princa ase edhe vetë Fatosi i Krues Skanderbegu u la në dorë kuer kishte ndo'i punë, me sunduesë a mreten të Shteteve t'Europës, ase edhe per kundra kuer Shtetet tjera t'Europës kishin ndo'i punë a çashtje me princa Shqyptarë".⁹

Për një varg shkrimesh të botuara në këtë revistë edhe në këtë aspekt duhet përmendur Marin Sirdanin. Ky autor, trajton tematikën rreth jetës dhe veprës së Skënderbeut, që mbase edhe sot janë atraktive për studiuesit në lidhje me Skënderbeun, bie fjala artikujt: "Kerkime mbi vorrin e Skanderbegut",¹⁰ "Nji rival i Skanderbegut",¹¹ "Në shka fajiset Skanderbegu",¹² "Ku u vorrue Skanderbegu",¹³ "Andrra në diell"¹⁴ etj. Artikulli i fundit "Andrra në diell" madje është recension që autori i bën një artikulli të botuar në gazetën "Rinija Fashiste" të asaj kohe me titull: "Vdekja e Skanderbegut".¹⁵

Revista "Hylli i Dritës" ka botuar edhe dokumente origjinale që flasin për familjen e Kastriotëve dhe lidhjet e tyre me Napolin.¹⁶ Këto shkrime kanë për autor Athanas Gegajn, autor edhe i librit për Skënderbeun, vepër kjo që tashmë është përkthyer edhe në gjuhën shqipe.¹⁷ Këto dokumente janë të botuara me tekst origjinal në italisht dhe për kohën kur u publikuan mbanin primatin e dokumenteve të pabotuara. Nga i njëjti autor në këtë revistë hasim edhe artikuj për figurën e Skënderbeut si bie fjala artikulli me titull: "Gurrat historike t'epokës së Skanderbegut".¹⁸ Kur flasim për publikimin e dokumenteve për Skënderbeun duhet potencuar se përveç Athanas Gegës kemi edhe një autor tjetër, njëfarë Gjon Shllaku i cili botoi dokumente origjinale që tregojnë lidhjet e Skënderbeut

⁹ P. Antonin Fishta o.f.m,"Skanderbegu e Françeskajt", *Hylli i Dritës*, nr. 7-8, Korrik-Gusht, Shkodër, 1930, f. 366-367.

¹⁰ *Hylli i Dritës*, nr. 4, Prill, Shkodër, 1932, f. 181-194.

¹¹ *Hylli i Dritës*, nr. 7-8, Korrik-Gusht, Shkodër, 1932, f. 385-395; *Hylli i Dritës*, nr. 9, Shtatuer, Shkodër, 1932, f. 437-443.

¹² *Hylli i Dritës*, nr. 3, Marc, Shkodër, 1935, f. 153-158; *Hylli i Dritës*, nr. 11, Nanduer, Shkodër, 1935, f. 550-557; *Hylli i Dritës*, nr. 1, Kallnduer, Shkodër, 1936, f. 30-35; *Hylli i Dritës*, nr. 3, Marc, Shkodër, 1936, f. 130-136.

¹³ *Hylli i Dritës*, nr. 7-8, Korrik-Gusht, Shkodër, 1937, f. 331-333.

¹⁴ *Hylli i Dritës*, nr. 3-4, Marc-Prill, Shkodër, 1940, f. 187-192.

¹⁵ *Hylli i Dritës*, nr. 3-4, Marc-Prill, Shkodër, 1940, f. 187-192.

¹⁶ A.G,"Dokumenta mbi relacione mjes të Napolit e familjes së Kastriotve", *Hylli i Dritës*, nr. 11, Nanduer, Shkodër, 1938, f. 617-620; *Hylli i Dritës*, nr. 12, Dhetuer, Shkodër, 1938, f. 697-701.

¹⁷ At Athans Gegaj OFM, *Arbëria dhe Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468*,(Zgjidhi për ju: Gjergj Gashi), Eurorilindja, Tiranë, 1995.

¹⁸ *Hylli i Dritës*, nr. 1, Kallnduer, Shkodër, 1939, f. 49-53.

me Raguzën.¹⁹ Tekstet e këtyre dokumenteve janë në kroatisht, italisht e shqip.

Te “Hylli i Dritës” hasim të botuar me përzgjedhjen e redaksisë edhe letra të tjera që bëjnë fjalë për Skënderbeun, si për shembull shkrimi “Nji leter e Gjergj Kastriotit dergue qytetit të Siena-s”.²⁰

2. Në *aspektin folklorik*, duke publikuar tregime për Skënderbeun të mbledhura në viset e ndryshme të Shqipërisë. Në këtë aspekt duhet veçuar shkrimet e autorit Marin Sirdanit, edhe pse artikulli i tij për Skënderbeun nuk është në tërësi tregimtarë, por është: “Historia e legenda”²¹- siç e thotë edhe vetë autori.

3. Në *aspektin letrar*, numri i pesë i vitit 1914 boton një dramë të titulluar: “Perpara derës s’Parrizit” ku biseda zhvillohet në me të Shën Pjetrit, Skënderbeut dhe Djallit, e që për autor ka Gj. Fishtën, i cili nënshkruhet me pseudonim Castigan Ridendo. Kjo dramë botohet në vazhdimë.²² Ndërsa, autori Filip Fishta e trajton “Skenderbun në letërsinë shqipe”.²³

Si personalitet historik Skënderbeu sigurisht që ka lenë mbresa edhe të fqinjët me të cilat herë pas herë kishte edhe marrëdhënie të mira. Në shenjë respekti për kontributin e tij, Italia në vitin 1936 vendosi që një rrugë në Bari t’i vente emrin e Skënderbeut. Në lidhje me këtë, në rubrikën “Lajme rrokull Shqypnis”, në mes tjerash, shkruhej: “Nji rrugë në Bari emnohet ”Skanderbeg”.- Kryetari i Bashkis së këtij gjyteti njoftoi Konsullin e pergjithshem të Shqypnis, z. Dr. Tahir Shtyllen, se njaj rrugë i ka vu emnin e heroit kombëtar Gjergj Kastriota Skanderbeg: e këta per kujtim të lidhjeve miqësore qi kanë kenë gjithherë e janë edhe sot nderemjet metropoles së bregut t’andejshem e t’atdheut të fatosit Kruetan”.²⁴

Aspektet e lartëthëna të trajtuara nga “Hylli i Dritës” i hasim edhe në revistën “Leka”, por me autorë të tjerë, sidomos këtu duhet të veçojmë vështrimet e drejtuesit të kësaj reviste Zef Valentinit me titull “Gjergj Kastrioti pasqyra e atdhetarit shqiptar”, i cili përshkruan Skënderbeun, ndër të tjerash, edhe si

¹⁹ P. Gjon Shllaku, o.f.m, “Dokumente historije”, *Hylli i Dritës*, nr. 3-4, Marc-Prill, Shkodër, 1940, f. 182-186; *Hylli i Dritës*, nr. 7-8, Korrik-Shtatuer, Shkodër, 1940, f. 396-400.

²⁰ “Nji leter e Gjergj Kastriotit dergue qytetit të Siena-s”, *Hylli i Dritës*, nr. 3-5, Marc-Maj, Shkodër, 1941, f. 224-225.

²¹ P. Marin Sirdani o.f.m, “Zembra e Skanderebegut”, *Hylli i Dritës*, nr. 5, Maj, Shkodër, 1931, f. 291-299.

²² *Hylli i Dritës*, nr. 5, Fruer, Shkodër, 1914, f. 163-168; *Hylli i Dritës*, nr. 6, Marc, Shkodër, 1914, f. 191-193.

²³ Filip Fishta, “Skanderbue në Letersin shqipe”, *Hylli i Dritës*, nr. 6-7, Qershuer-Korrik, Shkodër, 1944, f. 95-101.

²⁴ *Hylli i Dritës*, nr. 5, Maj, Shkodër, 1936, f. 226-227.

ringjallës të kombit apo të “komit” siç do ta shkruante Zef Valentini.²⁵

Në revistën “Leka” hasim edhe tregim kombëtarë apo “Kallxim komtar” me autor Zef Harapin,²⁶ ku shkruan për sprovat para të trimërisë së Skënderbeut.

Për vështrimin në aspektin letrarë për Skënderbeun në revistën “Leka” e hasim shkrimin e vitit 1933 me titull: “Neper hije të Skenderbegut”.²⁷

Në anën tjetër, revista e Komuniteti Mysliman Shqiptar “*Zani i Naltë*” në muajin tetor të vitit 1931, në rubrikën “Nga fletët e Historisë” dhe me titullin “Si u zhvillue islamizma në Shqipni”, kur bënë fjalë për fillet e ardhjes së islamit te shqiptarët, në mes tjerash, shkruan: “Shqipnia mundi me rifitue independencën e vet në kohë të Gjergj Kastriotit qi kje titullue me emnin mysliman “Skender Beg”.²⁸ Por në këtë artikull autori nuk pajtohet që Skënderbeu të jetë marrë pengë nga turqit në moshë të re. Për mendimin tim, ky konstatim duhet të jetë rezultat nga leximi i librit të orientalistit të njohur anglez Tomas W. Arnold i botuar në Londër më 1913,²⁹ i cili autor ka të njëjtin qëndrim, sikurse autori i shkrimit në revistën “*Zani i Naltë*”. Si duket, kjo vepër, e cila kishte bërë mjaftë bujë në qarqet intelektuale të kohës, do të ketë qarkulluar dhe do të ketë qenë e njohur edhe tek shqiptarët, kjo sepse trajton përhapjen e islamit nëpër botë në përgjithësi, por edhe te shqiptarët në veçanti. Për më tepër, ky autor në kuadër të elaborimit të përhapjes së islamit te shqiptarët, kur fletë për rininë e Skënderbeut konstaton se “rrëfimet se ai ende si fëmijë është marrë pengë nga turqit dhe se është edukuar ndër myslimanët duke tërhequr vëmendjen e sulltanit, hulumtimet historike i kanë zbuluar si trillime. Në këtë pikëpamje fakte të verifikuara janë këto: Iskender-beu e ka kaluar rininë e vet në viset malore të banuara me shqiptarë”-³⁰ përfundon konstatimin orientalisti Thomas W. Arnold.

Revista “*Zani i Naltë*, po ashtu, botonte shkrime dhe të autorëve shqiptarë që e lartësonin figurën e Skënderbeut edhe në vargje, si bie fjala, vargjet e shkruara nga Ferit Vokopola,³¹ pastaj nga një autor me pseudonimin Dibrani,³² nga Hafiz Ali Korça etj. Këtu, sa për ilustrim, po veçojmë vargjet e Hafiz Ali Korçës, i cili në qershor të vitit 1928 duke i kushtuar disa vargje mbretit Ahmet Zogut e

²⁵ Zef Valentini, “Gjergj Kastrioti pasqyra e atdhetarit shqiptar”, *Leka*, nr. 8-12, Nanduer, Shkodër, 1937, f. 535-546.

²⁶ Zef Harapi, “Peng a rob?”, *Leka*, nr. 11, Nanduer, Shkodër, 1931, f. 354-358.

²⁷ K. Masrreku, “Neper hije të Skenderbegut”, *Leka*, nr. 9, Shtatuer, Shkodër, 1932, f. 271-273.

²⁸ “Si u zhvillue islamizma në Shqipni”, *Zani i Naltë*, nr. 2, Tetuer, Tiranë, 1931, f. 55.

²⁹ Vepra e Thomas W. Arnoldit, është përkthyer edhe në gjuhën shqipe me titull: *Historia e përhapjes së Islamit*, (Përktheu: Nexhat S. Ibrahim), ShB, Dituria Islame, Prishtinë, 2004.

³⁰ Thomas Arnold, *Historia e përhapjes...*, f. 169.

³¹ Ferit F. Vokopola, “Fluturimet e shpirtit”, *Zani i Naltë*, nr. 3, Tetuer, Tiranë, 1926, f. 94.

³² *Zani i Naltë*, nr. 8, Qershuer, Tiranë, 1928, f. 605.

bënë një krahasim të këtij të fundit me Skënder Kastriotin. Poezia mbanë titullin “Kurora Mbretërore”, në të cilën, përveç tjerash, poeti thotë:

“ O flamur i shenjtë çeli fletët tinë
Mjaft e derdhe gjakun mjaft e zgjate zinë
Se ke sipër ZOGUN që ta fali Zoti
Si ishte që moti Skander Kastriijoti”³³

Këto nuk janë vargjet e vetme në revistën “Zani i Naltë”. Vargje që e lartësojnë figurën e Skënderbeut, hasim edhe në disa numra të kësaj reviste, e sidomos në numrat që i kushtoheshin festës së 28 Nëntorit, dhe kur përmendej Flamuri Kombëtar ai gjithmonë identifikohet me Skënderbeun.

Figura e Skënderbeut, behët pjesë e një debati, në një artikull të vitit 1936, që botohet në revistën “Zani i Naltë”. Siç edhe potencohet në këtë shkrim, arsyeje e zhvillimit të kësaj replike, është shkrimi që botohet në gazetën kulturore “Rilindja” në Mars të vitit 1936 në Korçë. Kjo gazetë sipas artikullshkruesit drejtohet nga Dr. Pandi M. Frashëri. Sulmi i saj ishte bërë ndaj fesë islame dhe besimtarëve shqiptarë. Duke u ndier të fyer nga një artikull i tillë, drejtuesit e gazetës “Zani i Naltë”, vendosin që t’i përgjigjen. Sulmi ndaj besimtarëve mysliman shqiptarë nga “Rilindja” në mes tjerash e përshkruan se “Shqiptarët e Skënderbeut ishin të krishter dhe ky ish thërritur prej popujve të Evropës qi të luftonte për Kryqin. Armiqt e Skënderbeut ishin muhamedan dhe me të zaptuar Shqipërinë e tij, pas vdekjes së tij, u përpoqën qi kësaj t’i heqin fenë e armikut të tmershëm të tyre dhe të ngulin në vend të saj fenë e tyre”- ky ishte njëri nga pasueset e shkrimit të gazetës “Rilindja” për të cilin, drejtuesit e revistës “Zani i Naltë” ishin ndier të fyer dhe në përgjigjen e tyre ata shkruajnë: “ Këra rrjeshta i shkruën një gazetë kulturele, Rilindja, edhe në emën të nasjonalizmit Shqiptar!... Skënderbue i pranuem prej gjith kombit si “*Hero Kombëtar*” sod na paraqitet prej Rilindjes si “*Gjeneral i Kryqit*” edhe përsëri këjo e përkohëshme vazhdon tue derdh lot krokodili për *bashkim kombëtar*. Sa kontrast i madh!.... Pasta ndryshohen edhe faktet historike. Skënderbue nuk ka luftue për kryq por për atdhe nuk ka luftue kundër fesë islame, por kundër Turkut. Duhet të dihet se vetë Skënderbeu ka qenë muhamedan e nuk ka themel ajo qi thohet se aj u ba i krishtenë. Sepse, po të bahesh i krishtenë, Shqiptarët s’kishin me e dijtë emnin “Skënderbej”. M’anë tjetër, krahë për krahë me Skënderbun ka qenë edhe nipi i tij Hamza Bej Kastriijoti, për të cilin askush nuk ka pretendue se e la fenë *Islame*. Veç kësaj Skenderbeu ka luftue edhe kundër Venecjanëve të Krishtenë. Me gjith këtë sod Skënderbeu asht pranue prej të gjithëve si afetar, për veç “*Rilindjes*”, e cila e do t’ishite ma mirë qi t’a kishte pasë emin “*Vjetër-lindja*” mbassi kërkon me ngjall “*Kryqzatat e Vjetra*”, të cilat akoma edhe sot i mallkon

³³ H. Ali, “Kurora Mbretërore”, *Zani i Naltë*, nr. 8, Qershuer, Tiranë, 1928, f. 602.

edhe vetë bota e kerishtenë”.³⁴ Po që se analizohet me kujdes pasuesi i shkruar nga gazeta “Rilindja” edhe përgjigja e bërë nga “Zani i Naltë”, për mendimin tim, tingëllojnë shumë aktuale.

Të njëjtat trajtime për Skënderbeun i hasim edhe në dy revistat e tjera të Komunitetit Mysliman Shqiptar, në revistën “Kultura Islame” dhe “Njeriu”.

Revista “Kultura Islame” nga muaji nëntor i vitit 1939, boton një shkrim në dy vazhdime, ku trajton shqiptarizmin jashtë dhe brenda atdheut. Objekt trajtimi në këtë artikull autori Izet Bebeziq, ka shpërnguljen e popullatës shqiptare për Thesali, ishujt grekë dhe More në periudhën “përpara dhe rrotull sundimit ottoman”.³⁵ Krahas këtij trajtimi, autori gjithashtu shkruan edhe për kolonitë e arbëreshe në Itali, shpërnguljen e shqiptarëve në këtë vend pas vdekjes së Skënderbeut etj. Vendosja e tyre u bë kryesitë në kohën e Alfonsit, sepse siç tashmë është e njohur, Skënderbeu kishte marrëdhënie të mira diplomatike me mbretërinë e Alfonsit³⁶ dhe pas vdekjes së Alfonsit, Skënderbeu i ofron ndihmë lufte pasardhësit të Alfonsit, mbretit Ferdinand. Sipas, artikullshkruesit, njëra nga arsytet pse shqiptarët u vendosën në Itali, ishte edhe falë këtyre marrëdhënie që Skënderbeu kishte sa ishte gjallë me Alfonsin dhe më pas edhe me Ferdinandin, e kjo ndikoi që edhe pas vdekjes së Skënderbeut shqiptarët shkuan dhe u vendosën atje.³⁷

Periudha pas vdekjes së Skënderbeut në historiografinë shqiptare përshkruhet periudhë me pasoj të rënda ekonomike, demografike etj.³⁸ Revista “Kultura Islame” e pranon një mendim të tillë kur thotë: “Prej kësaj kohe nisë për Atdhen e ynë ay prapsim geopolitik dhe shqonuer, i cili vazhdoi dhe vioji deri në ditët e shpalljes së liris kombëtare”,³⁹ më pastaj po në këtë revistë shkruan: “Nji hije e zezë, porsi cipa e territ të natës, mbuloi Shqypnin mbas vdekjes së Lunait Kruetan”.⁴⁰ Por, përtej kësaj që shkruan autori i shkrimit, vazhdon edhe më një konstatim tjetër se pas vdekjes së Skënderbeut “Shqipëria në kohët e Turqvet u-bë m’e pasurë e m’e-begatë se kurdo; se Shqipëtarët sulëshinë bashkë me Turqit nëpër gjith anët të botës, edhe këthehëshin ngarkuarë me ar e me argjent me armë të vjetëra e me kuaj të bukur t’Arabisë. Me të qënë më trima e më të

³⁴ “Qi të triumfojë e vërteta”, *Zani i Naltë*, nr. 4, Prill, Tiranë, 1936, f. 107-108.

³⁵ Izet Bebeziq, “Shqiptarizimi jashta dhe mbrenda atdheut”, *Kultura Islame*, nr. 3, Nanduer, Tiranë, 1939, f. 110.

³⁶ Besa Bakalli-Haxhiq, “Skënderbeu dhe Alfonsi i V”, *Simpoziumi për Skënderbeun*, (9-12 maj 1968), IAP, Prishtinë, 1969, f. 57-56.

³⁷ *Kultura islame*, nr. 3, Nanduer, Tiranë, 1939, f. 112.

³⁸ *Historia e popullit shqiptar I*, ASHSH-IH-Toena, Tiranë, 2002, f. 465.

³⁹ *Kultura Islame*, nr. 3, Nanduer, Tiranë, 1939, f. 114.

⁴⁰ *Kultura Islame*, nr. 8, Prill, Tiranë, 1940, f. 310.

zotë se Tyrqitë, shkonin edhe nëpër më të mbëdhenji e më të nderçmit vënde, e kishin më tepër nder se ata vetë Tyrqitë”.⁴¹

Në vitin 1940, në muajin prill, botohet një artikull me karakter historik, që bënë fjalë për pajtimin e gjaqeve në vitin 1876. Autori i shkrimi, në hyrje jep një sqarim se ç’farë është historia dhe për ç’farë na shërben ajo? Për autorin në fjalë, historia na shërben për të na paraqitur ngjarjet nga kohet më të vjetra e deri në ditët e sotme, dhe, përveç tjerash, shkruan autori, historia na tregon edhe për historinë tonë shqiptare ku ”na paraqet kohët e lumnueshme të Skanderbuet, mbretit të Shqypnis, herojt kombëtar, i cili luftoi për pamvarsin e Shqypnis e për të pritë hovin e furishëm të tyrqeve që të mos hapeshin n’Oksident. Tregohen imtisht, në histori, trimënitë e Skënderit Trim dhe të popullit kreshnik Shqyptar”.⁴²

Epitete për Skënderbeun si këto që i hasim në këta pak rreshta që përmendem më lartë, si: “Mbret i Shqypnis”, “Hero kombëtar”, “Skënder Trimi”, “Kreshnik Shqyptar”, “Luan Kruetan”, janë epitete që nuk i hasim në kaq pak rreshta në revistat tjera, të cilat i kemi marr në trajtim.

Në aspektin letrar, emri i Kastriotit përmendet në vargjet e “Kulturës Islame” me titull: “Dëshmor të Kombit”⁴³ dhe në tregimin “Episod mbi Skanderbegun”.⁴⁴

Duhet theksuar se te revista “Njeriu” shkrimet për Skënderbeun, ilustrohen edhe me portrete të tij.⁴⁵ Dhe kjo sigurisht që ka domethënieën e vetë. Për më tepër Ferit Vokopola, njëri nga nënshkruesit e aktit të Pavarësisë së Shqipërisë, në numrin nëntor të vitit 1942, në revistën “Njeriu” kur flet për ngritjen e Flamurit Kombëtar, ja se ç’shkruan: ”Ky altar i shenjtë i lirisë Arbërore duke prirë përpara mbretin trim dhe Heroin Kombëtar, Skënder Ben. Nër aqë luftra të përgjakshme, në syksese mbi syksese, nuk ishte nderuar vetëm Shqipërinë por njëkohesishtë i kishte shërbyer Europës t’asaj kohe si një moroje...”.⁴⁶

⁴¹ *Kultura Islame*, nr. 3, Nanduer, Tiranë, 1939, f. 114.

⁴² Asim Lohja, ”Dy fjalë mbi të kaluemen-Pajtimi i gjaqeve: 1876”, *Kultura Islame*, nr. 8, prill, Tiranë, 1940, f. 310.

⁴³ Refik H. Bezhani, ”Dëshmor të Kombit”, *Kultura Islame*, nr. 4, Dhjetuer, Tiranë, 1939, f. 153.

⁴⁴ Postribësja, “Episod mbi Skanderbegun”, *Kultura Islame*, nr. 10, Qershuer-Korrik, Tiranë, 1942, f. 316-317.

⁴⁵ *Njeriu*, nr. 5, Nanduer, Tiranë, 1942, f. 3, 14.

⁴⁶ Ferit Vokopla, ”Ngritja e Flamurit Kombëtar”, *Njeriu*, nr. 5, Nanduer, Tiranë, 1942, f. 3.

Përfundim

Duke i shfletuar revistat nga shtypi ynë fetarë në mes dy luftërave botërore, mund të përfundojmë se e përbashkëta e këtyre revistave është se figurën e Skënderbeut e trajtojnë si figurë historike, kombëtare, udhëheqës, diplomat.

Revista katolike "Hylli i Dritës" dhe "Leka" për nga vëllimi i shkrimeve figurës së Skënderbeut i kanë dhënë më shumë hapësirë, madje kanë botuar edhe dokumente që bëjnë fjalë për Skënderbeun.

Në anën tjetër, revistat myslimane: "Zani i Naltë", "Kultura Islame" dhe "Njeriu" ndonëse nuk kanë ndonjë shkrim ku bëhet fjalë ekskluzivisht për figurën e Skënderbeut, megjithatë aty nuk vihet në dyshim asnjëherë të vetme Skënderbeu si hero i yni kombëtar. Për më tepër, këto revista nuk harrojnë dhe nuk ngurrojnë të botojnë edhe portrete të Skënderbeut dhe të konstatojnë lidhjen që ka Flamuri Kombëtar me Skënderbeun. Dhe sa herë shkruhet për Flamurin Kombëtar aty përmendet edhe Skënderbeu, të cilin për ta lartësuar edhe më shumë e krahasojnë edhe me Aleksandrin e Madh.

Në qoftë se paraardhësit tanë nga komunitetet fetare e trajtuan me të drejtë Skënderbeun si hero kombëtarë etj., atëherë nuk ka asnjë arsye që sot shtypi i komuniteteve fetare shqiptare të ketë tjetër mendim e qëndrim.

Dhe në fund fare, marrë në përgjithësi themi se e kaluara e komuniteteve tona fetare ka dëshmuar se ato si në aspektin intelektual e shkrimor po ashtu edhe kombëtarë kanë qenë në nivelin e duhur dhe në vijë të drejtë.

THE PERSONALITY OF SKANDERBEG IN THE RELIGIOUS ALBANIAN PRESS BETWEEN TWO WORLD WARS

By browsing the magazines of our religious press between the two world wars, we can conclude that the common of these magazines is that Skanderbeg's personality is treated as a historical, national personality, leader and diplomat.

Catholic magazines "Hylli i Dritës" and "Leka" to the volume of articles of Skanderbeg personality, have given more space, they have even published documents referring to Skanderbeg.

On the other side, the Muslim magazines: "Zani i Naltë", "Kultura Islame" and "Njeriu", although they do not have any exclusive writing about Skanderbeg's personality, yet Skanderbeg has never been dubbed as our national hero. Moreover, these magazines do not forget and do not hesitate to publish portraits of Skanderbeg and ascertain the connection that the National Flag has with Skanderbeg. And whenever you write about the National Flag there is mention Skanderbeg, which, to exalt him even more, is compared to Alexander the Great. If our ancestors from religious communities correctly treated Scanderbeg as a national hero etc.

If our predecessors from religious communities correctly treated Scanderbeg as a national hero etc., then there is no reason why today the press of Albanian religious communities to have a different opinion and attitude.

And in the end, we are generally saying that the past of our religious communities has shown that both intellectual and textual as well as national aspects have been at the appropriate level and in the right line.

Bibliografia

- A.G., "Dokumenta mbi relacione mjes të Napolit e familjes së Kastriotëve", *Hylli i Dritës*, nr. 11, Nanduer, Shkoder, 1938
- Ali, H., "Kurora Mbretrore", *Zani i Naltë*, nr. 8, Qershuer, Tiranë, 1928
- Arnold, Thomas W., *Historia e përhapjes së Islamit*, (Përktheu: Nexhat S. Ibrahim), ShB, Dituria Islame, Prishtinë, 2004.
- Bakalli-Haxhiq, Besa, "Skënderbue dhe Alfonsi i V", *Simpoziumi për Skënderbeun*, (9-12 maj 1968), IAP, Prishtinë, 1969
- Bebeziq, Izet, "Shqiptarizimi jashta dhe mbrenda atdheut", *Kultura Islame*, nr. 3, Nanduer, Tiranë, 1939
- Bezhani, Refik H., "Dëshmor të Kombit", *Kultura Islame*, nr. 4, Dhetuer, Tiranë, 1939
- Criticus, "Biblijografi", *Hylli i Dritës*, nr. 1-2, Kallnduer-Fruer, Shkodër, 1924.
- Fishta, Filip, "Skanderbue në Letersin shqipe", *Hylli i Dritës*, nr. 6-7, Qershuer-Korrik, Shkodër, 1944
- Fishta, P. Antonin o.f.m., "Skanderbegu e Françeskajt", *Hylli i Dritës*, nr. 7-8, Korrik-Gusht, Shkodër, 1930.
- *Fjalori Enciklopedik Shqiptar 2*, ASHSH, Tiranë, 2008
- *Fjalori Enciklopedik Shqiptar 3*, ASHSH, Tiranë, 2009
- Gegaj, At Athans OFM, *Arbëria dhe Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468*, (Zgjedhi për ju: Gjergj Gashi), Eurorilindja, Tiranë, 1995
- Harapi, Zef, "Peng a rob?", *Leka*, nr. 11, Nanduer, Shkodër, 1931
- *Historia e popullit shqiptar I*, ASHSH-IH-Toena, Tiranë, 2002
- Lohja, Asim, "Dy fjalë mbi të kaluemen-Pajtimi i gjaqeve: 1876", *Kultura Islame*, nr. 8, prill, Tiranë, 1940
- Masrreku, K., "Neper hije të Skenderbegut", *Leka*, nr. 9, Shtatuer, Shkodër, 1932
- "Nji leter e Gjergj Kastriotit dergue qytetit të Siena-s", *Hylli i Dritës*, nr. 3-5, Marc-Maj, Shkodër, 1941
- Postribësja, "Episod mbi Skanderbegun", *Kultura Islame*, nr. 10, Qershuer-Korrik, Tiranë, 1942
- "Qi të triumfojë e vërteta", *Zani i Naltë*, nr. 4, Prill, Tiranë, 1936
- "Si u zhvillue islamizma në Shqipni", *Zani i Naltë*, nr. 2, Tetuer, Tiranë, 1931
- Sirdani, P. Marin o.f.m., "Zembra e Skanderebegut", *Hylli i Dritës*, nr. 5, Maj, Shkodër, 1931
- Shllaku, P. Gjon, o.f.m., "Dokumente historije", *Hylli i Dritës*, nr. 3-4, Marc-

Prill, Shkodër, 1940

- Valentini, Zef, "Gjergj Kastrioti pasqyra e atdhetarit shqiptar", *Leka*, nr. 8-12, Nanduer, Shkodër, 1937
- Vokopola, Ferit, "Ngritja e Flamurit Kombëtar", *Njeriu*, nr. 5, Nanduer, Tiranë, 1942
- Vokopola, Ferit F., "Fluturimet e shpirtit", *Zani i Naltë*, nr. 3, Tetuer, Tiranë, 1926

Prof, Asoc.Dr. Mois KAMBERI¹

ORIGJINA E KASTRIOTËVE, SKËNDERBEUT NËPËRMJET TOPONIMEVE

Abstrakt

Toponimet ose emrat e vendeve ruajnë në vetvete një autencitet të lashtë. Ato, më shumë se çdo gjini tjetër të kësaj natyre, u kanë bërë ballë ndryshimeve politike dhe kanë kapërcyer shekuj, për të arritur deri në ditët tona. Toponimet e gjetura në trevat e zotërimeve të Kastriotëve, për Kastriotët dhe Skënderbeun në Dibër janë të shumta, dhe kjo ka shpjegimin e vet, pasi epoka e Skënderbeut që më e lavdishmja në historinë e popullit shqiptar dhe qytetërimit evropian.

Gjeonologjia e shtëpisë së Kastriotëve do të kishte qenë e papërfillur, po të mos kishte dalë nga gjiri i saj Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Shumë shtete, popuj apo krahina të ndryshme kërkojnë ta bëjnë heroin tonë të tyre. Por burimet bashkëkohore dokumentare për paraadhësit e heroit, nuk shkojnë përtej të atit të tij, Gjon Kastriotit. Burimet dhe dokumentat e sjella do të hedhin poshtë shumë hamendësi rreth origjinës së Skënderbeut dhe do të përcaktojnë në bazë të këtyrë dokumentave dhe një toponimastike të pasur origjinën e tij nga Dibra. Përsa i përket vendit nga ishin Kastriotët, dhe ca më tepër, nuk flasin as për vendin ku kaloi fëmijërinë Skënderbeu.

Tema synon të sjell burime të pasura historike, dokumente të shkruara, dhe kujtime nga bashkëkohës, si dhe një toponomistikë shumë të pasur për origjinën e Kastriotëve dhe të Heroit tonë Kombëtar –Gjergj Kastrioti-Skënderbeu.

Densiteti i toponimeve për periudhën skënderbegiane, krahas Dibrës shtrihet pothuajse në tërë territorin shqiptar, si: Mat, Krujë, Lezh, Kukës, Mirditë, Librazhd, Elbasan, Tiranë etj. Do të jepen lokalizime të ndryshme rreth origjinës së Skënderbeut dhe betejave të zhvilluara prej tij nëpërmjet toponimeve. Krahas Skënderbeut në temë do të sillen dhe aktiviteti i disa prijësve të tjerë shqiptarë bashkëlutëtarë të tij si: Hamza Kastrioti, Moisi Golemi, Vrana Konti, Gjergj Arianit etj.

Fjalë kyçe: Gjeonologji, toponime, dokumente historike, gojëdhëna, legjenda etj.

¹ University “Aleksandër Moisiu”, Durrës; moiskamberi@yahoo.com

Tema: Origjina e Kastriotëve, Skënderbeut nëpërmjet toponimeve

Toponimet ose emrat e vendeve ruajnë në vetvete një autencitet të lashtë. Ata, më shumë se çdo gjini tjetër e kësaj natyre, u kanë bërë ballë ndryshimeve politike dhe kanë kapërcyer në shekuj, për të arritur deri në ditët tona. Toponimet e gjetura në trevat e zotërimeve të Kastriotëve për Kastriotët janë më të pakta në krahasim me ato për Gjergj Kastriotin, dhe kjo ka shpjegimin e vet, pasi epoka e Skënderbeut që më e lavdishmja. Mbas Skënderbeut, në rradhën e toponimeve vijnë ato për për Pal e Gjon Kastiotin. Nga densiteti që kanë toponimet, ato mund t'i ndajmë nga koha e krijimit të tyre në:

- toponime të krijuara në vitet 1443-1468
- toponime pas vdekjes së Heroit.

Është diçka shumë e veçantë që për vite e vite me rradhë historianët u muarën më orgjinën etnike të Kastriotëve dhe të krahinës shqiptare nga ato vinin. Pasi u zgjidh përfundimisht çështja etnike e Kastriotëve, filloi diskutimi mbi origjinën e tyre krahinore. Edhe sot e kësaj dite nuk ndërpritën punimet pa fund rreth origjinës krahinore të Kastriotëve dhe Skënderbeut. Në lidhje me këtë temë, gama e tezave ishte më e gjerë, sepse për trajtimin e saj u shfrytëzuan dy fusha burimore nga të cilat njëjën e përfaqësonte tradita popullore, tjetrën dokumenti historik.

Në lidhje me këtë tezë, fillimisht u shfrytëzua tradita popullore. Por sa më tepër regjistroheshin të dhënat popullore, aq më tepër vihej re se ato nuk pajtoheshin midis tyre, çdo krahinë e ndjente veten krenare ta nxirrte origjinën e Kastriotëve nga gjiri i saj. Gjeonologjia e shtëpisë së Kastriotëve do të kishte mbetur me siguri e papërfillshme, po të mos kishte dalë nga gjiri i saj Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Por burimet historike bashkëkohore për paraardhësit e Skënderbeut nuk shkojnë përtej Gjon Kastriotit. Madje shumë nga këto burime heshtin plotësisht, përse i përket vendit nga ishin Kastriotët dhe nuk flasin as për vendin ku kaloi fëmijërinë Skënderbeu.

Pas vdekjes së Skënderbeut, pushtuesi osman rrënoi mbarë viset shqiptare: qytete, manastire, kisha e objekte pelegrinazhi, u dogjën e bënë shkrumb e hi gjithçka e shkruar që lidhej me të kaluarën e Kastriotëve e Skënderbeut. U shkatëruan e u dogj ajo pjesë e historisë që shkatëronte historinë e vetë Perandorisë, që nuk mund t'i pranonte disfatat e saj përballë të vërtetës historike, që dhe një popull i vogël u bë pengesë në realizimin e projekteve të saj. Ata shkatëruan atë pjesë të historisë që lidhej me epokën më të lavdishme në historinë e shqiptarëve, atë të Kastriotëve e Skënderbeut. Por ato që i shpëtuan shkatërimit e zhdukjes qenë toponimet. Prandaj dhe gjurmimi i tyre, aq sa është i lodhshëm, është dhe i rëndësishëm dhe i domosdoshëm. Duke patur vlera

njohëse toponimet pasqyrojnë dhe traditat tona, vyrtytet, atdhetarizmin, luftrat tejet të përgjakshme për liri e pavarësi kombëtare. “Ashtu si fjalorët, toponimet janë si sahatët; më i keqi është më i miri se asgjëja dhe, nga më i miri, mos prit kurrë të jetë i përsosur”.²

Densiteti i toponimeve për periudhën skënderbegiane nxjerr në pah Dibrën e Matin, të cilat shtrihen pothuajse në tërë territorin e këtyre trevave. Por kjo nuk do të thotë që në vise të tjera shqiptare këto kanë munguar. Tradita popullore për Skënderbeun është e pasur edhe në rrethe të tjera të Shqipërisë si në Krujë, Kukës, Mirditë, Lezhë, Librazhd, Elbasanit, Durrës e Tiranë. Këto zona përbëjnë trevat kryesore të kësaj tradite. Me interes janë legjendat e toponimeve për kalatë, për malet, shkëmbinjtë, shpellat etj., që njihen në popull me emrin e Skënderbeut.

Në toponiminë për epokën e Skënderbeut vendin kryesor e zënë kalatë, fortesat dhe grykat e qafat e maleve. Më të përmendurat e kohës ishin: Kalaja e Krujës, Petrelës, Gurit të Bardhë, Lezhës, Shëngjinit, në Tiranë, Prezës, Zgërdheshit, Daules dhe Shkopetit në Krujë, Darsit e Bruçit në Mat etj. krahas tyre me kohë u ndërtuan edhe kala të reja si ajo e Modriçës, Rodonit, Peladhisë.

Toponomastika flet edhe për betejat e ashpra të Skënderbeut të zhvilluara në truallin shqiptar, që janë zhvilluar në rrethana të ndryshme. Toponimet e kësaj natyre, tradita i vesh me tregime gojore e legjenda pa mbarim. Si për betejat e Krujës, Albulenës, Kasharit, Gurit të Bardhë etj.

Përveç luftrave të zhvilluara ndër kala, toponomastika jep dhe ato të zhvilluara ndër male e fusha, dhe ato janë saktësuar në toponimet: “Gjurma e Atit”, Gjurma e Kalit”, Gjurma e Mushkës së Skënderbeut”. Këto toponime saktësojë çdo vend që ka shkelur Skënderbeu.

Përveç këtyre vijnë toponimet e kërcimit të kalit të Skënderbeut si: Kepi e Guri i Skënderbeut, Mali i Skënderbeut, Mali i Kastriotit, Fusha e Skënderbeut, Qafa e Belegjut në Mat, Shtegu i Skënderbeut, Pylli i Skënderbeut, Kulla e Skënderbeut, Shkalla e Skënderbeut në Rrajcë, Sheshi i Skënderbeut në Dardhë të Librazhdit etj.

Krahas këtyre janë dhe një seri toponimesh, si: Sofra e Skënderbeut, Kroi i Skënderbeut, Gurra e Skënderbeut, Mullini i Skënderbeut, Burgju i Skënderbeut, Vneshta e Skënderbeut, Tryeza e Skënderbeut, Gështenjat e Skënderbeut.

Veç këtyre toponimeve që lidhen me luftrat e Heroit, janë dhe një seri toponimesh që flasin për pushtetin e Skënderbeut, mbi kujdesin e tij për gurrat, krojet, pusët, tokat mullinjtë, lëmenjtë, që kanë të bëjnë me bereqetin, për pemët frutore, sofrat e tryezat ku shtrohej buka, ndërtimet e rrugëve, urave, shesheve, lama për rrahjen e bakrit për armët e luftës etj.

Duke u mbështetur në rezultatet e studimeve të ndryshme të vërtetuara në

² Samuel Johnson, filozof anglez i shek. XVII

bazë të burimeve të shkruara nga bashkëkohës të heroit dhe toponimet e pasura, akademikët shqiptarë bënë të mundur që më 2 nëntor 1985 ³në fshatin Sinë e Poshtme të rrethit të Dibrës të ndërtonin dhe përruronin Muzeun e Kastriotëve, i vogël por me një përmbajtje të madhe historike. Ai i kushtojë familjes së shquar të Kastriotëve e në mënyrë të veçantë të birit të saj të Gjergj Kastriotit –Skënderbeut. Ky muze u ngrit në fshatin Sinë të krahinës së Çidhnës në Dibër të Poshtme ku, sipas traditës popullore dhe në bazë të njoftimeve historike, ka qenë banimi i Kastriotëve dhe vendlindja e Skënderbeut⁴.

Ky përfundim është i lidhur me atë se në Dibër më shumë se në viset e tjera shqiptare, janë trashëguar ndër breza shumë këngë, tregime, legjenda e toponime për Kastriotët. Nisur nga burimet historike të mbështetura në toponomistikë, janë arritur disa përfundime të rëndësishme si:

- për origjinën e Kastriotëve
- për lokalizimin e betejave e kalave të Heroit si: Torviolli, Mokrena,

Otoneta, Meçadi, Rrethas e Talamiranës.

Kjo është normale pasi nga 24 beteja që ka zhvilluar Skënderbeu gjithsej, 19 janë zhvilluar vetëm në Dibër. Këto i gjejmë që nga Reka e Zhupa, Dibra e Madhe e Golloborda, Zerqani e Bulqiza, dy Fushat e Dibrës, Katër Grykët e Murrës, Muhurin e Çidhnën e deri në Lurë e Reçin e thellë malor të trevës dibrane.

Përveç toponimeve të shumta që hasim në truallin e të dy Dibrave për luftrat, kalatë apo vendqëndrimet e Skënderbeut ka dhe një grup tjetër toponimesh, të cilat janë të lidhura me vendlindjen dhe vendbanimin e Kastriotëve. Toponomastika që flet për vendlindjen dhe vendbanimin e Kastriotëve pati dy mikrokrahina të Dibrës së Poshtme:

- krahinën e Çidhnës dhe
- krahinën e Muhurit.

Muhuri është njëri nga Nëntë Malet e Dibrës në anën e majtë të Drinit të Zi. Toponimet në këtë krahinë nisin me dy Mazrekat: Mazreka e Poshtme dhe Mazreka e Epërme(sipërme) dikur kishin qenë qytet e pranë tyre është ende vendi që quhet Xhiteti(qyteti), ku edhe sot gjenden shenja muresh dhe sipër tyre mbi Shqath, është Kisha e Shënmërisë.⁵

Vendasit na njohin edhe me toponimet : “Vresht në Gardhin e Poshtëm” të lagjes ë sotme Rinë në një familje Berisha në Fushë Muhur dhe me emrin e

³ Ndreu Haziz, “Toponime për vendlindjen dhe vendbanimin e Kastriotëve”, Marin Barleti, Tiranë 1997, f.24.

⁴ Frashëri Kristo, “Nga cili vend i Shqipërisë ishin Kastriotët?”, Shkenca dhe Jeta, nr.1/86, f.28.

⁵ M.H.D. Dosja Kujtime për Kastriotët, Lan Mziu 81 vjeç, LMiftar Mziu 61 vjeç nga Fushë Muhuri.

një lagjie Bulaç që quhet, Palpus.⁶ Familja Berisha na kujton vëllezërit Berisha, besnikë të Skënderbeut, ndërsa Palpus ose pusi i Palit me Pal Kastriotin të atin e Gjonit. Dy Mazrekat dhe toponimet që u përmenden në anën veriore janë gjeografikisht të gërshetuara me Gardhin e Pashtëm dhe Gardhin e Epërm, Sinë e Poshtme dhe Sinë e Epërme të Çidhnës.

Në ndihmë të këtyre dy toponimeve me vlera historike, na vinë edhe dy dokumnte historike të Gjonit të Aragonës. Në të parin thuhet se: "Ne Gjoni Aragonës etj... me letra të shumë shkëlqyeshmit mbretit të Napolit, Ferdinandit, nipit tonë u përcollën tek ne Nikoll Bralera e Kostandin Mazreku Kastrioti, princa të Epirit të Shqipërisë, udhëheqës të zotët kundër turkut dhe një gjaku me Gjergj Mazrek Kastriotin-Skënderbeun". Në dokumentin e dytë thuhet: "Ne Gjoni Aragonës etj... me letra të shumë shkëlqyeshmit mbretit të Napolit, Ferdinandit nipit tonë u përcollën pranë nesh, Pjetër Emanueli, Zaharia Gropa, Pjetër Kuçja(Kuka) dhe Pal Maneshi, fisnik shqiptarë ose epirot, prisa të zot kundër turqve të udhëheqësit shumë të përmendur e të pathyueshëm Gjergj Masrek Kastrioti, princ i Shqipërisë dhe i Epirit dhe të një gjaku me të".⁷

Marin Sirdari i cili shpjegon tradicionalisht ndryshimet e mbiemrave thotë: "Mbas zakonit të hershëm e të thjeshtë ndër ne me marrë një familje emrin e vjetër Mazrek e patën Kastriotët pse rrjedhin prej Mazrekut, në se emri i dytë shënonte fshatin Kastri ku u vendosën pasi lanë vendin e parë prej ka ishin dyndur. Sido që të jetë puna ndër akte zyrtare shifet se qitet anash mbas do vjetve emni i hershëm Mazrek e kryetarët e kësaj dinastie përdorin emrin e dytë Kastrioti."⁸

Çidhna është një krahinë tjetër, e cila përmendet dendur në dokumentet e mesjetës. Tradicionalisht njihet si njëri nga Nëntë Malet e Dibrës. Në kohë të Kastriotëve ajo ka pasur tetë fshatra sipas Deferit të Dibrës, 1467 ishin: Sina e Epërme, Sina e Poshtme, Gardhi i Poshtëm, Arrasi, Shashari, Çidhna e Poshtme dhe Çidhna e Epërme. Të gjitha këto fshatra janë të vendosur në anën e majtë të Drinit. Këto fshatra janë të mbushura me toponime nga të cilat përmendim: Gardhi i Poshtëm, Gardhi i Epërm, dy Sinat, Kalanë e Çidhnës(ose të Skënderbeut), Kepi i Trojes dhe Troja, Kepi i Skënderbeut, Xhiteti(qyteti) i Çidhnës, Kroi Tonzotit(kështu e thërriste populli Skënderbeun), katër kishat e Sinës e të Gardhit, ku njëra në Sinë të Epërme quhet dhe sot Kisha e Shën Kollit.

Evidentimi i toponimisë Sinë dhe Gardh, na e nxjerr më në pah një dëshmi e fisnikut Gjon Muzaka, bashkëkohëtar i Skënderbeut i cili, pas vdekjes së Heroit u largua nga Shqipëria dhe në mërgim në Napoli, shkruan më 1510, kur ishte në moshë të thyer kujtimet e veta për djemt e tij. Midis njoftimesh shumë interesante

⁶ M.H.D. Dosja Kujtime për Kastriotët, Besnik Kbej, mësues-njohës toponimesh

⁷ Dok. 14 tetor 1467.

⁸ M.H.D. Marin Sirdari, Skënderbeu mbas gojëdhënave, f.6.

që jep për finikët shqiptarë, disa nga të cilët i njëjtte personalisht, përmend edhe një të dhënë me interes për gjyshin e Skënderbeut. Ai thotë në kujtimet e tija se:” Gjyshi i Zotit Skënderbe, quhej Pal Kastrioti dhe ky nuk kishte në zotërim më tepër se dy fshatra të quajtura, Signa dhe Gardhi i Pishtëm”. Të dy këto fshatra ndodhen në Dibër të Poshme ballë për ballë me fshatin Kastriot. Të dy fshatrat ekzistojnë në kohën e Skënderbeut. Kjo vërtetohet dhe nga defter mufasal turk i viti 1467, ku të dy fshatrat janë regjistruar ashtu siç i shënon Gjon Muzaka, madje dhe fshati i dytë është shkruar me gërmat turke në trajtën e shqipes Gard-i-postë.

Njoftimi tjetër me interes që i takon birit të Pal Kastriotit dhe të atit të Skënderbeut, Gjon Kastriotit, na e jep përsëri një bashkëkohëtar i Heroit tonë, humanisti Italian, Raffael Volaterrano në veprën e tij me titull “Komentatorët” që ai e boton në pleqëri në fillim të shek.XVI. “Ai nuk e quan Gjonin , atin e Skënderbeut, me mbiemrin Kastrioti, por Gjon Dibra ose Gjon Dibrani, në latinisht Johannes Dibra sive Doberiensis”. Ky njoftim e përforcon më tepër pohimin e Gjon Muzakës se Pal Kastrioti, ati i Gjonit, ishte gjithashtu dibran.

Një dëshmi tjetër interesante na vjen nga fondi i dokumntacionit turk. Është defter mufasal i regjistrimit të popullsisë së fshatrave e feudeve që administrate perandorake kreu në vitin 1467 në territorin e sanxhakut të Dibrës, i cili përfshinte, përveç të tjerave, rrethet e sotme të Matit e Dibrës. Në këtë defter na dalin dy veta që mbajnë mbiemrin Kastrioti. Njëri me emrin Dhimitër Kastrioti është regjistruar si banor i thjeshtë, si fshatar raja në fshatin Sinë e Poshtme të Çidhnës, tjetri me emrin Mark Kastrioti është regjistruar si jamak(ndihmës) feudalëve spahi në fshatin Shtjaknë të Matit. Në defter nuk thuhet as për njërin as për tjetrin se ato kishin lidhje farefisnore me Skënderbeun.

Përveç defterit turk të vitit 1467, kemi në dorë dhe një regjister tjetër musafal të Dibrës, të hartuar nga qeveritarët osman në vitin 1571. Në këtë defter, jo në Sinë, por në fshatin Çidhën e Epërme janë regjistruar së bashku emrat e dy kryefamiljarëve homonimë, mbasi të dy quhen Pal Kastri. Mundet që në të dy rastet kemi të bëjmë me një shkurtim të mbiemri Kastri(oti). Nuk është një supozim pa bazë, sepse 31 vjet më vonë na shfaqet një tjetër pinjoll kastriotas nga ky fshat, quhet Jozef Kastrioti nga Çidhna, i cili ka nënshkruar krahas dy përfaqësuesve të tjerë dibranë ditën e kuvendit ndërkrahinor shqiptar të Dukagjinit që u mblodh në vitin 1602 në fshatin Dukagjin të Matit.

Nga sa thamë më sipër, nxirret konkluzioni se shfaqja e Kastriotëve në trevën dibrane, në fillim në Sinë, pastaj në Çidhën, gjatë një historiku kohor prej 250 vjetësh, që nga Pal Kastrioti i Gjon Muzakës deri tek Jozef Kastrioti i Kuvendit të Dukagjinit, nuk mund të thuhet se është rastësi. Kjo vazhdimësi të dhënash që përfaqësojnë afërsisht 8 breza njerëzorë, tregojnë se Kastriotët kanë qenë qysh në shek.XIV banorë të trevës së Çidhnës, deri aty nga shek. XVII kur

gjurmët e tyre humbasin në burimet historike.

Këtyre të dhënave tani duhet t'u shtohet edhe një argument i ri, i cili me sa dimë deri sot askush nuk e ka vënë në dukje. Është fjala për vendimin e senatit të Shën Markut, në të cilin jepet Gjergj Kastrioti dhe vëllai i tij Stanish Kastriotit, qytetaria e Venedikut, më 20 shkurt 1445. Vendimi i cilëson të dy vëllezërit "Zot të Dibrës e të Matit". Për të zbërthyer përmbajtjen e titullit duhet të kemi parasysh se më 1445, Skënderbeu kishte çliruar Krujën, të cilën i ati nuk e zotëronte dhe ishte shpallur zot i saj. Këtë na e thotë qartë Marin Barleti ku shkruan se "Kruja është qytet i Epirit i vendosur në fushën e Matit". Kjo do të thotë se Skënderbeu dhe Stanishi më parë qenë zotër të Dibrës dhe pasi e shtinë në dorë Krujën edhe zotër të Matit.

Nën dritën e këtyre të dhënave origjina dibrane e Skënderbeut, tani vërtetohet dhe nga Marin Barleti. Kështu viset e Çidhnës, ai i quan "Viset e Skënderbeut". Fjalët e humanistit shkodran Marin Barleti, tani marrin një kuptim të veçantë, kur thotë se jo vetëm Skënderbeu kur u kthye nga Nishi në Dibër, i njëjtte dibranët por edhe dibranët e njëhjin Skënderbeun, prandaj ai hyri në Dibër pa luftë, si në shtëpinë e tij. Po për këtë arsye ai u nis qysh të nesërmen në mëngjes, i shoqëruar nga qindra dibranë për të marrë me dredhi Krujën. Askush nga dibranët vazhdon Barleti, nuk kundërshtuan veprën e tij të guximshme, por nënvizon edhe ai, por edhe nga malli që ushqenin për të prej një kohe kaq të gjatë. Prandaj shkruan ai më tej, "dibranët u derdhën të gjithë rreth e përqark kush e kush më parë, tërë shënd e verë dhe duke kërcyer nga gëzimi, me lot që u rridhnin në fytyrë nga gazi i madh, një palë puthnin duart, një palë faqet e kokës, të tjerë këmbët e pastaj gjithë trupin duke e mbytur me përqaftime të pambaruara".⁹

Por në traditën gojore të popullit, emir i fshatit Kastriot dhe toponimet për Gjon Kastriotin mbeten të pashlyeshme në mendjen dhe zemrën e popullit. Emri i fshatit e ka zanafillën me emrin e fisit të Kastriotëve. Fshati në kohën e Gjonit e Skënderbeut ka qenë një qytet me shumë shtëpi, por pas vdekjes së Skënderbeut, turqit e rënuan dhe e bënë rafsh me tokën. Lagjet më të mëdha kanë qenë Çeliasë dhe Troja. Toponimet nisin në lagjen Çeliasë, me një kodër që ndodhet 100 m në bregun e djathtë të përroit të Kastriotit, që vendasit e quajnë "Kalaja e Gjonit", "Kulla e Gjonit", që tani i thonë "Kodra e Gështenjave". Kjo kodër është në krye të Çeliasë, ngjitur me Kishat e Kastriotit. Në anën perëndimore të kalasë(kullës) është toponimi "Kopshti i Gjonit", rrethuar me mure, që tani nuk shihen. Në very të kullës janë "Ogradja e Gjonit" dhe "Zabeli i Gjonit", "Kopshti i Gjonit", "Pusi i Gjonit", "Gjuri (guri) i Luftës" rreth katër hektarë tokë. Fundin e lagjies e mbyll "Kodra e Pareve". Këtu në Kastriot, tek Troja, ka një krua që i thonë "Kroi Kastriotit". Ky krua nuk ka emrin e fshatit, por atë të fisit të kastriotëve. Ashtu

⁹ Marin Barleti, "Historia e Skënderbeut", Tiranë 1983, f. 629.

sin ë Sinë edhe në Kastriot, thonë vendasit, ka emra vendesh si “Troja e Gjonit”, “Troja” etj. që lidhen me kastriotët edhe në fshatin Kuke.¹⁰

Në mbështetje të toponimit “Troja” flet një defter regjistrimi osman i vitit 1583. Aty krahas emrave të tokave të tjera përreth është shkruar edhe “Truallishtja e Gjonit” dhe ngjitur me të “Truallishtja Kuka”. Po me Gjon Kastriotin e toponimet e dendura “Troje” na indentifikon më së miri dhe Volaterrano, në veprën e tij të viti 1506, që e quan Gjonin të atin e Skënderbeut, Gjon Dibrani. “Gjoni kishte në zotërim të tij “Trojën” dhe vende të tjera Brenda vendit”¹¹

Toponimi katundi(fshati) Kastriot, flet qartë për autencitetin e fisit të Kastriotëve si dibrane, duke i marrë këto në lidhje të pashkëputura që nga Mazrekat, Sinat dhe Gardhi i Poshtëm. Përsa i përket vendlindjes së Gjergj Kastriotit, janë dhjetra tregimtarë nga Dibra e Epërme e deri në Lurë, që thonë se vendlindja e Heroit është në Kastriot. Në këtë vazhdë hyri edhe Sirdani me të dhënat e tij ““Mbreti, i cili kundronte së afërmi cilësitë e jashtëzakonshme të tijat(Skënderbeut) e dërgonte shpesh në krye të ushtrisë për me shue kryengritjet e për me vendosë qetësinë e vendit e gjithkund i printe ora para. Së mbrami e nisi ky edhe me një urdi të madhe kundra kryqtarëve, por këtë herë, tuj pa giasën se mundte me i ba lak e me u shporr tij, nësa po kalonte nëpër Adriene shmang me të vet e voti në katund të Kastriotit, ku kishte dhe fisin e vet”.

Krahas këtyre toponimeve në ka dhe toponime të tjera si: “Kalaja e Voles” dhe “Përroi Shkamajnit”, të cilat sipas përshkrimit të Biem, na jep të drejtën të pohojmë se beteja e 29 qershorit 1444 u zhvillua në Fushën e Kastrioti dhe goditja përfundimtare u bë në afërsi të lagjes Voletë fshatit Vrenjt, në Dibër të Poshtme. Fusha ishte 7 milje e gjatë dhe 3 milje e gjërë dhe ishte e rrethuar nga të katër anët prej malesh, brigjesh e pyjesh. “Skënderbeu ka luftue këtu në kastriot, ku sot themi “Gjuri i Luftës” etj., por beteja më e madhe është zhvilluar të Kalaja e Voles. Këtë kala Skënderbeu e mbante për mbrojtur Kalanë e Kastriotit dhe të dyja bashkë mbronin qytetin e Çidhnës dhe Sinës.

Tregimtarë e këngë popullore historike për Skënderbeun në Dibër, flasin dhe për disa kala e gryka se janë të Skënderbeut si: kalaja e Xhitetit(qytetit) në Lurë, Kalaja e Gradishtit në Limjan. Është me interes një toponim i vetëm që hasim në Reç, që thotë se “Shpella e Skënderbeut” nga veriu ka “Hurdhat e Pacit”, në lindje “Rahin e Koculit”.

Mikrokrahina e Lurës ka një seri toponimesh të Skënderbeut si: “Rruga e Skënderbegjut”, lurasit thonë se kalon në të gjitha trevat dibrane. Lurasit kanë qenë farkëxhinjtë e Skënderbeut të cilët i kishin bërë një top që se kishte kush në atë kohë.

Kryeministri Turqisë, Feti Pasha, në vitin 1916 ka shkruar :” Nandë Malet

¹⁰ MHD, Dosja Kujtime, Sefedin Doçi, Selim Lleshi, fshati Kastriot

¹¹ Volaterrano.”Libri VIII, Geografia, Makedonia, f.188

e Dibrës së Poshtme dhe të Dibrës së Epërme formojnë atë krahinë klasike, roli historik i së cilës ka ushtruar ndikim të madh jo vetëm në problemet shqiptare, por edhe ballkanke.... Falë Dibrës, Skënderbeu-Heroi Kombëtar mundi të konsolidojë pushtetin e vet, duke përballuar për 24 vjet ushtritë tona. Midis tij dhe gjeneralëve tanë, përfundimi i luftimeve varej nga mposhtja e “Nandë Maleve” të dy Dibrave. Atje është zemra e Shqipërisë, porta e vërtetë e Shqipërisë, është atje kurdoherë”.¹²

Si përfundim mund të themi se:

Ajo që e lidh historinë me tokën është toponimia. Deri më sot, nuk ekziston një botim i veçantë toponomastik që lidhet me origjinën e Kastriotëve dhe Skënderbeut. Kështu, duke u nisur nga burimet historike të mbështetura në toponomastikën, kam arritur në disa përfundime të rëndësishme si për origjinën e Kastriotëve ashtu dhe për lokalizimin e disa betejave, si atë të Troviollit, Mokrenës, Otonetës, Meçadit e sidomos të Skënderbeut. Duke patur këto vlera njohëse, toponimet pasqyrojnë dhe traditat tona, atdhetarizmin, luftrat tejet të përgjakshme për liri e pavarësi kombëtare.

Pal Kastrioti, Gjon Kastrioti dhe Gjergj Kastrioti, me vëllezër e farefis rridhnin nga Mazreka e Muhurit, ndaj siç flasin dhe dokumentet, mbanin në fillim mbiemrin Mazreku. Nga Mazreka ata u ngulën në Sinë e në Gardh. Që Kastriotët ishin banorë të Sinës së çidhnës vërtetohet nga defterët turk. Ai i vitit 1467 shënon Dhimitër Kastriotin banor të Sinës, krahas Kol Priftit, fis që jeton edhe sot e kësaj dite në Sinë. Për Sinën e Gardhin dëshmon Gjon Muzaka:”Ato ishin prona të Pal Kastriotit”. Kësaj thënie i vjen në ndihmë dhe ajo e Sirdanit.

Defteri tjetër turk i regjistrimit të popullsisë dhe të feudeve në Dibër, ai i vitit 1571, shënon Pal Kastriotin banor të Çidhnës së Epërme.

Nga Sina e Gardhi, Kastriotët dolën në fushë. Vendi që zunë u quajt Kastriot. Në defterin turk të regjistrimit 1583 shënohet “Trullishtja e Gjonit”. Kjo e fundi konfirmon toponimin “Troje”. Këtë toponim “Troje” e hasim në Sinë dhe në Kastriot. Për këtë toponim Troje, vlen të përmendim dhe Volaterranon që më 1506 shkruante se:”Gjon Dibrani kishte në zotërim Trojen dhe disa vende të tjera brenda vendit”.

Të dhëna të shumta gojore na sjell Sirdani, për vendlindjen e Skënderbeut:”Nësa po kalonte nëpër Adriene, u shmang me të vet e voti në katund të Kastriotit, ku kishte dhe fisin e vet”.

Ngritja e Muzeut Historik të Kastriotëve në Sinë nga Akademia e Shkencave në vitin 1985, i vjen dhe më shumë në ndihmë pohimit tonë se “Kastriotët qenë

¹² 11. Bastri beg Dukagjini, “Shballkanizimi Orientit”, Paris, 1919.

dibranë autokton” sepse Sina sipas traditës popullore dhe në bazë të njoftimeve historike ka qenë banimi i Kastriotëve dhe vendlindja e Skënderbeut.

In conclusion we can say that:

What links history to one’s land and nation is toponymy. So far, there is no particular toponomastical publication related to the origin of Kastriot and Skanderbeg. Therefore, based on historical resources related to toponomastic studies, I have come to some important conclusions regarding the origin of the Kastrioti’s and the venue of several battles, such as those of Trouvoli, Mokren, Ottonet, Meçad, and especially that of Skanderbeg. Considering these cognitive values, the toponyms get reflected in our traditions, patriotic feelings and bloody wars being fought for national freedom and independence.

Pal Kastrioti, Gjon Kastrioti and Gjergj Kastrioti, their brothers, and relatives and kinship came from Mazreka of Muhur, and the documents reveal that the surname they initially held was Mazreku. They moved from Mazreka to Sina and Gardh. The Kastrioti’s were inhabitants of Sina and this is confirmed by the Turkish defters. One of these defters of 1467 determines that Dhimitër Kastriot was living in Sina, along with the family of Kol Prifti, whose kinship still live in Sina even nowadays.

Gjon Muzaka testifies their living in Sina and Gardh: “These were lands owned by Pal Kastrioti”. This statement was supported by Sirdan, too.

The other Turkish defter on the population and feudal census in Dibra dating from 1571, shows that Pal Kastriot was an inhabitant of Çidhna e Epëme.

The Kastrioti family left Sina and Gardhi and settled into the field. The place they settled was called Kastriot. In the Turkish recordings in 1583 this is named as “The Trullo of John”. This finally confirms the toponym “Troje” (meaning “land, property” in Albanian). This “Troje” toponym is encountered in Sina and Kastriot. For this toponym Troje, it is worth mentioning Volterranon who wrote in 1506 that “Gjon of Dibra owned Troja and some other regions within the country.”

Sirdani makes a mention of many legends and myths about Skanderbeg’s birthplace: “If he was going through Adriene, he drifted and headed towards the village of Kastrioti, where his kith and kin used to live.”

The establishment of the Kastrioti Historical Museum in Sina by the Academy of Sciences in 1985 is very helpful to our assertion that “the Kastrioti family were autochthonous people of Dibra origin” because Sina, according to the popular tradition and the historical findings was the living place of Kastrioti’s and the birthplace of Skanderbeg.

Bibliografia

- Batri beg Dukagjini, “Shballkanizimi Orientit”, Paris, 1919
- Dok. 14 tetor 1467
- Frashëri Kristo, “Skënderbeu”, Toena, Tiranë, 2002.
- Frashëri Kristo, “Dibra dhe etnokultura e saj”, vëll.I, Dibër 1995.
- Frashëri Kristo, “Nga cili vend i Shqipërisë ishin Kastriotët?”, Shkenca dhe Jeta, nr.1/86
- Historia e Popullit Shqiptar, vëll.I, Toena, Tiranë 2002.
- Marin Barleti, “Historia e Skënderbeut”, Tiranë 1983
- M.H.D. Dosja Kujtime për Kastriotët, Lan Mziu 81 vjeç, Miftar Mziu 61 vjeç nga Fushë Muhuri.
- M.H.D. Dosja Kujtime për Kastriotët, Besnik Kbej, mësues-njohës toponimesh
- M.H.D. Marin Sirdari, Skënderbeu mbas gojëdhënave
- MHD, Dosja Kujtime, Sefedin Doçi, Selim Lleshi, fshati Kastriot
- Ndreu Haziz, “Toponime për vendë lindjen dhe vendbanimin e Kastriotëve”, Marin Barleti, Tiranë 1997
- Pulaha Selami, “Mbi origjinën e Kastriotëve”, Peshkopi, 1985.
- Sadiku Hilmi, “Rreth tezës së origjinës së Kastriotëve nga Hasi”, Ushtima e Maleve, 22 nëntor 1986.
- Sirdani Marin, “Skënderbeu mes gojëdhënash”, 1926.
- Volaterrano, libri i tetë, geografie, Macedonia.